

# HYSEN SINANI

BIBLIOTEKA

BSH-311

5'79



**NUK E HARROJA  
ATE DITE**

roman

8SH-31

S 59

HYSEN  
SINANI

**Nuk  
e  
harroja  
atë  
ditë**

roman

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

BIBLIOTEKA E  
BANKËS QENDRORE  
NR. 1

52302

*Redaktor*  
**ZENEL SULA**

*Piktor*  
**SAFO MARKO**

*Recensues*  
**Dhimitër Xhuvani**  
**Kujtim Harshova**  
**Lumira Berati**

Jibër i bukur  
i realizimit  
Socialist.

Më kishin pushuar nga puna.

Çudi. Vjen një çast kur mund ta ndiesh veten aq të hutuar, sa të mos arrish të kuptosh asgjë nga ato që kanë ndodhur. Për një njeri si unë, që gjithë jetën e ka pasur krejt të thjeshtë e të qartë, edhe një shqetësim fare i vogël bëhet shkak që t'i dridhen duart e të mos nderë dot as cigaren. Por unë shqetësimin nuk e kisha aq të vogël. Mua më kishte ngjarë diçka që rrallëkujt i takon ta provojë. Dhe kjo më bënte ta ndieja veten të vetmuar. Veçse nuk më dukej si ajo ndjesia e zakonshme e vetmisë që ngjan pak si trishtim e pak si mall për dikë a diçka. Ishte një vetmi e veçantë, e paprovuar ndonjëherë

më parë, që më sillte vazhdimisht të njëjtën përshtypje, të njëjtin mendim qysh nga çasti kur më lanë në dorë librezën e punës...

S'di sa kohë kisha qëndruar si i trullësuar tek ajo portë e hekurt ku, pasi i prisja të gjitha fijet e shkrepëses, e flaka edhe kutinë, edhe cigaren e pandezur. Nuk kisha asnjë dëshirë tjetër veç të largohesha nga ajo ndërmarrje dhe nga ata njerëz që më kishin hedhur jashtë saj. Por kjo nuk është aq e lehtë, kur ndien sidomos edhe njëfarë faji e njëfarë turpi për t'u dalë të tjerëve para syve. Atëherë akoma më pak e di ku të shkosh e çfarë të bësh. Se ja, po të nisesha drejt e në punën e tim vëllai, ai nuk do të priste të më dëgjonte deri në fund. Sapo të merrte vesh përse bëhej fjalë, do të më jepte ndonjë nga ato këshillat e tij të famshme që mua, ndonëse më kishin pëlqyer (gjithmonë, tani me siguri do të më ngrinin nervat. Motra e madhe (as kjo nuk do të më dëgjonte deri në fund) do të habitej në fillim, pastaj nuk do të besonte, do të alarmohej e papërmbajtur dhe rrezik të vinte menjëherë në zyrat e ndërmarrjes si me për t'u kërkuar llogari atyre që më kishin pushuar. Këtë nuk e doja. Motra e dytë do të më vështronte me ironi e do të më bënte moral për disiplinën në punë. Pastaj do të

më nxirrte një gotë raki, do të më skuqte ndonjë biftek a bërçollë dhe do të më porosiste të isha më i kujdesshëm, si të mos kishte ndodhur kushedi se çfarë. Kjo do të m'i ngrinte nervat edhe më tepër. Ndërsa motra e tretë, ajo do të më shikonte me ca sy të pikëlluar pa më thënë asnjë fjalë, ndoshta edhe do të përlotej. Kjo, akoma më keq, do të bënte të më dukej vetja si në një skenë melodrame.

Pa e kuptuar, këmbët më kishin çuar në një pijetore, duart ishin futur vetë në xhepa dhe banakierja më dukej se më kishte dhënë në kafe e fërnet pa e porositur. Isha gati i bindur për këtë, sepse e ndieja që isha prisur aq shumë në fytyrë, sa shitësja do ta kishte pasur të lehtë të merrte me mend brengeën që më mundonte. Dhe ajo mund ta kishte mësuar me kohë që njerëz të tillë, sigurisht, e marrin kafën me fërnet.

Nuk e di si e kisha pirë edhe atë gotë dhe kisha nisur lojën me lëvizjet e banakieres. duke harruar gjithçka, edhe veten, edhe të tjerët. E vështroja si shtypte ekspresin me njërën dorë, duke i mëshuar me gjithë shpatullën, se si e hidhte kafën e shtrydhur nga një filxhan i madh çaji në një broke porcelani, pastaj e kthente masën e kërkuar në xhezve, e ziente për disa çaste dhe më në fund mbushte filxhanët që nxirrnin avuj. Kështu pa pushim. Dikujt i jepte një konjak, dikujt një paketë cigaresh, një tjetri pastë a çokollatë dhe pothuajse për secilin

e kishte nga një fjalë të zanatit a një buzëqeshje. Filloi të më pëlqente. Edhe pse në moshë jo të re, ajo ishte e bukur. Kishte flokë tepër të zinj, sy edhe më të zinj e të mëdhenj, që rrethoheshin nga një e bardhë tepër e shndritshme. Hundën e kishte të drejtë, pak, fare pak përpjetë, ndërsa buzët të plota e me një formë klasike. Këto tipare ishin vënë aq harmonishëm në fytyrën veza-ke, sa mund ta merrje shumë lehtë me mend bukurinë e rrallë në rininë e saj.

Ajo më buzëqeshi. Me sa duket e kishte ndier vështrimin tim të përqëndruar, ose më mirë kishte vënë re nervozizmin tim dhe i kishte ardhur keq. Pas pak, kur njerëzt ishin rralluar në banak, ajo m'u afrua dhe, si i kaloi një leckë përsipër tryezës, më tha:

M'u duke i mërzhitur kur hyre.

— Po.

Unë i ktheva buzëqeshjen.

— Ta paska prishur ndonjë vajzë.

Ajo ishte krejt e sigurt dhe unë nuk dëshiroja t'ia hiqja sigurinë, por as nuk mund ta gënjeja, qoftë edhe ashtu kot, pa të keq.

— Jo, — i thashë, — më kanë pushuar nga puna.

Ajo nuk më besoi.

— Një djalë si ti nuk kanë përse ta pushojnë nga puna, — tha si me qortim e si t'i kishte marrë ato fjalë për shaka, që, megjithatë, nuk i kishte pëlqyer.

Ajo u largua për në banak po duke buzëqeshur. Unë ndjeva një gjallëri të menjëher-

shme. I qenkam dukur njeri i mirë, thashë me vete dhe m'u bë qejfi që dikush mendonte ashtu.

Ekspresi filloi përsëri të fishkëllente dhe një grua kërkoi shurup. Nurije Katroshti, thashë dhe në çast mendova: Pse m'u kujtua kjo grua fatkeqe, kjo kuqalashë që dikur punonte në repartin e ambalazhit, kurse para pak kohësh e kishin transferuar në montim? «Më shuplakën, he i shuplaktë zoti!», më pati thënë ditën e transferimit. Edhe atëherë desha ta pyesja se ç'donte të thoshte «shuplak», por nuk guxova. Ajo ishte shumë e acaruar. Gjithmonë, kur përdorte këtë fjalë, ajo, ose ishte tepër e mërzitur, ose zbrazte një duf a hidhërim të madh. Kur më pati treguar se si kishte mbetur qyqe, pa burrë e pa fëmijë, më pati thënë: «Mua më shuplaku jeta, vëllai i motrës, askush s'më ka hak.» Dhe unë prapë nuk e kisha pasur të qartë kuptimin e asaj fjale, me gjithë historinë e dhimbshme të jetës së saj. Kishte parë shumë vdekje me sy. Gjashtë njerëz nga të shtëpisë nënë, baba, motra e vëllezër ia kishin vrarë nazistët, «sa hap e mbyll sytë». Ajo kishte shpëtuar, sepse kishte qenë duke kullotur kecat dyqind hapa larg shtëpisë. Por kjo s'ishte gjë. Fëmija pesëvjeçar, sa ishte ajo atëherë, rritet dhe harron. Nga fshati e kishte marrë daja i vet që banonte në Tiranë. Si u rrit, e kishin martuar «me një burrë të bukur fort», me një shofer nga familja e Katroshtëve. Kishte lindur një djalë që «ia



këpuste kryet të atit dhe kush ishte si unë». Por fati që shkruar i zi për të. Një ditë erdhën e i thanë se nuk e kishte më as burrin e as djalin. Kishin rrëshqitur me makinë në Qafëkërrabë. Dhe ajo, megjithatë, kishte jetuar, «se njeriu qenka më i fortë se guri»... Më vinte keq për këtë grua dhe, sa herë takoheshim në mensë, i jepja një kafe që e pinim bashkë të shoqëruar me cigare. «Nuk më duan këta», — thoshte duke bërë me kokë nga zyrat dhe unë e merrja me mend që e kishte fjalën për drejtorin, Dyr Demën, dhe disa të tjerë që ai i kishte njerëz të tij. Kur e pyeta njëherë, «nuk jam e bukur unë, të keqen motra», më tha dhe u ngrit e iku në repart. Qau kur mori vesh se më kishin pushuar nga puna dhe, në vend të ngushëllimit, mallkoi me po ato fjalë që kishte mallkuar kur e kishin transferuar në repartin e montimit. «Të shuplakën edhe ty më keq se mua. He, i shuplaktë zoti!» Mua më ngjau sikur më qëlloi dikush me shuplakë dhe sikur m'u bë i qartë kuptimi i asaj fjale që më ishte dukur aq e çuditshme e gati argëtuese.

Vallë, përse më që kujtuar kjo grua e mjerrë? Nga fjala shurup apo nga fishkëllima e ekspresit? M'u dukën krejt të kota loja me lëvizjet e banakieres, fërneti që pija e bile vetë prania në atë pijetore të periferisë. Megjithatë, ndenja edhe disa minuta. E ktheva me fund pijen që më kishte mbetur në gotë, përshëndeta banakieren dhe dola në rrugë.

As tani nuk dija ku të shkoja e çfarë të bëja. Por ndoshta kështu do të ishte për cilindo si unë, për një të fejuar që martohesh në gusht. Kurse atë ditë data ishte tetëmbëdhjetë prill. Sa kohë vallë do të rrija pa punë? Kur do të kthehesha edhe një herë në qetësinë time të dikurshme?... Apo nuk do të kishte më kurrë një «qetësi të dikurshme»?...

Sa e çuditshme më dukej kjo gjendje! E pabesueshme. Që gjashtëmbëdhjetë vjeç i kisha kapur hekurat akull të ftohtë në mes të dimrit dhe nuk kisha qenë i pakënaqur. Në dhjetë vjet punë nuk kisha munguar as dhjetë ditë, se isha i fortë fizikisht dhe nuk sëmuresha. Kurse tani, ja, kundër dëshirës sime, më kishin dhënë një «leje» që s'dihej sa do të zgjaste. «Me atë librezë, hajde të gjesh një vend tjetër tani», — më tha Donika, e fejuara, kur u ndamë te porta e ndërmarrjes. «Më duket se u bëra unë shkak. Mund të isha treguar më e matur...», — pëshpëriti ajo, por dukej që as vetë nuk i besonte ato që thoshte...

Sesi më vinte që e kisha lënë aty. Si do të punonte ajo pesë metra larg Mësall Sulës? Pastaj, a do t'u qëndronte dot ngacmimeve të tij dhe të përgjegjësit të repartit, Gention Spahut, që më kishte armikun numër një? Po Dyr Dema, drejtori ynë, të cilit i kisha fyer publikisht dhëndrrin, burrin e së bijës, ç'do të bënte? Ata me siguri që s'do ta linin të qetë. Do t'i nxirrnin pengesa në

punë, do të shfrytëzonin ndonjë të metë dhe... E çfarë? Në fund të fundit, gjëja më e madhe që mund t'i bënin ishte ta transferonin në repartin e presave. Kjo ishte zakonisht masa më e rëndë e Dyrrit ndaj punëtorëve që bënin thyerje të disiplinës ose që nuk i pëlqenin atij. Por ai as këtë s'do ta bënte, sepse Donika nuk do të linte shkak për asgjë. Ajo do të dinte të ishte e matur dhe e kujdesshme. Donika... E përse Donika?

Duhej të kujtoja të tjerë njerëz. Duhej të kujtoja atë që mund të më mësonte qoftë edhe se çfarë nuk duhej të bëja, po qe se çdo gjë kishte marrë fund, siç kishte thënë Dyrri Dema: «Hë, edepsëzi! Me këtë librezë pune nuk ha bukë në gjithë republikën. Vetëm në kanal. Atje ka punë për atë». Kurse e fejuara ime, siç mund të merret me mend, e trembur nga këto fjalë, e kishte zburtonin e drejtorit: «Me atë librezë, hajde të gjesh vend tjetër tani.» E gjeja apo jo? Më dukej e pabesueshme të shkoja në zyrën e punës dhe atje të më thoshin: «Jo, me këtë librezë, ti, djalë, vetëm në kanal mund të punosh... Apo se ka firmosur Dyrri Dema...»

Më duhej patjetër një njeri për t'u këshilluar, një mik, një i afërm, dikush që dinte më shumë se unë, që i kuptonte më mirë këto gjëra dhe mund të më drejtonte. Por, edhe për të zgjedhur njeriun që, mbi të gjitha, mund të më dëgjonte me vëmendje, m'u desh shumë kohë derisa vendosa. Dhe u nisa për në zyrën e Lirim Tiranës, baxhanakut

tim. Më duhej të bëja nja dyqind metra në këmbë për të shkuar në njërin nga stacionet e autobusit, në të poshtmin ose në të sipërmin. Eca për nga i poshtmi, gati duke vrapuar, se më dukej sikur s'do ta gjeja Lirimin aty, po të vonohesha qoftë edhe një minutë. Dhe po të mos e gjeja tani, kisha bindjen se më vonë s'do të isha i zoti për t'i kërkuar ndonjë mendim, sepse diçka tjetër mund të më lindte në kokë dhe krejt tjetër gjë të bëja.

Duke iu afruar stacionit, ndjeva në krah një veturë që më ndiqte me hapin tim. U kthva me vrull dhe në timon pashë një njeri në moshën time. Po më buzëqeshte. Në fillim nuk e njoha, ngaqë më pengonte refleksi i xhamit anësor, por pastaj thirra me gëzim dhe hapa derën e përparme ende pa ndaluar makina. Ishte një shok ushtrie, shofer i një zëvendësministri.

— Ku do të shkosh? — më pyeti ai pa më përshëndetur.

— Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, — i thashë, — po ç'kemi njëherë, si ke qenë?

— Top fare! — Ai më hodhi një vështrim me bisht të syrit. — Paske ndërruar punë?

Unë lëviza dorën në ajër.

— Jo, dua të takoj dikë.

— Shumë mirë, ja ku arritëm.

Ai ndaloi makinën e u kthye nga unë gjithnjë duke buzëqeshur. Me sa dukej ma falte mospërfilljen. Po unë ndieja bezdi kur ma falnin kaq lehtë mospërfilljen. Ai më ki-

shte marrë në makinë, ndoshta nga dëshira për të biseduar, për të kujtuar ndonjë histori nga ushtria apo për të pirë një kafe. Dhe, kuptohej, ma kishte lexuar mërzitjen në fytyrë, si banakierja, ndaj, pa këmbyer as pesë fjalë, më kishte sjellë aty ku doja.

— Sikur të merrnim diçka në ndonjë pasticeri, — i thashë si i zënë ngushtë.

— Jo, jo, — ma bëri me dorë. — Një herë tjetër: Këtu jemi. — Dhe nisi makinën gati pa më përshëndetur.

Më erdhi inat dhe turp me veten. Në ato caste që kishim udhëtuar bashkë i kisha harruar edhe emrin. Sapo u nis, ia kujtova. E quanin Bardhyl Metani, i biri i Latif Metanit, tiranas denbabaden dhe zanatçi denbabaden...

Me gjithë nxitimin tim, Lirimin nuk e gjeta në ministri. Dhe mirë m'u bë. Sepse të nxitosh vetëm nga një mendim që të vjen papritur në kokë, është një gjë aq e kotë, sa ç'është e kotë çdo ngutje që synon fundin pa menduar fillimin. Baxhanaku im nuk kishte ardhur fare aty; natën e shkuar kishte qënë me shërbim. Edhe unë këtë e kisha harruar...

I shkova në shtëpi. Aty ishte. Në kuzhinë. Përpara mbante një kulesë plot me qepë të qëruara, që i merrte prej andej, i grinte imët dhe i hidhte në një pjatë të madhe. Kur hyra unë, pa më thënë asnjë fjalë, u ngrit, mori një karrige, e vendosi pranë së tijës dhe, si më vuri një thikë në dorë, më tha:

— Grij, se gruaja do të niset për në punë!

Unë qesha dhe u ktheva t'i jepja dorën Lillianës, motrës të së fejuarës, që hyri në kuzhinë sikur vërtet ta priste jashtë ndonjë alarm.

— Lëri, ore, ceremonitë, se të thashë që s'kam kohë.

Lirimi i tha këto fjalë në mënyrë aq të shtirur, sa ne qeshëm të dy. Kurse Liliana ngriti një vetull plot përçmim dhe na tregoi «edhe një herë» se si duheshin bërë tamam këto punë kaq të vogla.

Të grish qepë kur të djeg koka, është vështirë të pranosh të të djegin edhe sytë. Vec kësaj, është një gjë mjaft e rëndomtë. Por unë e bëra me qejf dhe njëqind herë më mërzë e më shpejt se Lirimi, sikur ta dija që pas kësaj do të më vinte një lloj çlirimi. Dhe erdhi. Kur kullesa u boshatis, baxhanaku im u ngrit plot mburrje për punën që kish-te bërë, mori në bufe një shishe me raki, dy gota po aty, një pjatë me djathë e qepë të njoma në aneks dhe, si i vuri në tavolinën e mesit, shpërtheu:

— Tani që e mbaruam detyrën, mund të fillojmë nga ceremonitë e mikpritjes. Hë, ç'thonë hekurat? I rregulloni mirë apo jo?

Qesha. Më pëlqente kur fliste ashtu për punën tonë, me njëfarë ironie mallndjellëse. Dikur kishte qenë vetë shofer e mekanik. Nganjëherë edhe më ngacmonte: keni punë me përgjegjësi ju. Jeni më të rëndësishmit! Edhe kjo më pëlqente. Qeshja gjithmonë. Por ndërruaka dita, ndërruaka moti, ndërru-

aka njeriu. Tani që ai më kujtoi punën, e ndjeva menjëherë që u zymtova. Këtë e vu-ri re edhe Lrimi, sepse më tundi kokën: ç'kisha? Nuk i thashë gjë. Në atë kohë hyri përsëri Liliana, që shkante e vinte sa në kuzhinë në banjë, ku ndihej zhurma e makinës larëse. Ajo na solli edhe ca patate të pjekura në furrë dhe nga një kremviçe.

— Për dhjetë minuta bëhet kima, — tha.  
— Unë po iki, se, po u vonova, më duhet të pres autobusin tjetër, që vjen pas një çerek ore a njëzet minutash. Oh, harrova! Keni edhe pak byrek në aneks, po të doni.

— Ik, nuse, se të gjitha i kemi, — i tha Lirimi.

Unë qesha padashur, se e dija që Lilianës i vinte inat kur i thoshin nuse. Lirimi më shkeli syrin, e takoi gotën me timen dhe, si e piu me fund, më pyeti:

— Ke ndonjë hall që je kështu?

— Po, e kam një.

Ai mbushi përsëri gotat dhe priti në heshtje. Nuk dija nga t'ia filloja. S'e kisha menduar kurrë aq të vështirë, aq të ngatërruar një gjë që më ishte dukur krejt e thjeshtë. Kurse tani që kisha thënë e kam një hall, çfarë t'i tregoja? Nuk dija asgjë. Unë vetëm sa e ndieja që shkaku i pushimit tim nga puna nuk ishte ajo që kishte ndodhur në stacionin e trenit në Fier. Mirëpo, në qoftë se nuk ishte vërtet ky shkaku, cili ishte atëherë? Para se të nisja të tregoja, po llogarisja me mendje se sa kohë do të kërkonin

ato që do të thosha, ato qindra vogëlsira, një  
këtu e një atje, një dje e një sot, që mua  
më dukeshin se kishin mbushur kupën time  
te Dyr Dema. Ja, kjo më dukej krejt e pa-  
mundur për natyrën dhe aftësitë e mia. Ajo  
që unë mund të tregoja më qartë dhe më  
saktë ishte historia e Fierit. Vetëm që andej,  
duke u nisur nga më e dukshmjat e nga më  
e afërta, mund të shkoja te më të paduk-  
shmet e te më të largëtat, vetëm që andej  
mbase mund të niste halli im, mbrapsht.

Dhe fillova të tregoja.




Atë ditë do të shkonim në Sarandë.

Ishte një ekskursion që e bënte vetëm reparti ynë i veglave. Idenë për në atë qytet në fillim e pati Donika. Pastaj me atë punë u mor vetë përgjegjësi i repartit, Gjentian Spahu. Listën me emrat e atyre që dëshironin të vinin Donika ia dha atij dhe ai bëri disa ndryshime. Hoqi dy djem që kishin bërë thyerje të disiplinës në punë dhe, siç tha Mësall Sula, i mbushi mendjen Natali Hajredinit që të vinte edhe ajo me ne. Njëherë ekskursioni që duke dështuar, sepse nuk plotësoheshin vendet, por ditët e fundit mbetën shumë jashtë listës, ngaqë kërkuan të vinin pothuajse të gjithë. Jashtë listës më kishin lënë edhe mua. U habita kur e mora vesh fare rastësisht dhe pyeta menjëherë

Donikën. Ajo më tha se, kur e kishte bërë listën, emrat tanë nuk i kishte shënuar, sepse «i dinte përmendsh». Qesha dhe shkova në zyrën e Gentianit. Qeshi edhe ai kur i tregova si ishte puna dhe më premtoi se do ta rregullonte vetë. «S'ka problem», — tha. U largova i qetë.

Megjithatë, sesi më vinte. Përse Donikës ia kishin shënuar emrin, kurse mua jo? Si mund ta mendonin që ajo të shkonte vetëm në Sarandë, kur ne ishim të fejuar dhe punonim në një repart? As xha Kasem i nuk do ta linte plakën vetëm e jo më unë! Me siguri kanë harruar, thashë me vete dhe s'e vrava më mendjen për këtë.

Në mëngjes u ngrita herët, menatë. Do të bëja një gjysmë ore rrugë më këmbë për të shkuar te Donika, që mund të mos ishte ngritur nga gjumi. E njihja të fejuarën time pak harraqe, ndaj duhej ta parashikoja edhe këtë për të arritur trenin në kohë. Para se të dilja, më tërhoqi vëmendjen një copë letër e bardhë dhe një pesëdhjetëlekësh, vendosur nën cepin e taketukës mbi tryezën e kuzhinës. E mora letrën dhe lexova: «Fred vëlla! Ca para më shumë janë një mundësi për ca qejf më shumë. Rrugë të mbarë!» U preka dhe disa çaste mbehta ashtu në këmbë duke menduar për natyrën e veçantë të vëllait tim të madh. Si ishte ashtu ai njeri! I pavëmendshëm e shpërfillës ndaj disa gjërave të zakonshme dhe po aq i kujdesshëm ndaj disa të tjerave. Mbrëmë,



kur unë i thashë se do të shkonim në ekskursion në Sarandë, ai as që e ngriti kokën nga libri që po lexonte dhe vetëm sa më tha «e kalofshi mirë» duke shënuar diçka në një skedë. Kurse ja, nuk kishte harruar të më linte atë shënim që mua më krijoi menjëherë një gjendje të ngazëllyer. Kjo ishte shenjë e mirë për nisjen...

Në rrugë yjet kishin filluar të veniteshin. Asgjë nuk lëvizte, as njerëz dhe asnjë gjethe në pemët e rrugëve. Kjo tregonte se edhe ajo ditë do të ishte e kthjellët dhe pa erë, ashtu siç e kishim pritur. Ora po i afrohej katëregjysmës dhe në dy dyqane bulmeti punëtorët e transportit i kishin shkar-kuar arkat me qumësht e kos anës trotuarit. Futa një karamele në gojë dhe, pa u shkrirë e gjitha, ndeza një cigare. Nuk kisha pirë kafe në shtëpi, sepse s'doja të zgjoja vëllanë, që ishte bërë me fëmijën e tretë. Ishim ngushtuar shumë në atë apartament me dy dhoma e një kuzhinë dhe unë mezi prisja të mbaronte pallati që po ndërtonte ndërmarrja jonë. Punoja çdo pasdite nga dy-tri orë, si edhe të dielave. Aty nga fundi i korrikut duhej të përfundonte. Atëherë edhe do të martoheshim. Kështu kishte thënë Donika. Po edhe sikur të donim ndryshe, s'kishim asnjë mundësi tjetër. Do të punonim, do të merrnim shtëpi dhe do të prisnim gushtin apo shtatorin...

Ëndrra e shtëpisë sikur ma kujtoi prapë e ma nxiti më të fortë dëshirën për një ka-

fe. Shpejtova hapat, por kjo qe një gjë e kotë, sepse në atë orë nuk ishte i hapur asnjë lokal. Pi te stacioni i trenit, thashë me vete dhe, pa e kuptuar si e kisha bërë rrugën, u gjenda te pallati i Donikës. Ajo banonte në katin e parë me të ëmën e të atin. Për të mos bërë zhurmë, më kishte porositur të trokisja në xhamin e dritares së kuzhinës ku do të flinte atë natë. Lëvizja gishtërinjtë dhe thonjtë bënë një kërkëllitje gati të pandjeshme. U çudita kur në errësirën përtej xhamit shqova kokën e Donikës. Ajo më futi në kuzhinë dhe më bëri shenjë të ulesha në divan. Vuri xhezven në plitkën e vogël dhe më buzëqeshi. Hapa gojën gati për të thirrur nga gëzimi i kafesë, por ajo vuri gishtin mbi buzë që të heshtja dhe doli në korridor.

Donika ishte bërë gati me kohë, sikur të mos kishte mbyllur sy nga qejfi i udhëtimit. Ishte hera e parë që shkonim bashkë në një qytet tjetër dhe ajo më ishte lutur të mos flinim në një dhomë në hotel, sepse i vinte turp nga shoqet. Por unë si kisha thënë as po, as jo.

Kafeja u fry shumë dhe u derdh. Donika erdhi me vrap dhe e hoqi nga plitka para se të ngrihesha unë nga divani. Ajo rrudhi buzët dhe shikoi nga unë, po mua s'më erdhi keq që u derdh kafeja, sepse nuk e doja me shkumë. Ndeza një cigare dhe fillova të pija kafënë duke vështruar Donikën. Kishte veshur një bluzë të lehtë në ngjyrë bezhë

dhe fund të kuq. Flokët i derdheshin deri mbi supe, të butë e me një shkëlqim të kuqërremtë. Në sy kishte diçka të veçantë, bebet sikur i qenë zmadhuar e nxirë më shumë. Ajo e ndjeu kureshtjen time dhe buzëqeshi. «Një çikë fare», — pëshpëriti dhe më shkeli syrin. E kuptova menjëherë atë të veçantën e saj: kishte bërë qepallat me laps. Por s'ishte vetëm kjo. Bebet e syrit nuk ia zmadhonte as lapsi dhe as mungesa e dritës së diellit. Në sytë e së fejuarës sime atë mëngjes unë vura re një si mahnitje a si dëshirë që s'arrita ta kuptoja ç'ishte, por që e ndjeva se kishte të bënte me mua, me pralinë time në atë dhomë. Qesha pa të keq me druajtjen e saj. U ngrita, vura filxhanin mbi tavolinë dhe e kapa Donikën nga supet. Nuk më ishte dukur kurrë aq e freskët, aq e re, aq e bukur sa atë çast.

E afrova pranë dhe e putha, gjatë. Ajo më shtyu lehtë dhe bëri «shët» me buzët e mbledhura si të dëshironte një puthje tjetër nga unë. Donte të thoshte se mund të ngrihej i ati ose e ëma. Më mori nga dora dhe, duke hedhur në sup çantën e kuqe si fundi, më nxori në rrugë.

Kur arritëm te stacioni i trenit, mali i Dajtit kishte nisur të përflakej nga dielli që po lindte.

Në tren u ulëm në fund të vagonit. Ishte një kupe me gjashtë vende, por ne qemë katër veta. Unë e Donika i kishim kthyer shpinën derës dhe vështronim gati të gjithë va-

gonin. Kujtim Sauku dhe Luftar Zyka rrinin përballë nesh dhe mund të shihnin vetëm peizazhin përjashta.

Në një kupe më poshtë, në atë të kundërt me tonën, kishin zënë vende Gentian Spahu dhe Mësall Sula, që kishin vënë në mes Natali Hajredinin, e cila para disa kohësh qe shkarkuar si shefe e planit, por, siç kishte thënë Dyrri, do të vazhdonte të kryente atë detyrë derisa të gjendej një ekonomiste tjetër «po aq e talentuar». Ajo më vështronte në një mënyrë të tillë që më dukej sikur do të ngrihej nga çasti në çast e do të vinte për të më thënë një gjë të gëzueshme. Ishte nga ato që i quajnë mjaft tërheqëse si femra, me tipare të theksuara e sy të zinj të mëdhenj, më të zinj e më të mëdhenj se të gruas sime.

Donika më ra me bërryl. «Ç'e sheh ashtu», — më pëshpëriti. Desha t'i thosha se ajo m'i kishte ngulur sytë sikur donte të më shprehte diçka, por nuk fola, s'kisha qejf që Donika të mendonte se po shfajësohesha. Kujtimi, që e kishte vënë re lëvizjen e saj, ktheu kokën prapa dhe qeshi.

— Qenka treguar zemërgjerë Dyr Dema, — tha. — Ia paska besuar dhëndrit shefen e «talentuar».

Qeshëm edhe ne, por s'folëm. Në ndërmarrje kishte shumë mërmëritje për lidhjet e tyre. Ato filluan sidomos kur Natalinë e bënë shefe të planit. Atëherë u zbulua një gjë që na habiti të gjithë. (Kjo sigurisht dihej

më parë nga disa). Natali Hajredini nuk ishte vajzë dëshmori, siç qe përhapur, por e bija e një kolaboracionisti të pushkatuar nga partizanët në verën e vitit 1944. Se si kishte zbritur e ëma në Tiranë dhe si qe martuar për së dyti me një ish-tregtar të papërzier me pushtuesit, këto qenë hollësi që, më mirë se cilido tjetër, i dinte Mësall Sula. Ai dinte gjithashtu hollësi për martesën e vetë Natalisë me një tip që shihej përherë mbi një motoçikletë të vjetër «Guzzi», të modifikuar à la «Suzuki». Dinte edhe shkaqet që e detyruan Dyrri Demën ta shkarkonte si shefe plani. Por kjo ishte tjetër gjë. Më shumë përshtypje kishte bërë emërimi sesa shkakimi i Natalisë, sepse fjalët që u thanë shprehnin habinë se si një grua me biografi të tillë mund të vihej në një vend me aq rëndësi për ndërmarrjen tonë. Ne punëtorët i themi pa druajtje ato që mendojmë për drejtuesit. Dhe jo sepse «nuk kemi ç'të humbasim» (kushdo që bëhet i pakëndshëm për shefin e tij, diçka humbet, më pati thënë njëherë im vëlla), por sepse kështu jemi mësuar që prej tridhjetë vjetësh. Megjithatë jo gjithmonë fjala jonë zë vendin e duhur. Se ja: Shpresa Bilali, zëvendëssekretarja e organizatës-bazë të Partisë, e kishte kundërshtuar vendosjen e Natalisë në atë post, por Dyrri kishte gjetur mënyrën për ta bërë të pavlefshëm atë kundërshtim duke deklaruar kudo se nuk kishin ku të gjenin një ekonomiste më të talentuar se Natali Hajredini. Sidoqoft-

të, nëse kishte vërtet diçka për të cilën mund të shquhej ajo grua, ishte bukuria e saj dhe ajo shprehja dashamirëse, e përjetshme në fytyrë që e bënte të dukej sikur rronte vetëm për t'u dhuruar mirësi të tjerëve. Për këtë e donin shumë burra dhe e urrenin shumë gra.

— Unë e di ç'po mendon, — më tha Luf-tar Zyka. — Është e vërtetë që ajo...

Ai e la përgjysmë fjalën. Duket i erdhi rëndë prej Donikës të vazhdonte më tej. U skuq në fytyrë dhe pothuajse gjatë gjithë rru-gës nuk foli më.

Ishte një djalë trupvogël, rreth të tri-dhjetave. I heshtur shumë dhe tip studiuesi, siç mund ta cilësoje sapo ta shikoje. Dinte gjuhë të huaja dhe në byronë teknologjike e mbanin ndër specialistët më të mirë. Por ishte i druajtur si një vajzë dhe tepër naiv. Unë e doja se që i çiltër. Vinte shpesh te ne dhe ndiqte me vëmendje zbatimin e ski-cave që kishte bërë vetë. I pëlqente axhus-teria dhe nganjëherë punonte me limë ndonjë nga stampat e mia. Një ditë më tha se dë-shironte të ikte nga byroja e të vinte të pu-nonte aty, në repartin e veglave. I thashë se mirë ishte atje në byro. Ai buzëqeshi hi-dhur. Deshi të më tregonte diçka, por duket ndërroi mendje dhe më pyeti nëse kisha kohë të takoheshim ndonjë pasdite. Kur të du-ash, i thashë, pa e pyetur përse kërkonte të më takonte... M'u kujtua ajo pasdite te klubi i Avdiut dhe më erdhi keq për të.



Nxora paketën, i dhashë një cigare Kujtimit, se Luftari nuk e pinte, por nuk arritëm ta ndiznim. Te ne u afrua Ylli Berati që u përkul mbi mua dhe më tha në vesh:

— Po bëjnë një gjë të poshtër, më duket. I thanë konduktorese që një biletë do ta paguash ti, se ti je jashtë liste.

Më hipi menjëherë gjaku në kokë. Më erdhi të ngrihesha e të shkoja t'i thosha Gentian Spahut se ishte një palo burrë që s'e mbante fjalën as për një copë biletë, lëre pastaj për më shumë. Por vetëm sa ndeza cigaren dhe, si e thitha nja dy herë, çuditërisht më ra krejt inati.

— E, mirë, — i thashë Yllit, — i paguajmë dhjetë lekë, s'është ndonjë gjë e madhe.

— Jo, nuk ke për t'i paguar! — u hodh Donika. Unë u ktheva nga ajo dhe e vështrova pak i habitur. — Nuk ke për t'i paguar ti! — përsëriti ajo. — Këtu janë tetë të huaj, që s'punojnë fare në ndërmarrjen tonë. Ata ta paguajnë vendin e tepërt, jo ne!

Dukej shumë e zemëruar dhe unë nuk dija si ta qetësoja. Kisha frikë mos ngrihej e shkonte t'i shfrynte Gentian Spahut. Ai mund t'ia kthente, mund ta fyente, dhe kësaj ia kisha më shumë frikën.

— Rri, — i thashë, — se erdhi konduktorja.

Dhe futa dorën në xhep. Por Donika nuk më la t'i nxirrja paratë.

— Të lutem, — i tha gruas që rrinte më

këmbë, — do të na presësh pak sa të sqarohjmë diçka.

Por konduktorja nuk priti.

— S'ka gjë, — tha. — Mos e prishni gëzimin e ekskursionit.

Ajo na buzëqeshi dhe u largua për në vagonat e tjerë. Mbetëm si të ngrirë dhe për disa çaste ramë në një zymti të bezdisshme.

— Bëjmë një pesëqindësh? — tha Ylli dhe, pa pritur përgjigje, shtyu Kujtimin dhe u ul përballë meje.

Nisëm të luanim në heshtje, por pak nga pak loja na rrëmbeu dhe filluam të qeshnim e të thërrisnim për letrat e njëri-tjetrit. Mua po më ecte shumë. Lojën e parë e kisha fituar me nja njëzet pikë diferencë dhe në të dytën udhëhiqja njëqind e tetëdhjetë me gjashtëdhjetë.

Nuk di sesi, sytë më shkuan padashur te kupeja e përgjegjësit. M'u duk sikur Mësall Sula po i bënte shenja Donikës. Ktheva kokën nga ajo dhe u binda që ishte vërtet e ashtu. Ai qeshte dhe i përmallej me ca sy si të perënduar që ma merrte mendja se vetëm neveri mund t'i ngjallnin njeriut. Edhe Donika e qesëndiste me sy, por në mënyrë mjaft tallëse. As kjo nuk më pëlqeu.

Ylli ktheu kokën prapa.

— Lëre, — më tha, — se e bëjnë qëllimisht. Duan të të provokojnë.

— Mua të më provokojnë?! — u habita.

— Lëre, vazhdo lojën, — përsëriti Ylli.

— Isha aty kur thanë ca fjalë. Kanë bërë edhe

plane, më duket, po ti mos çaj kokën. Duan të provojnë se sa burrë je. Kanë marrë edhe kovaçin me vete për trim.

— Ç'thua budallallëqe, Ylli, po të, hidh!

Ai hodhi dysh. Plasi e qeshura se vetëm unë mund t'i merrja letrat e shtruara. Ylli bëri zhurmë dhe e mori prapë dyshin. Kishte të drejtë. Ishte ngatërruar për shkakun tim. E prishëm atë lojë dhe pas pak e lamë fare.

— Mblidhuni një minutë këtu, të gjithë!

— thirri Gentian Spahu, sapo zbritëm në sheshin e stacionit të Fierit.

Ne u afruam aty ku kishte qëndruar ai dhe pritëm që të fliste. Por përgjegjësi ynë e kishte gjithmonë të vështirë fillimin e asaj që do të thoshte, sado e parëndësishme të ishte. Vuante kaq shumë për të kërkuar fjalë të zgjedhura, që t'i përshtateshin pozitës së tij si shef, sidomos emrit aq tingëllues, fytyrës vezake me ato tipare të holla si të një femre të brishtë, trupit të gjatë e të drejtë si selvi, sa të vinte me të vërtetë keq për të. Të habiste me këtë lloj vetëdijeje për rëndësinë e tij, që e bënte të besonte se njerëzit prisnin gojëhapur ç'do të thoshte. Por më tepër të vinte për të qeshur kur e vështroje si merrte frymë thellë, si rrinte ashtu me gjoksin e gufuar e buzët të shtrën-

guara, aq gjatë sa ndonjëri nga ata që prisnin ta dëgjonin mbledhje buzët e sikletosur si ai. Edhe tani ashtu po rrinte, më shumë se një minutë. Më në fund shfryu dhe unë sikur u çlirova.

— E shikoni këtë makinë? — Ai buzëqeshi duke na treguar me dorë një autobus në ngjyrë të kaltër. — Kjo do të na çojë në brigjet e bukura të Jonit. Por, shokë, na ka dalë një problem i vogël: dikush këtu është i tepërt, dhe ky i tepërt duhet të mendojë vetë për udhëtimin deri në brigjet blu... — Buzëqeshi përsëri, si me keqardhje, pastaj shtoi: — S'kemi ç'të bëjmë. Shoferi nuk pranon të marrë as edhe një njeri jashtë vendeve.

Por këto fjalë të fundit i dëgjuam vetëm unë dhe Donika, sepse të tjerët, sapo kishin parë autobusin, ishin nisur për të zënë vendet.

Nuk kishte asnjë dyshim që «i tepërti» isha unë. Megjithatë, ende nuk po u besoja veshëve. Si mund të bëhej një gjë e tillë? Nuk ishte fare e rregullt nga çdo anë që ta vërtisje; nuk ishte shoqërore, nuk ishte njerëzore, nuk ishte e ndershme, ishte fyese, poshtëruese. Apo mos vallë pikërisht këtë kërkonte Gentian Spahu, të më poshtëronte në sy të shokëve, para së fejuarës? «Ç'borxh i kisha atij njeriu?» — pyeta veten dhe atë çast nuk m'u kujtua asgjë veç ndonjë fërkimi për punën apo për ca gjëra që mund të ishin mbledhur dalëngadalë, një dje e një sot. «Po

mirë, — mendova, — këtë lojë kaq të ulët e të trashë kanë zgjedhur Gentian Spahu e Mësall Sula për të shfryrë inatet e punës?!...» Po çuditësha vërtet. «Megjithatë, — thashë me vete, — unë nuk do t'i lë këta të më bëjnë gazin e botës». Ndaj iu afrova Gentianit dhe e pyeta:

— Mos jam unë ai «i tepërti»?

— Ti je, — ma ktheu gati me kënaqësi dhe futi në gojë një kokërr lajthi që kërciti midis dhëmbëve.

— Po ne sikur u morëm vesh një herë, dhe ti më the se do ta rregulloje gabimin e Donikës.

— Epo njeriu zihet edhe ngushtë. Ja që s'e rregullova dot.

Më habiti dhe m'i ngriti nervat në çast ky qëndrimi i tij kaq shpërfillës, ndaj i bërtita:

— Ç'flet, mor ti! Si nuk e rregulluake dot kur këtu ka nga ata që kanë marrë me vete edhe çupat e dajave e të hallave?!

— Dëgjo këtu ti, — m'u kërcënua ai, — mendjemadhësinë e të bërtiturat ruaji për atë, në shtëpi (tregoi Donikën me kokë), jo për mua. Se me mua i ngarkon drutë ndryshe ti.

Ishte me të vërtetë e padurueshme kjo sjellja e tij, po unë u mundova ta shtroja pak acarimin dhe e pyeta i përmbajtur:

— E si kështu? Si i ngarkuakam ndryshe, Gentian, se po më habit.

Por këtë ai e mori si druajtje nga ana

ime, ndaj e çoi edhe më tej kërcënimin e tij.  
— Ta tregoj unë kur të kthehem, — tha.  
— Ndërsa tani, ti, ja ku e ke trenin, bën mirë të marrësh biletë para se të niset e t'ia mbathësh për Tiranë, kurse kjo (ia bëri prapë me kokë nga Donika) le të vijë në Sarandë, se ka vendin e saj. Ose zgjidheni vetë si do të bëni, por me ne vetëm njëri do të vijë!

Po e dëgjoja si në ëndërr. Sytë më ishin mjegulluar nga këto fjalë të fundit dhe e shikoja turbull. Mudohesha të dalloja ndonjë shenjë shakaje në ato që kishte thënë dhe në fytyrën e tij, por fjalët më dukeshin si fshikullimë kamxhiku që vazhdonin të më digjnin gjithë trupin, kurse fytyra si një ngërdheshje tallëse e përçmuese. Nuk mundesha më të mendoja për asgjë. Mezi arrita të dalloja që po largohej. Më kujtohet që e ndoqa pas Gentianin, që i vura dorën në sup, që e ktheva nga vetja dhe... Nuk e di, e qëllova unë atë, apo ai mua? U përmenda vetëm kur Donika më futi krahun dhe më tërhoqi drejt stacionit...

Për atë që kisha bërë qeshë plotësisht i ndërgjegjshëm vetëm pasi piva kafënë që më solli Donika dhe pasi ajo ma përshkroi edhe një herë atë që kishte ndodhur.

— Nuk duhej ta bëje këtë, Alfred! Nuk duhej... — përsëriste ajo gati për të qarë.

Më erdhi keq për të dhe turp nga vetja. Unë isha pak gjaknxehtë, por askush nuk më njihte për njeri të sherreve, dhe as kisha bërë ndonjëherë sherre të tilla. As me fjalë nuk grindesha gjatë me njerëzit. Kur nuk duroja më, largohesha pa folur derisa më binte zemërimi. Dhe inat nuk mbaja kurrë. Por këtë herë nuk kisha ditur të përmbahesha dhe sesi më dukej vetja, si në një udhë pa krye.

— Hë, — pyeta Donikën, — ç'do të bëjmë?

Ajo ngriti supet.

— Do të shkojmë në Sarandë?

Ajo ngriti prapë supet.

— Jo, — tha pas pak, — mua më vjen turp.

— Nuk shkojmë, — i thashë. — Po si, do të kthehemi në Tiranë?

Ajo u mendua gjatë. Pastaj, e qetë, tha:

— Shkojmë në Lushnjë, te Flora. S'kemi genë që vjet në verë.

— Shumë mirë, — i thashë dhe u ngrita të shihja orarin e trenave.

Flora ishte motra e madhe e Donikës dhe unë e doja, sidomos fëmijët e saj të rritur

që ishin mjaft të afruar me njerëzit e tyre në Tiranë.

Kur po kaloja pranë tryezës së dy të rinjve, ata më buzëqeshën dhe më përshëndetën. Njëri, ai që dukej pak më i madh e me trup sportisti, u afrua te sporteli i biletarisë dhe më tha:

— Isha aty edhe kur u grindët me fjalë. Ajo, e fejuara është? — pyeti duke parë nga Donika.

— Po.

— Bëre shumë mirë. Bashkë me Gimin, atë shokun tim, do të vinim të dëshmonim edhe në polici, po të ishte nevoja.

— Faleminderit, — i thashë, i dhashë dorën dhe u largova duke zënë Donikën për krahu.



Në punë u kthyem të hënë, bashkë me ata që kishin qenë në Sarandë. Dy ditë ndenjëm te motra e Donikës, dhe s'e kaluam keq. Shkuam edhe në Divjakë. Atje Donika u mrekullua, u mahnit nga pylli i pishave dhe nga hapësira e plazhit. Aq i pëlqeu ky vend, sa më tha se një herë tjetër duhej të vinim për të ndenjtur gjatë, ndoshta për të kaluar gjithë lejen e zakonshme. Vijnë, i thashë, por tani kemi halle të tjera... Ajo nuk foli dhe mua m'u duk se nuk i kishin bërë shumë përshtypje fjalët e mia. Ç'pati për t'u bërë, u bë, tha. Tani mos e mbaj më mendjen tërë ditën aty. Dhe unë ndjeva në gast një mbështetje e siguri që do ta dëshiroja për shumë kohë.

Në repart ishte qetësi e plotë. Unë hyra i

pari dhe, nga që s'dija ç'të bëja, nisa të vësh-  
troja me radhë tryezat e punës që i kishte  
mbuluar një shtresë e hollë pluhuri. Duhej  
të filloja punë, si të mos kishte ndodhur as-  
gjë, por nuk më bëhej të zija gjë me dorë.  
Ndieja një lloj plogështie që më sillte gjumë,  
dhe njëkohësisht njëfarë padurimi që më  
nxiste të ikja fare nga ai vend dhe të kthehe-  
sha pasi të kishte mbaruar gjithçka rreth  
meje. Ja, mendoja, ata do të fillojnë të vijnë  
njëri pas tjetrit dhe mua do të më  
vështrojnë si një kafshë të rallë në  
kopshtin zoologjik. Pastaj do të bëhet  
mbledhja e dikush do të habitet, dikujt do t'i  
vijë keq që ndodhin këto gjëra e ndonjë  
tjetër kushedi ç'mund të thotë. Mund të më  
qortojnë, mund të më fyejnë, mund të më për-  
buzin... dhe të gjitha në sy të të gjithëve  
e në sy të Donikës. E pastaj, çfarë? U ina-  
tosa me vetveten dhe u habita pse drejtin  
edhe unë vlerësoja vetëm atë gjest të pa-  
matur e nuk mendoja për shkaqet që më  
çuan deri aty. Në mënyrën më të pashpje-  
gueshme, më sillej nëpër mendje kënga e  
Halil Gashit. E kisha dëgjuar në tren kur  
po ktheheshim nga Lushnja dhe më qe kuj-  
tuar gjyshja që e donte aq shumë atë kë-  
ngë, sidomos kulmin e saj, kur Halil Gashi  
i ri e vret Beqir agën në mes të kafenesë,  
sepse i ka fyer motrën Hajrie e vetë atë.  
Në këtë kulm gjyshja qante pa menduar për  
shkaqet të tjera, kurse unë, për rastin tim,

unë duhej të mendoja si t'ua bëja të ditur edhe të tjerëve se ç'njerëz ishin Mësall Sula, Gention Spahu dhe ndonjë që u shkonte pas. Nuk kisha pse të trembesh. Ata duhej të kishin frikë, se ata ishin përlyer në ca punë të ulëta. E ndoshta edhe kjo histori banale s'ishte gjë tjetër veçse një kurth i paramenduar, por mbase jo tamam me këtë fund. Sigurisht, jo me këtë fund që, megjithatë, për ata ishte i mirë... Ky mendim sikur bëri një lidhje të vetvetishme në mendjen time të trazuar. Si nuk e kisha kuptuar që unë isha bërë me kohë i mërzi-tshëm e i padëshirueshëm për këta njerëz, dhe se një ditë ata do të gjenin një mënyrë për të më hequr qafe? Veçse aq të lehtë nuk do ta kishin. Nëse ata dëshironin të më hiqnin qafe, unë dëshiroja t'u qëndroja, bile në atë mënyrë, sa të çuditeshin të gjithë... Duke më habitur edhe vetë mua, ai padurimi që më nxiste të ikja fare që andej e të kthehesha kur të kishte mbaruar gjithçka, më qe zëvendësuar me një lloj tjetër padurimi: me ngutjen që mbledhja apo ajo që do të bënin ata të fillonte sa më parë.

Zhurma e zakonshme e punës s'kishte më shumë se një orë që kishte filluar dhe unë ende s'kisha prekur gjë me dorë. Megjithatë, pa e ditur ç'bëja, mora një stampë dhe nisa

ta montoja. Pas pak m'u afrua Besnik Zajmi, brigadieri, dhe më pyeti:

— Hë, Alfred, ç'ke kështu?

Unë ngrita kryet dhe e vështrova.

— Hiç, — i thashë, — jam pak i mërzi-tur. E more vesh ti?

Ai pohoi me kokë. Pa stampat e renditura mbi tryezë dhe më tha «shumë mirë», pastaj «mos u mërzi» dhe u largua. Ishte një djalë i pashëm, me fytyrë të rrumbullakët, me trup të fortë e pak më të lartë se unë. Ishte një njeri që s'dinte të bërtiste kurrë; por punët i shkonin mirë. Ne i bindeshim dhe brigada e tij mbante pothuajse gjithë prodhimin e veglave të ndërmarrjes. Edhe për këtë më kishte ardhur inat dhe kisha bërë fjalë, sepse dy brigadat e tjera bënin pajisje e stampa për modele të reja që rrallë hynin në punë. Magazina ishte mbushur deri në tavan me prodhime të tilla. Megjithatë, Besnik Zajmin nuk e kishte shumë qejf Dyr Dema. Ishte njeri i mbyllur dhe atij nuk i pëlqenin këta tipa. Besniku e dinte këtë, por thoshte se nuk i bëhej shumë vonë. Nuk shkonte as të shtunave në «Drini» me «ata», megjithëse Gentiani dhe Mësalli e kishin ftuar disa herë. Ky qe bërë një rregull i tyre dhe çdo të hënë Mësalli tregonte për humorin e Dyrrit, që «i kishte vdekur së qeshuri».

Një mbrëmje kisha qenë edhe unë me atë grup.

Ishte ditë rrogash, tre vjet më parë. Gusht. Mësalli erdhi te tryeza ime e punës dhe më dha një cigare. Nxori çakmakun me gaz dhe ma ndezi. Dukej i gëzuar dhe pak i pirë.

— Ishim me Dyrin, — më tha. — Hëngrëm nga një fërgesë e bërçollë te klubi i Avdiut dhe i rrëkëlyem nga dy gota verë. Folëm edhe për ty...

Ai heshti disa çaste duke më vështruar në një mënyrë të tillë, si të më mbante të fshehtë një lajm të gëzueshëm.

— Të do shumë ai, — vazhdoi, — dhe një kunatin tënd e paska mik. Hë, çfarë Dyrri që është!

— E di, — i thashë, — po pse më do shumë drejtori?

— Është djalë i mirë, na tha. Pastaj na pyeti: hë, si thoni, ta marrim me vete sorte? Patjetër, i thamë ne. Dhe ai më ngarkoi mua që të të lajmëroja.

— Sonte?! E ku kështu? — e pyeta.

— Në «Drini», pra! Nuk e di ti që «dora jonë» shkon çdo të shtunë atje?

— E di, — i thashë dhe i buzëqesha. — Po kur do të takohemi?

— Në shtatë atje.

Ai më shkeli syrin dhe u largua duke u tundur majtas e djathtas si patok. Ashtu ecte. Këmbët i hidhte njëren para tjetrës, kurse krahët i lëvizte si të hallakatur.

Nuk më kishte pëlqyer asnjëherë ky njeri. Kurrë s'e kisha marrë vesh se ç'punë bënte.

Hynte e dilte në repart dhe në tryezën e tij s'e kisha parë të rrinte më shumë se një orë. Ishte brigadier i Donikës, kurse Donika zëvendësbrigadiere. Qeshnin të gjithë me këtë brigadë prej dy vetash. Por Mësalli nuk qeshte. Ai i përfitonte kushtet lehtësuese si të gjithë brigadierët e tjerë. Ai qeshte me ata që qeshnin me këtë brigadë, e cila kishte vetëm një anëtar. «Tymi im të shkojë drejt», — thoshte dhe dilte nga reparti duke u tundur majtas e djathtas.

Në atë kohë ne nuk ishim fejuar, por Donika vinte ndonjëherë në tryezën time dhe ankohej për Mësallin. «Do të iki në ndonjë brigadë tjetër, — më thoshte, — megjithëse aty jam rehat. M'i ngre nervat ai. Le që nuk punon fare, po ka filluar edhe... Si kërmill më duket kur lëpihet...» Ajo e priste fjalën menjëherë, sapo kujtohej që po fliste para meje. Një ditë qe inatosur me të vërtetë. Donte të më thoshte diçka, po sikur ngurronte. Më në fund e tha: Mësalli merrte pajisje për riparim dhe i bënte hyrje në magazinë si të reja. Tani e kuptoj pse dalim ne me realizim aq të mirë, tha ajo dhe më pyeti si të vepronte. I thashë të mos e lejonte t'i bënte këto gjëra. Ajo tundi kokën dhe shkoi në vendin e saj të punës.

Po atë ditë Donika erdhi prapë te tryeza ime dhe u mbështet në morskë, ashtu siç bënte kur e thërrisja unë.

— Ke filluar të bëhesh shok me Mësallin?

— më tha duke pyetur e pohuar njëkohësisht.

— E, — ia ktheva, — pse të mos bëhem, derisa është edhe shoku yt?

— Shoku im nuk është ai, — tha dhe buzëqeshi me ironi. — A e di ç'më thotë kur më pëshpërit si në vesh? Flet vetëm për punën por më afrohet te koka për të krijuar te ju përshtypjen e bisedave intime... Dhe, me sa duket, ia paska arritur qëllimit...

— Sigurisht, derisa ia ke dhënë vetë këtë mundësi.

Ajo më vështroi me inat, pastaj si me mosbesim, buzëqeshi dhe më ktheu shpinën. Unë e ndoqa me sy dhe ndjeva një kënaqësi të menjëhershme. Fjalët e saj për Mësallin i mora si një nxitje për mua, dhe një mendim që më kishte lindur m'u kthye pothuajse në bindje...

Në «Drini» shkova dhjetë minuta përpara. Aty gjeta vetëm Mësall Sulën. Ishte ulur në kolltukët e sallonit dhe pinte cigare; këmbën e djathtë e kishte hedhur mbi të majtën. Sapo më pa, u ngrit dhe më futi krahur. Shkuam e zumë vend në një tavolinë të qoshes, ku rrinin zakonisht ata.

— Këtë vend e ka fort qejf Dyrri, — tha Mësalli.

Unë nuk fola. Më vinte pak çudi që më kishin ftuar edhe mua në mbrëmjen e tyre të së shtunës. Më vinte çudi edhe me atë lloj rregulli për t'u mbledhur në një ditë të caktuar të javës. Sidoqoftë, po të mos mendoja se më kishin thirrur nga që Dyr Dema mund të kishte ndonjë nevojë për kuzatim, tim, që ishte drejtor në ministrinë nga varej ndërmarrja jonë, mua do të më bëhej qejfi që ata më kishin futur në rrethin e tyre të ngushtë. Kisha dëshirë ta njihja drejtorin, sepse për atë thuheshin fjalë të mira, sidomos jashtë ndërmarrjes, por edhe jo të mira, e këto brenda në ndërmarrje. Aq simpati kishte ai në njerëz që s'punonin te ne, sa askush nuk e përmendte emrin e ndërmarrjes, por e zëvendësonte atë me emrin e drejtorit. «Ti punon te Dyr Dema?» — pyesnin. Ose: «Dyr Dema po bën gjëra të mira, vetëm se të shtrenjta.» «Dyr Dema del përherë me tejkalime.» Dhe pak nga pak emri i ndërmarrjes ishte mbuluar nga emri i drejtorit, derisa një ditë vura re se ishte hequr edhe tabela me inicialet NSP, që ishte te porta e madhe. Kjo mund të ishte edhe për arsye të tjera, siç u tha: do të bëhej një e re e mirë dhe e shkruar më bukur. Por, në të vërtetë, e reja ende nuk po dukej... Kisha menduar që kjo simpati që krijuar nga nderet që bënte Dyrri duke shpërndarë disa prodhime të imëta të ndërmarrjes sonë në formë dhurate për ditëlindje apo martesë. Por tani po dukej se ajo vinte edhe nga mjeshtëria e tij për të mble-



dhur rreth vetes njerëz si ky Mësalli që vlenin sa për njëqind altoparlantë...

Mësall Sula u ngrit nga tavolina dhe shkoi në kuzhinë. «Të lajmëroj Muharremin që do të vijë Dyrri», — tha, me sa duket, për kuzhinierin. Pas pak u kthye bashkë me kamerierin.

— Ne mund ta marrim nga një dopio, derisa të vijë ata, — tha.

— I presim më mirë.

— Jo, ore, mund të vonohen, — nguli këmbë Mësalli dhe porosi kamerierin të sillte dy dopio e një «nga ajo fërgesa».

Sa kohë u vonua kamerieri, ne ndenjëm në heshtje. Mësalli më vështronte me të njëjtën buzëqeshje dashamirëse, që unë s'e besoja. Po mbështetësi është njeri i mirë, thashë me vete, dhe kot e gjykoj keq. Ashtu mund ta kishte natyrën. Dhe për natyrën e tyre njerëzit nuk janë as përgjegjës e as fajtorë...

— Do të të pyes për diçka, Alfred, — tha Mësalli, — por ta ngremë njëherë. Gëzuar!

— Shëndet! — i thashë dhe prita.

— Me Donikën si i ke punët? — pyeti pa kurrfarë hyrjeje.

M'u duk shumë e papritur kjo dhe s'dija ç'të thosha. Ngrita supet. Një çast u ndjeva tepër i fyer. Si pyeste kështu ky i pacipë?!

— Mos ma merr për ters, po... e kam parë që vjen çdo ditë te tryeza jote dhe bisedoni... — u ngut të shpjegohej Mësalli.

— Ajo me ty rri gjithë ditën në një tryezë, Mësall, dhe mua s'më ka shkuar në mendje se mund të ketë diçka midis jush, — i thashë me inat e me ironi. Dhe, për të mos i lënë

shkak të më keqkuptonte shtova: — Nuk kam asgjë me të, veç shoqëri. Të paktën tani për tani.

Ai buzëqeshi në një mënyrë të pakapshme.

— Flet shpesh për ty, — tha dhe prapë buzëqeshi, por këtë herë si të më thoshte se i dinte ca gjëra dhe nuk kishte pyetur kot.

Fillova të bezdisësja nga ai dhe e ngrita gotën pa e takuar me të tijën. Në atë kohë në hyrje të restorantit u duk Dyrri Dema, i shoqëruar nga tre të tjerë. Dy prej tyre i njihja: ishin Gentian Spahu dhe Bërhim Shtylla, kovaçi kryesor i ndërmarrjes; të tretin jo. Ai kishte një trup të rregullt, mesatar. Ashtu e kishte edhe fytyrën, të rregullt, që nuk të linte ndonjë përshtypje të veçantë. Ata u ulën dhe pak më vonë unë mora vesh se ai ishte bankier në një minierë jo larg Tiranës, ndërsa e shoqja i punonte magazinierë te ne.

Nisëm të pinim. Mezet erdhën njëra pas tjetrës dhe njëra më e shijshme se tjetra. Fërgesa me mëlçi e çikla mishi zhytej nën gjalpë; qefulli i pjekur zinte një pjatë të tërë të madhe, ndërsa biftekët me patate ende nxirrnin avuj. Të gjitha këto ishin edhe në menu, por neve na i kishin sjellë si për mik, me garniturë të zgjedhur sipas dëshirës ose pa garniturë. Kushedi sa do të na bjerë për të paguar, mendova dhe më erdhi keq që kishim porositur aq shumë. E dija që s'do t'i haja dot të gjitha.

— Pi verë, — më tha Dyrri. — Ajo të bën mirë; t'i bluan ç'të hash, jo raki, rakia të djeg.

E ktheva me verë, siç më tha ai, dhe gjithë kohën dëgjoja ata, se unë s'kisha për çfarë të flisja. Dyrri kishte vërtet humor, por jo sa të vdisje gazit, siç thoshte Mësalli të hënave. Ai humorin e bënte me fjalën e zgjuar, kur ndërhynte në bisedë, kur ngacmonte ndonjërin dhe sidomos kur donte të tallte dikë. Gjentianit, që dukej si i trishtuar dhe s'ishte i vëmëndshëm në bisedë, i tha: «Gjentian, o djallë, kur flas unë, mund të harrosh që më ke vjehërr, se vjehërrri ta fal, por nuk duhet të harrosh që jam drejtori yt...» Mësalli ia plasi të qeshurit dhe e qëlloi në sup Gjentianin. Në atë kohë, në tryezën tonë, një ndihmëskameriere e re mblodhi disa pjata bosh dhe u largua duke u tundur lehtë. Dyrri e ndoqi me sy, pastaj iu kthye Mësallit: «Mos qesh shumë, levend, se detyrat e tua na i lënë ne pleqve pastaj, e për ne janë tepër të rënda.» U mor vesh që e kishte fjalën për ndihmëskamerieren e re dhe qeshën të gjithë.

Kështu kaluan nja dy orë. Morëm poçe të tjera me verë dhe raki. Dyrri ngacmoi pak edhe kovaçin, por ky qe një humor shumë i tërthortë, që unë s'arrita ta kapja. Me sa munda ta merrja me mend, kovaçi bënte edhe punë vetjake në ndërmarrje (mashat u përmendën) dhe këto i jepnin racionin e përditshëm të rakisë: dy dopio dhe një fërgesë si ajo që po hanim. U qesh shumë me fjalët e kovaçit, që unë s'i kuptoja plotësisht, sepse i rrokulliste nëpër gjuhë e nofulla në mënyrë të tillë që kërkonte patjetër përkthyes. Megji-

thatë, edhe pse ai i linte frazat përgjysmë, ata i merrnin vesh për bukuri historitë që mërmëriste. Qesamin ata, qeshja edhe unë, fare kot.

— Po nuk ndenje gjatë me të, nuk e merr vesh se ç'thote, — më pëshpëriti Gentiani dhe filloi të më përthente humorin e kovaçit, i cili po tregonte se si i kishte bërë korte tërë mëngjesin e së dielës së kaluar «nuses së tij yll», Halimesë që «nuk plakej kurrë».

Kisha një javë pa bërë dashuri me «zonjën», tha kovaçi dhe vështroi Dyrrin gjithë nënqeshje. Por unë nuk jam derr si disa të rinj (i rrotulloi sytë nga ne, sidomos nga Mësalli). Se këta të rinjtë nuk i dinë ca punë kadënesh. Hë! Unë jam burrë i urtë, Dyrr, ti e di. I dua gjërat butë e ëmbël. Prandaj i thashë qysh në mëngjes herët Halimesë: O ylli i Bimit, hajde bëji një kafe lalës, se do të të kallëzoj ëndrrën që më çoi prej gjumit. Ajo mori xhezven dhe unë nisa t'i kallëzoja, me demek. Ishim ulur të dy në minder, i thashë. Hajër, o zot! ia bëri nusja. Hajër, posi, thashë edhe unë dhe vazhdova t'i kallëzoja se si unë e kisha vënë kokën në prehrin e saj, por nuk qe tamam ai prehër, qe ndryshe: më i butë dhe më i lëmuar, sikur ajo të kishte veshur fustan mëndafshi. Unë desha ta puth, por ajo më tha: «Shët, se na shohin». Unë e kapa për mes, kurse ajo më rrëshqiti për duarsh e më tha: «Prit një herë se do të të bëj një tas me hoshaf». Nuk e dua, moj, hoshafin! i thashë dhe u ngrita. Ajo buzëqeshi ëmbël e bukur dhe më tha: «E di unë se ç'do

ti!» Dhe erdhi të më puthte, por mua më doli gjumi dhe ngela pa u puthur me gruan time... Pu, pu, pu! ia bëri ajo dhe harroi kafen që u derdh... Kështu duhet, — e mbaroi kallëzimin e vet kovaçi, — jo si këta të rinjtë.

— Dhe na vështroi ne që tani po qeshnim me të madhe, sepse e kishim kuptuar që në fjalët e para ironinë ndaj atyre burrave që i përkëdhelin shumë gratë.

Gentiani deshi të më tregonte edhe diçka tjetër për gruan e kovaçit, që ai e kishte të dytën a të tretën, por kishte nisur të fliste banakieri. Një herë pata përshtypjen se ai po tregonte diçka të rëndësishme, sepse kokën e kishte ulur pak, si të rënduar nga mendimi, vetullat i kishte rrudhur fort dhe buzët i përvishte herë pas here si tepër i bezdisur për ato që po thoshte. Kur mora vesh se për çfarë po fliste ashtu, një zot e di se ç'më përmbaiti të mos ia plasja të qeshurit: ai po tregonte se si mund të bëhej një tavë me plëndësa, mburrej që plëndësa mund të gjente sa të **doie** dhe se tavën e bënte vetë. Pjesa e fundit e tregimit ishte kjo: «Kur plëndësat janë bërë të bardhë, po të bardhë fare ama, merren, futen në një tenxhere me presion, zihen mirë, po mirë fare ama, dhe pastaj futen në tavën e dheut, që dërgohet në furrë... Atëherë të më thuash mua se ç'po ha!»

Fillova të mërzhitesha pak, po tamam në këtë kohë Dyrr Dema nisi të tregonte se si i kishte shkuar një vajzë në zyrë dhe i kishte kërkuar të kalonte në byronë teknologjike. «E përse të të çojmë atje?» — e kishte pye-

tur ai dhe ajo i qe përgjigjur: «Se mos janë më të bukura ato që keni marrë atje?!» Dyrri kishte qeshur me naivitetin e saj dhe i kishte thënë se në byro nuk i zgjidhnin nga bukuria që kishte koka jashtë, por nga ajo që kishte brenda. «Ashtu?: — ishte çuditur vajza. — Më falni, shoku drejtor, — i kishte thënë, — unë e shkreta kujtoja se i zgjidhni vetëm nga pamja e jashtme...» Dhe sikur ishte larguar jo aq e bindur. Qeshëm më tepër ngaqë Dyrri e tregoi bukur, duke imituar zërin dhe habinë e vajzës. Pastaj ai m'u drejtua mua dhe më pyeti për kunatin. Më tha se ishte burrë i aftë dhe njeri i mirë. Unë mendova se tani do të mësoja edhe arsyen e ftesës në atë «mbledhje», siç i thoshin ata. Por u zhgënjeva. Drejtori më tha se im kunat ishte interesuar për mua dhe se ai, Dyrri Dema, i kishte bërë diçka, një shërbim të vogël.

Më erdhi mirë që ishte kështu. Nuk do të doja që ai të kërkonte të ndërhyja për ndonjë gjë tek im kunat, sepse nuk kisha dëshirë të përzihesha në punë që s'më takonin. Nuk më pëlqente as të bëja e as të më bënin nderë me paramendim.

E ngrita gotën e verës me kënaqësi dhe me simpati për drejtorin.

— Gëzuar, shoku drejtor! — e urova. —  
— Në dasmë të fëmijëve të tjerë e të nipave!  
— shtova duke e takuar gotën me të gjithë.

— Gëzuar, Alfred! — ma ktheu Dyrri. —  
— Dhe me një nuse të mirë! Se djemtë që nuk martohen vetë, i martojmë ne pastaj, ose i çojmë në byro teknologjike...

Qeshëm dhe pimë.

Ora ishte nëntë e gjysmë dhe unë mendo-  
va se që koha për të paguar e për t'u ngritur.  
Kisna pirë shumë dhe kokën e ndieja pak të  
turbullt. Por nuk u ngritem. Ndenjem gati  
edhe një orë, derisa u mbyll lokali e kamerie-  
ret filluan të ngrinin karriget. Gjatë kësaj ko-  
he shakatë e bisedat për gjëra të parëndesish-  
me kishin mbaruar dhe vendin e tyre e kishin  
zënë gjykimet për njërin a tjetrin punëtor të  
ndërmarrjes. M'u duk vetja në një mbledhje  
të vërtetë, megjithëse fjalët vazhdonin të ki-  
shin një ngjyrim humoristik, por të një hu-  
mori mjaft të hidhur. U fol për Agron Dhimon,  
një saldator, që ishte «mistrec dhe llafazan»;  
për furnitorin e ndërmarrjes, që ishte «dallka-  
uk»; për kryeinxhinierin që mbahej për «no-  
vator e burrë i zot»; për Shpresa Bilalin, që  
«ëndërronte prej kohësh vendin e Musa Zhu-  
rit»; për Gani tornitorin, që «kishte filluar  
të hidhte vickla», për Myzejenin, «atë bulldo-  
gen e presave, që kërkonte t'i ndërronin pre-  
sën»; për ... Unë i ndërpreva.

— O, shoku drejtor, — i thashë, — para  
se të vija këtu me ju, më ishte dukur vetja  
punëtor i thjeshtë, i parëndësishëm, kurse  
tani që po ju dëgjoj që merreni kaq shumë  
me ne, po më duket vetja ndryshe. Sikur ta  
dinin punëtorët që ju i merrni kaq shumë në  
konsideratë, për nder që do t'u rritej mendja.  
Ua lini brigadierëve këto gjëra. Ju keni punë  
të tjera....

Në fillim, Dyrr Dema sikur u ngrys, po, kur

dëgjoi fjalët e fundit, iu bë qejfi. Nuk m'i kishte kuptuar keq ato që thashë. Kishte marrë vetëm pjesën që e ngrinte funksionin e tij si drejtor dhe jo pjesën e parë të qortimit.

— Po hë, o Alfred, fol! — tha ai. — E shikon që mua më duhet të merrem edhe me punët e të tjerëve? Se ja, këta s'punojnë!

Ai tregoi me kokë Gentianin dhe Mësallin. Ata buzëqeshën, se ishin mësuar me këto vërejtje pa të keq të drejtorit të tyre. I zgjuar, thashë me vete, por sesi më duket, si i djallëzuar dhe hileqar.

Dyrr Dema pa orën e dorës, na vështroi të gjithë me radhë, pastaj mbështeti duart mbi tavolinë dhe u ngrit.

— Ikim, — tha. — E mbaruam detyrën edhe për sonte.

Unë hapa sytë. Nuk kishim paguar.

— E kanë rregulluar këta, — tha Dyrrin që e kapi stepjen time.

Unë vështrova kovaçin e banakierin që më buzëqeshën dhe i falënderova me kokë.

Kështu kishte mbaruar ajo mbrëmje, që tani më dukej e largët, dhe e largët ishte në të vërtetë. Nuk e di përse duhej ta kujtoja pikërisht tani që ata do të më kishin përpara tyre si një të padëshiruar. Ndoshta pikërisht sepse ata kishin dashur të më bënin mik të tyre dhe ne s'ishim bërë kurrë miq. Kjo më jep-te kënaqësi.



Në repart hyri Musa Zhuri.

— Në orën njëmbëdhjetë asnjë të mos largohet, — tha ai. — Kemi një mbledhje urgjente. Qartë? — Dhe doli nga reparti pa qëndruar as edhe një minutë.

Në orën njëmbëdhjetë, përsërita me vete. Më bëri përshtypje që lajmëronte Musa Zhuri. Ai ishte sekretar i organizatës-bazë të Partisë dhe unë mendoja se nuk i takonte të merrej dhe aq me grindjet tona. Sidoqoftë, thashë me vete, ai është burrë i urtë dhe është gjë e mirë që vjen. U ktheva nga Donika dhe në sytë e saj pashë të njëjtin shqetësim që ndiejë edhe unë. Ajo erdhi prarë meje dhe u mbështet mbi morsë.

— Sa rëndë më vjen, — tha dhe mori një limë me të cilën nisi të bënte viza pa kuptim mbi syprinën prej llamarine të tryezës. Pasta, e lëshoi limën si një gjë të mërzitshme dhe shkoi në vendin e saj të punës, pa më thënë asnjë fjalë tjetër. Dhe mirë bëri, sepse në ato çaste nuk doja të dëgjoja asnjëri. Prisja orën njëmbëdhjetë. E prisja me nervozizëm, por edhe me kureshtje. Ç'do të thoshin? Ç'qëndrim do të mbanin? Ç'masë do të merrnin?

Dhe ora njëmbëdhjetë erdhi. Mbledhja duhej të bëhej vetëm me punëtorët e repartit tonë, ndaj u habita kur pashë të hynin punëtorë nga e gjithë ndërmarrja. Nuk më pëlqeu kjo gjë. Shumë prej tyre nuk më njihnin mua, nuk njihnin as marrëdhëniet në repartin tonë dhe, të flisje ashtu siç kisha menduar unë, ishte si të rrihje ujë në havan.

Mundej që prania e punëtorëve të gjithë ndër-marrjes të më ndihmonte, po të isha i zoti t'i tregoja gjërat shkurt dhe saktë. Por e ndieja që këtë s'do ta bëja dot... Sido që të jetë, thashë me vete, unë do të flas si të di. Ata, në daç të më dëgjojnë në daç të mos më dëgjojnë. Unë ato që kam për të thënë, do t'i them.

Pranë meje erdhën e zunë vend si mundën, mbi arka apo stola, Ylli, Kujtimi e Luftëtari. Donika ndenji në tryezën e saj, ku shkuan dy vajza që punonin në torneri. Të shumtët rinin në këmbë. Kjo donte të thoshte se nuk kishin ndër mend ta zgjasnin shumë mbledhjen. Por ajo, edhe pse ora kishte kaluar dhjetë minuta nga njëmbëdhjeta, ende nuk po fillonte. Me sa dukej prisnin Dyr Dema nuk është burrë i mirë dhe një Natali Hajredini që i tha sekretarit të Partisë ta fillonte mbledhjen, sepse drejtori nuk do të vinte; kishte punë. Po kjo, thashë me vete, edhe e shkarkuar nga detyra e shefes së planit, edhe më hiqet si ndonjë e graduar...

Më dogji mungesa e Dyrarit. Kjo tregonte se ai donte të hiqej si jashtë valles në masën që mendonte të merrte ndaj meje. Dhe kuptohej se ajo do të ishte e rëndë edhe nga ato që po thoshte Musa Zhuri. Ai po e përshkruante ngjarjen kështu:

— Në stacionin e Fierit, Gentiana ka mbledhur ekskursionistët dhe u ka thënë se njëri prej tyre është i tepërt. Kur papritur, Alfred Mara i është hëdhur për gryke dhe e

ka qëlluar. Pa u marrë vesh, pa u sqaruar si njerëzit. Dhe për çfarë? Për një vend ku të ulej bashkë me të fejuarën në autobus! Po a qëllohet shoku për një gjë kaq të vogël?! Ta ndërronte vendin me një tjetër dhe kaq... Ja, shokë, për këtë ju mblodhëm. Për besë, unë nuk di ç'të them më. Gjykoni vetë.

Mua më erdhi për të qeshur nga ato që t'ka ai dhe, me sa duket, do të kem qeshur, sepse Musa Zhuri më hodhi një vështrim të ngrysur dhe rrudhi vetullat. Por ai nuk kishte faj. Ai nuk gënjente. Isha i bindur që atij ashtu i kishin thënë dhe përsëriste ç'kishte dëgjuar. Megjithatë, sikur e ndjeu që e kishte thjeshtëzuar shumë ngjarjen, prandaj, duke vështruar Mësall Sulën, shtoi si për t'u siguruar:

— Mua kështu më thanë. Në qoftë se puna është ndryshe, le të flasin ata që kanë qenë aty.

— Ndryshe është, — tha Kujtim Sauku dhe doli dy hapa përpara, për t'u bërë i dukshëm te të gjithë. — Unë, — vazhdoi ai, — nuk isha as dhjetë metra larg kur ndodhi grindja. Të dy kishin qëndruar përballë njëri-tjetrit dhe po ziheshin me fjalë. I thashë Luftarit të afrohem, se më dukej që ishin gati për t'u mbërthyer. Në atë kohë Gentiani ia bëri Alfredit me dorë kështu: «ik qërohu», dhe u largua dy-tre hapa. Atëherë Alfredi e ndoqi pas, i vuri dorën në sup, e ktheu nga vetja dhe, pasi i tha edhe disa fjalë që ne s'i dëgjua, e qëlloi. Kështu ka qenë.

Ai u kthye aty ku ishte. Dukej i zymtë, mbase ngaqë kishte folur seriozisht, sepse ashtu ai fliste tepër rrallë.

— Po mirë, — iu drejtua atij sekretari, — ti, Kujtim, si mendon ti, të mira janë këto punë?

— Nuk janë të mira.

Kujtimi nuk lëvizi fare nga vendi ku qe mbështetur.

— E nderon kolektivin tonë kjo gjë?

— Nuk e nderon.

Kujtimi mohoi edhe me kokë.

— A quëllohet kështu shoku i punës, e aq më tepër përgjegjësi yt, që është pushtet për ty?

— vazhdoi pyetjet Musa Zhuri.

— Nuk quëllohet.

Kujtimi e tundi kokën në mënyrë më të theksuar.

— Atëherë, ç'masë mendon ti të marrim për Alfred Marën? — nguli këmbë Musai, pa e ndier që po e tepronte duke u kapur pas fjalëve të Kujtimit.

— Nuk e kam menduar.

— Duhej ta kishe menduar.

— Duhej...

Kujtimi hapi krahët si të pranonte një gabim të pafalshëm.

Plasën të qeshurat. Pyetjet e përgjigjet e tyre kishin bërë punën e një zbutësi komik duke i dhënë çështjes një karakter gati humoristik. Nuk dihej si do të kishte shkuar kjo mbledhje e prishur që në fillim, po të mos ngrihej Mësall Sulà e të thoshte:

— Nuk është për të qeshur ajo që ka ndodhur, as e thjeshtë. Është një gjë e turpshme. Në radhë të parë e dënueshme penalisht. Pastaj është e dënueshme edhe shoqërisht, edhe administrativisht. Prandaj jemi mbledhur këtu, shokë. Të gjykojmë e të japim dënimin e merituar. Unë...

Mësallin e ndërpre në. Punëtorët nuk e duan dot tonin e tij të fryrë, sidomos kur përdorte radhazi ato ndajfoljet që mbarojnë me -isht.

— Si flet kështu ky, more shokë! — u

— Aha, për llafe është i zoti ky! Apo s'po na mëson frengjishten!

— Qetësi! Lëreni shokun të mbarojë!

— Unë, — vazhdoi Mësalli, — kam kaq vjet në punë dhe nuk kam parë e as dëgjuar që punëtori të qëllojë përgjegjësin e tij. Kjo, shokë, siç e dini edhe ju vetë, nuk ndodh kurrë te ne, bile nuk ndodh as në vendet borgjezo-revizioniste. Kjo...

— Atje i vrasin fare, Mësall! — e ndërpreu i njëjti zë. Ishte i Ylli Beratit që kishte dalë pas shpinës sime.

— Kush flet atje?

Heshtje e plotë.

— Kjo, — nisi përsëri Mësalli, — te ne, në sistemin tonë socialist, do të thotë të ngresh dorën kundër diktaturës së proletariatit. Prandaj, shokë, unë propozoj të merret masa më e rëndë administrative: të pushohet nga puna!

— Shkove larg, Mësall! — tha njëri, pas-

taj të tjerët, ata që nuk e donin ose që nuk e duronin atë lloj pompoziteti, vazhduan:

— Më ngadalë, Mësall!..

— Qetësi, qetësi! — ndërhyri Musa Zhuri.  
— Flisni me radhë.

— Le të na thotë edhe Alfiedi se si ndodhi. Ne atë e njohim dhe ai nuk ka treguar se është i tillë, siç na del nga ky incident. Përkundrazi, është punëtor i rregullt, i respektueshëm, i sjellshëm e i dashur. Si e bëri ai këtë? Përse e bëri? Unë mendoj se, para kujtdo, ai duhet të flasë.

Ky ishte Naim Murati, kryeinxhinieri i ndërmarrjes. Më prekën fjalët e tij, më turpëruan, po sikur më bënë edhe më trim. Pa i marë leje askujt, bëra një hap para dhe tha-  
shë:

— Unë kam për të thënë shumë gjëra. Në qoftë se shokët më dëgjojnë, po filloj: Skandali në Fier për mua është një turp, dhe unë e di sa turp më ka ardhur për atë që bëra. Por, ama, nëse nga ana ime kjo ishte një gjë krejt e rastit, nga ata që më provokuan nuk qe aspak e tillë. Ajo që ngjau para tri ditësh kishte filluar të mbështillej si një lëmsh që para tre vjetësh...

— Mos bëj shumë histori, Alfred! — më ndërpreu sekretari.

Heshta. Ndoshta gjatë. U mendova. S'mund të shpjegohesha, si mund t'i bindja edhe të tjerët se kjo grindje vetëm sa dukej e rastit? Ma merrte mendja se të gjithë e kuptonin që mungesa e një vendi në autobus për mua apo

për të fejuarën time nuk do të na çonte kurr-  
sesi në një sherr të tillë, po të mos kishte gjëra  
të tjera midis nesh, për të cilat të dy palët  
ishin të prirura të mos i bënin lëshime njëra-  
-tjetrës. Ja, këto të tjerat duhej të shpjegoja,  
po a isha i zoti ta bëja këtë pa një çikë histo-  
ri?...

Përshtypjet e mia, marrëdhëniet e mia me  
Dyrr Demën dhe grupin e tij ishin me një fil-  
llim e me një fund; me një fillim tërheqës e  
kureshtar, me një vazhdim plot të papritura dhe  
me një fund të hidhur për mua e të lumtur  
për ata. Dhe kjo e gjitha ishte një histori, një  
histori që tregonte se në ndërmarjen tonë kishte  
disa që bënin ligjin, që i lëviznin njerëzit sipas  
qejfit nga njëra punë në tjetrën, që vinin e hiq-  
nin cilin të donin nëpër vende pune të privi-  
legjuara, që i trembnin ata që s'u bindeshin, që  
shfrytëzonin ç'të mundnin për interesat e tyre,  
që kërkonin nga të tjerët e vetë nuk punonin  
fare, që merrnin nëpër gojë të ndershmit e  
mburrnin batakçinjtë, të djallëzuarit, hileqarët,  
që... Ishin vërtet aq fije të ngatërruara, sa unë  
nuk mund t'i shpëstilla pa bërë pak histori.

— Më falni, — thashë, — por në qoftë se  
shokët nuk kanë mundësi të më dëgjojnë ta-  
ni, mbledhja të bëhet pasdite ose një ditë tje-  
tër.

U dëgjua menjëherë një zhurmë mosa-  
provimi. Ishte e qartë se ajo vinte nga pu-  
nëtorët që nuk bënin pjesë në repartin tonë.  
Dhe në njëfarë mënyre kishin të drejtë. Përse  
t'i humbisnin pasditet për të dëgjuar histori  
që mund t'u interesonin fare pak ose aspak?

Por, me sa dukej, kjo nuk i pëlqente as Musa Zhurit, i cili më tërhoqi vërejtjen duke më thënë:

— Nuk na mëson ti kur ta bëjmë e si ta bëjmë mbledhjen! Thuaj shkurt ç'ke për të thënë se shokët kanë punë.

— Jo, — ngula këmbë, — unë nuk mund t'i bie shkurt, bile në këtë mbledhje do të ishte mirë që të vinte edhe drejtori, sepse ai ka pjesën më të madhe në ato që do të them dhe, sigurisht, është më e drejtë t'i dëgjojë me veshët e tij, sesa t'ia thonë të tjerët... — Më kishte hipur inati dhe s'doja t'ia lija më. Ishja i bindur që s'duhej të veproja, megjithëse nuk e dija përse. Ato që i kisha thënë herë këtu e herë atje, herë me njërin e herë me tjetrin, t'i thosha të gjitha këtu e në sy të të gjithëve. — A mund të më dëgjoni, shokë? — pyeta. — Besoj se ato që do të them nuk më takojnë vetëm mua, por secilit...

Vura re me kënaqësi se fjalët e mia bënë efektin e duhur, sidomos tek ata që nuk punonin në repartin tonë. Edhe disa që kishin bërë ndonjë lëvizje padurimi, u kthyen nga unë dhe pritën me kureshtje. Por Musa Zhuri nuk më la të vazhdoja.

— Dëgjo këtu ti! — më ndërpreu ai. — Mos kërko të na e kthesh mbledhjen së prapthi. Ndërmarrja jonë merret si shembull për realizimin e detyrave. Dhe drejtuesit e saj janë në ballë të punëve... Ti duhet të japësh llogari për atë që ke bërë, të kërkosht ndjesë, të na mbushësh mendjen që je penduar e... Kështu!



Nuk po duroja më dhe s'di për ç'arsye e për ç'inat, ndoshta ngaqë më ndërpreu, iu ktheva atij:

— Shoku Musa, ju kërkoni nga unë që të pendohem për atë që kam bërë e të them: «Amani, more shokë, ma falni këtë marrëzi, se sot e tutje do të jem i urtë si pulë.» Kështu?... Jo, more! Dhe ja ku po e them këtu që Dyr Demën. Dhe ashtu ishte. Pas pak erdhi ditë do të japë llogari për ato që ka bërë e që po bën dhe që duhet t'i dish edhe ti...

— Si flet ky kështu, more! — sekush tha. hodh Mësalli. — Po kjo është hataja, ore! Kë-tij s'duhet t'i puthë fare këmba në këtë ndër-marrje...

Prapë u bë zhurmë dhe këtë herë m'u duk se fajin e pata unë që s'dita të përmbahesha. Tani ishte gati e sigurt që çdo gjë kishte marrë rrjedhën e një rrëmuje dhe kjo, mbi të gjitha, ishte në dëmin tim.

— Daleni, daleni! — thirri kryeinxhinieri duke u përpjekur t'i shuante hamendjet dhe **habitë**.

Pas pak ai arriti të vinte qetësi dhe kërkoi që të flitej së pari për rastin e grindjes e të mos kalohej në gjëra të tjera që s'kishin lidhje me të. Më pas, nëse unë dëshiroja, pse jo, të bëhej edhe një mbledhje tjetër. Të flasim **shokët që ishin të pranishëm** në incident, të flasim edhe ata që punojnë me këta dy pjesëtarë të kolektivit tonë, tha ai. Me radhë e me qetësi, sepse kështu do të dimë të gjykojmë më drejt për njërin e për tjetrin.

— A t'i them unë nja dy fjalë? — tha xha Kasemi që aty ku ishte ulur.

— Fol, — i tha Musa Zhuri dhe plaku u kollit.

— Ky çuni, — ai bëri me kokë nga unë, është punëtor e kryeulët. Që e paska ngrejtë kryet, do ta ketë pasur një hall. Kurse këtij tjetrit, — ai bëri po me kokë nga Gentiani, — sikur ka filluar t'i pëlqejë shumë vetja dhe nuk është keq t'i dalë pak nga qejfi... E mira është ta dëgjojmë çunin si e pati hallin. — Ai iu drejtua të gjithëve. — Punë kemi boll, po kjo është punë mbi punët. Ta dëgjojmë çunin, e, po u desh, të rrimë edhe nja dy orë mbasdite. Ç'gajë ka?

— Do të flas edhe unë, — tha Ylli Berati që do li prapa tavolinës dhe qëndroi midis dy radhëve të tryezave të punës. — Atë e provokuan, — vazhdoi ai. — Unë isha aty, ulur në tren bashkë me Gentianin e Mësallin, kur këta mër-mërisnin e qeshnin me njëri-tjetrin për atë që **do t'i punonin Fredit**. Sigurisht, ata e mendonin si një shaka që **do t'i ulte pak hundën atij, kurse këtyre do t'ua ngrinte ca më përpyetë**. (Disa qeshën.) Unë i thashë Mësallit që të mos e tepronin me ndonjë budallallëk, por ai nënqeshi me ironi dhe nuk ma vari, as kokën s'e **ktheu nga unë**. Filloi të më vinte inat dhe, megjithëse nuk i dëgjoja mirë **tek flisnin kokë më kokë**, e pata fare të qarë se do ta linin pa vend në tren, siç e lanë, por edhe në autobus. Me këtë qeshnin edhe më shumë. Po, në të vërtetë, kuptohej se nuk donin të bëhej sha-

ka; ata po kurdisnin diçka të poshtër për Fredin dhe Donikën.

— Jo me epitete fyese, — e ndërpreu sekretari.

— Epitete fyese? — u hapit Ylli. — Po pse a s'është e poshtër t'i thuash tjetri në mes të Fierit që lëre gruan të vijë me ne në ekskursion dhe ti kthehu në Tiranë?!...

Zhurma e pëshpëritjeve që e menjëhershme. Mua m'u duk sikur sallën e mbushi një ajër i nxehtë që po më zinte frymën. Si kishte rrotur ashtu Ylli?! Nuk e di ç'më mbajti që s'kërceva e s'e kapa për gryke. Unë e kuptoja, ai kishte thënë thelbin e arsyes së qëndrimit tim. E kishte thënë hapur dhe pa kurrfarë ngurrimi. Po unë nuk mund ta duroja që të thuhej kjo gjë në sy të të gjithëve dhe nuk mund t'ia lejoja një tjetri të bënte atë që kisha të drejtë ta bëja vetëm unë. Sidoqoftë, pas këtyre fjalëve, çfarëdo tjetër që të thuhej e sido që të thuhej, nuk do të shkaktonte një habi më të madhe.

— Mirë ia paska bërë! — tha një zë i largët, që m'u duk si i Gani tornitorit.

— Ua, sa turp! — tha një vajzë, që nuk e njoha, siç nuk i njoha as të tjerët më pas.

— Dale, o, mos flisni ashtu!

— Si të mos flasim?! Nuk dëgjon ç'bëhet?

— Dhëndri i Dyrarit... Hihi!

— Pse, ore, për këto gjëra na sollët të gjithë këtu?!

— Bëni vetë mbledhje reparti...

— Jo, përkundrazi, duhet bërë tamam

mbledhje e ndërmarrjes dhe, bile, shumë e fortë. Se këta paskan e ç'paskan, por edhe ne nuk kemi më pak, jo...

Dhe këta zëra e këto fjalë e kishin shthurur mbledhjen në mënyrë të vetëtimshme. Disa punëtorë pyesnin njëri-tjetrin, tundnin kokat, vështronin nga unë e nga Donika, ndonjëri edhe më buzëqeshte. Disa të tjerë që kishin qëndruar më këmbë te dera, filluan të ngushtoheshin dhe të afroheshin në mesin e repartit. Disa kërkonin që mbledhja të vazhdonte; të tjerët thoshin që të bëhej pasdite. Njëri, më duket saldatori i repartit të remontit, tha se duhej të vinte edhe ndonjë i deleguar nga Komiteti i Partisë. Sekretari mundahej t'i bënte të mbanin qetësi, por ishin shumë të paktë ata që ia vinin veshin. Unë ende nuk po kuptoja se ç'po ndodhte, aq shumë më kishin turpëruar fjalët që kishte thënë Ylli.

Në fillim, mungesa e Dyrë Demës në mbledhje nuk më kishte pëlqyer, por tani dukej qartë se pikërisht kjo kishte bërë që punëtorët të besonin se diçka më e rëndësishme fshihej nën atë grindje banale të stacionit të Fierit.

Shpresa Bilali u largua nga mesi i repartit ku kishte zënë vend dhe shkoi e i përshpëriti diçka Musait. Ai e vështroi një çast si në mëdyshje, tundi kokën e rrudhi vetullat në shenjë kundërshtimi për atë që i kishte kërkuar ajo, pastaj, si për t'i gjetur njëfarë zgjidhjeje sadopak të denjë asaj rrëmuje, tha:

— Çështjen do ta bisedojmë në drejtori.

Atje do të vendosim si të bëjmë. Tani shkoni në punë!

Dhe u largua i pari nga reparti. Pas tij doli Gentian Spahiu, që s'kishte thënë asnjë fjalë e s'i kishte hequr sytë asnjë çast nga një pikë, diku andej nga dritaret e fundit. Atë e ndoqën Mësalli e kovaçi, që u ngutën ta futnin në mes. Brenda një minute në repart kishim mbetur vetëm ne që punonim aty.

Unë mora një matricë dhe e shtrëngova në morskë. Futa limën në profilin e saj, por duart i kisha si të ngrira, s'më punonin fare. Mوندohesha të merrja me mend se ç'mund të bëhej pas kësaj, por truri nuk më sajente dot asgjë të qartë.

Pas pak aty erdhi Donika e më tha:

— Fola me Shpresën. Ajo do të ngulë këmbë që kjo punë të shqyrtohet edhe në organizatë. Por nuk paska dashur Musai. I ka thënë që këto gjëra i përkasin drejtorisë... Si do t'i bëhet?

Nuk dija ç'të thosha. Përgjigjen ia dha Ylli, që ishte afruar pa u ndier.

— Hiç s'do të bëhet, — tha ai. — Ja, **kaq ishte e gjitha. Hajdeni tani! Shkojmë pikë më nga një kafe në mensë.**

— Jo, — i thashë. — Nuk dua të më shohin atje tani.

Por në të vërtetë s'ishte kjo arsyeja: ende i mbaja njëfarë inati për ato fjalë që më kishin bërë të skuqesha deri në rrëzë të veshëve.

— E po mirë, si të kesh qejf, — tha ai. —  
— Atëherë po e marr Donikën.

Merre, thashë me vete, se të takon. Ai e zuri lehtë nga krahu dhe ajo e ndoqi pa folur. Unë i vështrova derisa u futën në mensë. Më kishte çuditur pak qëndrimi i Yllit edhe për faktin se ai ishte komunist dhe, si i tillë, mund të kishte qenë më i përmbajtur. Sidoqoftë, ai e kishte bërë të tijën, kurse unë ende nuk e dija nëse më kishte mbetur diçka për të bërë... Pa e vrarë më mendjen, u ktheva nga morsa ku kisha shtrënguar matricën, vendosa duart mbi limë dhe ndenja ashtu s'di për sa kohë, ndoshta për një orë a më shumë, derisa erdhi shefja e kuadrit, që më vuri dorën në sup.

— Eja, — më tha dhe u nis përpara,

Nuk e ndoqa menjëherë. Vrisja mendjen të gjeja përse më kërkonte, por mendja s'më jepte asnjë përgjigje. Kurse zemra po. Ajo filloi të më rrihte shpejt, duke më paralajmëruar për diçka të keqe. Dhe zemra s'më kishte gënjyer.

Në zyrën e saj me shufra hekuri, si më zgjati librezën, shefja e kuadrit, një beqare pesëdhjetëvjeçare, më tha si me keqardhje:

— Përse, more djem, bëni nga këto gjëra? Ec e gjej punë tani me këtë motivacion...

Ia mora librezën dhe lexova: «Pushohet me vendim të kolektivit për grindje dhe si i padisiplinuar në punë. Dt. 18 prill 1975. Nuk po u besojta syve. Vështrova shefen e kuadrit, por ajo kishte një fytyrë që s'të thoshte asgjë. E lexova edhe një herë atë që ishte shkruar në katorrin e vogël të librezës dhe thirra:

— Kjo është poshtërsi! Kolektivi nuk ka marrë asnjë vendim për të më pushuar! Dhe unë nuk kam qenë kurrë, as edhe një ditë, asnjë çast i padisiplinuar në punë!

— Unë nuk di gjë, — tha shefja, — unë nuk isha në mbledhje. Drejtorja e ka vendosur duke u mbështetur në propozimet e shumicës për t'u marrë masa më e rëndë administrative.

— Shumica?! Po pse, një njeri i vetëm qenka shumicë?!

— Kur nuk ka kundërshtime dhe mendime të tjera, edhe një propozim i vetëm mund të merret si shumicë. Ju mos u çudisni...

— Të mos çuditemi?!

Më vinte të ulërija me logjikën e kësaj vaje plakë; më vinte t'ia ngjeshja me shuplakë turinjve dhe gati sa nuk i thashë se me atë shpirt e me atë mendje që kishte, as për njëqind vjet s'kishte për të gjetur burrë, edhe sikur të mos vdiste kurrë.

— Dhe tani, — tha ajo, — mua të më falni, se kam punë të tjera. Po të keni ndonjë ankesë, shkoni te drejtori.

«Ik, moj shtrigë, do më mësosh ti mua ku të shkoj», — thashë me vete dhe dola nga zyra, i përcjellë nga mjauilitja e derës me shufra hekuri.

Në fillim mendova të shkoja te kryetari i bashkimeve profesionale të ndërmarjes, që ishte një presëtar thatim, por ndërrova mendje. Ai edhe fletët e kampit nuk guxonte t'i ndante pa miratimin e Dyrarit. «Ku di unë vë-

llai,» kaq thoshte për çdo problem që mund t'i drejtoheshe. Ndaj, pa e vrarë gjatë mendjen, shkova e trokita në zyrën e Dyr De-mës. Derën e hapi Natali Hajredini. Ajo buzëqeshi dhe më pëshpëriti:

— Është i zënë drejtori. Eja pak më vonë, ose nesër në mëngjes.

— Jo, tani! — thirra.

— E kam për të mirën tënde, — vazhdoi të më pëshpëriste e të më buzëqeshte Natalia. — Ai është shumë i zemëruar dhe do të jetë më keq për ty. Do t'i flas edhe unë, po kur të qetësohet.

— Jo, tani, në çast dua të flas me të, —  
— ngrita zërin dhe e shtyva pak Natalinë, —  
— Të lutem, largohu nga dera!

— Nuk mundem...

— Ç'flet, moj ti! Ç'je ti, gardiane? A, po, më fal! Harrova që ke mbetur «sekretare» vullnetare, tani që të hoqën nga shefe e planit...

— Ç'është aty, Natali? Kush thërret si i marrë?

Ky ishte zëri i hollë i Dyrarit. Nuk prita më, por e largova Natalinë nga dera dhe dola përpara drejtorit me librezën e punës në dorë.

— Çfarë ke që çirresh? — m'u hakërrua ai.

— Ja, këtë kam! — i thashë dhe i tunda librezën.

Ai buzëqeshi hidhur e në mënyrë ironike. U mbështet mirë pas karriges gjysmëkolltuk,



mori frymë thellë dhe, duke i dhënë fytyrës një pamje tjetër, thirri:

— Të na falënderosh për këtë! Se me ç'ke bërë ti, në burg duhej të përfundoje! E merr vesh që të kemi mëshiruar, apo jo? E di ç'ke bërë apo s'e di? Nuk e di, se, po ta dije, nuk do të vije këtu, ose do të vije për të më thënë «faleminderit shumë». Kush të lejon ty, more, të rrahësh njerëzit si në kohën e Zogut... Prandaj, mblihd mendjen, djalë! Dhe thuaj «më fal për shqetësimin».

Po fliste si Mësall Sula në mbledhje, veçse me fjalë të tjera, dhe unë nuk po dija si t'i përgjigjesha. Po më dukej se ai incident ishte sikuar që këtu, nga kjo zyrë. Dhe po më vinte shumë keq për vetveten, që e kisha lënë të rrëmbehej si një fëmijë. Vërtet të më njihnin kaq naiv sa me një provokim aq të trashë të mund të luanin me mua si të donin? Por tani nuk kisha kohë të mendoja për këto gjëra, më duhej të kërkoja të drejtën time e t'i thosha se formulimi i pushimit tim nga puna nuk ishte i saktë, se ishte bërë me keqdashje, se ishte manipuluar dhe se kjo ishte e palejueshme, e paligjshme. Dhe ia thashë këto.

— Mirë, mirë, — ma ktheu ai. — Ik ankohu. Ne e mbaruam detyrën tonë. Ti tani më lër rehat dhe shko ku të duash, dyert të hapura i ke.

Tek dëgjoja fjalët e atij njeriu me fytyrë të hequr, me hundë eshtake të kërrusur, me buzë të holla e veshë të mëdhenj, vetja po

më dukej më tepër si në një dialog të sa-  
juar teatri. Nuk thashë më asnjë fjalë. Para  
sigurisë së tij, çdo përpjekje për të kërkuar  
atë që më takonte më dukej e kotë. I ktheva  
shpinën dhe dola. Në derë Natalia më buzë-  
qeshi me keqardhje, si të më thoshte: «E  
shikon si i prishe të gjitha? Nuk më dëgjove  
mua...» Po kjo, mendova, si mund të bëjë  
dashuri me një shëmtirë të tillë?! Dhe u lar-  
gova pa i folur.

Shkova në repart për t'i treguar Donikës  
librezën dhe ika nga ndërmarrja pa takuar  
njeri tjetër.

— Kështu të paska ndodhur, — tha Lirimi dhe mori shishen për të më hedhur përsëri raki.

— Jo, — i mbajta dorën, — nuk dua më. E kam kokën të rënduar.

Heshtëm për njëfarë kohe. Lirimi mblodhi pjatat e gotat dhe i çoi në lavapjatë. Njëra kërciti, por s'u thye. Shpëtoi, tha Lirimi, dhe vuri xhezven në plitkën e vogël. S'ka familje që të mos ketë marrë nga këto furnela të vogla, mendova dhe ia ngula sytë kafesë që nisi të ziente.

— Po mirë... — Lirimi priti që unë të ngrija kokën. E ngrita dhe po vështroja ballin e tij të lartë e të zgjeruar nga flokët e rënë. — Po mirë, — përsëriti, — ç'ke ndër mend të bësh?

Ŋgrita supet. Pas pak i thashë:

— Hiç. Do të shkoj në lagje të kërkoj punë... Sido që të jetë, unë kam kategori të lartë dhe ata s'mund të më lënë rrugëve.

— Domethënë, do ta pranosh veten fajtor?

— Fajtor jo, por nuk dua të merrem më me ata.

Lirimi u mendua pak.

— Ashtu?! E ç'fiton ti këtu?

Lëviza dorën në ajër me plogështi.

— As që më shkon në mendje të fitoj ndonjë gjë. Unë ato që pata për të thënë e për të bërë i thashë e i bëra.

— S'është e vërtetë.

— Çfarë s'është e vërtetë?

— Që i the dhe i bëre të gjitha.

E vështrova me vëmendje.

— Ti, Fred, — tha ai, — nuk duhet të tërhiqesh. Nga këto që më tregove del se ata nuk duhej të të pushonin nga puna. Për të mbrojtur të drejtën tënde, te ne ka shumë organe e organizma. Në fillim mendoj të shkosh në një zyrë aty pranë kafe «Florës», e të pyesësh ku qëndron faji yt dhe sa të rëndon ty. Ky sqarim juridik është ana më praktike dhe më personale e çështjes. Pastaj, për të kërkuar të drejtën e punës që bëje, do të shkosh në Këshillin e Bashkimeve Profesionale të Rrethit. Ndërsa, për tërë ato të meta në punë dhe në drejtimin e ndërmarrjes që, siç thua ti, janë bërë shkak për konflikte midis teje, përgjegjësit tënd e ndonjë

tjetri ti duhet të informosh Komitetin e Partisë të Rrethit. Kur t'i kesh bërë të gjitha këto, edhe sikur të mos fitosh asgjë, të paktën do ta ndiesh veten të qetë dhe do t'i pranosh gjërat siç janë, i bindur, se të kanë dhënë atë që meriton...

Në të vërtetë, edhe unë këtë dëshiroja. Nuk mund të mësohesha me mendimin që më kishin pushuar nga puna dhe s'po bëja asnjë përpjekje qoftë për të fituar të drejtën time, qoftë për të provuar se ata që e drejtonin ndërmarrjen nuk ishin burra të mirë dhe se prej tyre mund të priteshin gjëra edhe më të mëdha. Nëse ndieja njëfarë shpërfilljeje për rastin, kjo vinte ngaqë ngutesha për punët e martesës, sepse, në kushtet e mia, s'mund të rrija pa punë. Por edhe martesa le të priste!

— Po, — i thashë Lirimit, — ke të drejtë. Veçse, ato që më përmende ti, më duhet t'i shënoj, se nuk do të di ç'të them në një vend e ç'të them në tjetrin.

— Mos u bëj merak. Këtu jemi. Pastaj, ti më the se do të më tregoje ca gjëra të tjera që s'kanë të bëjnë me këtë rastin e Fierit, apo jo?

— Po.

— Atëherë, kemi kohë plot.

Ai kishte veshur kostumin, kishte vënë edhe kravatën dhe po rrinte në këmbë, me duart në xhepat e pantallonave, i kthyer i tëri nga unë.

— Ç'do të bëjmë tani? — më pyeti. —  
Do të dalim?

— Dalim, — i thashë dhe u ngrita.

Jashtë kishte filluar të errej. Duhej të kishim ndenjur më shumë se katër orë dhe unë i kisha treguar Lirimit vetëm për incidentin me Gentianin dhe për mbledhjen. Por a kishte vërtet arsye të tjera që mua më krijohej bindja se kjo gjë e pakëndshme do të ndodhte patjetër një ditë? Se qysh pas olimpiadës teatrale unë do të kisha hyrë me siguri midis atyre që përmendeshin në fund të darkës në «Drini» dhe i jepnin asaj emrin «mbledhje»? A nuk ishte grumbulluar mëria e tyre ndaj meje pikë e nga një pikë, që nga fjalët e këmbÿera me Mësall Sulën e deri te grindja me Gentian Spahun? Po Dyrr Dema, a s'ishte pikërisht ai më i cënuari nga ca ndërhyrjet e mia pak si të hidhura në punët e tij?

Isha krejt i bindur për të gjitha. Por, që këto t'ua përcillja të tjerëve ashtu siç i ndieja e i mendoja unë, më duheshin ura të pafundme kalimi, të cilat nuk do të përtoja t'i ngrija me durim e me kthjelltësi në mendjen time.

Po festonim marrjen e flamurit të olimpiadës që e kishim fituar me dramën «Një vajzë e ditëve tona». Ishte një mbrëmje e ngrohtë tetori nja dy muaj pas darkës me Dyrri. Pjesa me të cilën konkurruam që e keqe, por ne e luajtëm mirë. Siç i thonë, i dhamë pak shpirt, e bëmë të besohej deri diku nga ata që e panë. Dyrri mbeti shumë i kënaqur dhe na përgëzoi me fjalë të mira. Në të vërtetë meritën kryesore për suksesin e trupës sonë amatore e pati vetë Dyrri. Ai na krijoi kushte që do t'i kishin zili edhe profesionistët; na ndoqi vazhdimisht në prova dhe na dha mendime konkrete që në ndarjen e roleve e deri te sugjerimi i ndonjë mizanskene, që e habiti edhe regjisorin për gjetjen e bukur...

Dyrri e donte shumë teatrin. Kishte lu-

ajtur edhe vetë kur kishte qenë partizan i vogël. Kjo gjë u bë edhe shkak që ai të na tregonte ndonjë nga historitë e tij të luftës, «histori të një trimi të çartur», siç thoshte Mësalli, por që nuk ishin të tilla. Ashtu siç i tregonte vetë Dyrri, ato qenë episode të natyrshme dhe të besueshme.

Por t'i lëmë këto. Tani dua të them tjetër gjë. Që kur na lajmëruan të mblidheshim në mensë, sepse do të luanim teatër, mua m'u krijua një gjendje shpirtërore e çuditshme, si ajo e njeriut që është gati t'ia plasë të qeshurit, por përmbahet. Në fillim, regjisori na zgjodhi duke na gjykuar vetëm nga pamja për të na ndarë në personazhe pozitive e negative. Pastaj ai na vuri të lexonim me radhë të njëjtën copëzë, ku heroina shpërrthente në një monolog të brendshëm. Këtë, siç na tha ai, e bënte për të provuar logjikën e secilit në të lexuar. Duke na çuditur të gjithëve, në leximin e monologut u dallua Mësall Sula. Regjisori qeshi në një mënyrë të pakuptueshme, por i kënaqur, dhe e veçoi Mësallin nga të tjerët. Pasi na dha dy vetave nga një kopje, ai na tha ta lexonim pjesën me vëmendje dhe pas tri ditësh të mblidheshim po aty për të ndarë rolet.

Dhe kjo ditë që për mua pak e ndryshme nga të tjerat. E kisha lexuar pjesën dy herë dhe nuk më kishte pëlqyer. Bile, pata përshtypjen se diçka të tillë, të ngjashme, e kisha parë e dëgjuar disa herë. Një vaj-



zë e re, e kulturuar, pranonte të fejohej me mblesë, e shtyrë nga motive mikroborgjeze; por shpejt e kuptonte hapin e hedhur gabim dhe kthehej në «rrugën e saj të çliruar nga mbeturinat e një bote që s'vjen më», siç shprehej një personazh. Heroina e pjesës sonë që studente praktikante në farmaceutikë, por, me sugjerimin e Dyrrit, ajo u kthye në inxhinierë që priste emërimin në Tiranë, prandaj e kishte pranuar edhe fejesën me një njeri që nuk e donte. Nën ndikimin e punëtorëve dhe të një kushëririt të saj intelektual të përparuar, ajo do ta prishte këtë fejesë dhe në fund të dramës do të merrte valixhen e do të shkonte atje ku kishte nevojë Atdheu. Këtë rol e deshën të gjitha vajzat, por regjisori ia caktoi Donikës. E, po kështu, edhe rolet e tjera, me pak kundërshtime apo pakënaqësi, u ndanë qetësisht midis nesh, derisa mbeti ai i Jorgaqit, të fejuarit që braktisej. Për atë, si më të përshtatshmin, regjisori kishte zgjedhur Mësall Sulën, por ky nuk pranoi në asnjë mënyrë. Përveçse nuk shoh asgjë të përbashkët me të, tha ai, ky personazh që mishëron një njeri me koncepte mikroborgjeze, nuk më shkon as si komunist që jam. Atëherë u bënë ndryshime dhe Mësalli mori rolin e një punëtori pararojë që i jepte këshilla heroinës për kuptimin e thellë që duhej të kishte fjala «dashuri». Mua më mbeti Jorgaqi dhe, për çudinë time, nuk më erdhi aspak keq. Përkundrazi, personazhi që lëvizte më natyrshëm

në dramë që pikërisht Jorgaqi. Ai jepej nga autori si një burrë i pashëm, i mençur e me kulturë, por që gjykohej keq e përbezej vetëm sepse kishte pranuar të fejohej me një vajzë, e cila nuk e kishte dashuruar kurrë. Kjo për mua nuk ishte një e metë. Sigurisht, ishte një gabim i tij, por jo e metë që mund ta bënte atë personazh negativ. Ndaj, duke e interpretuar pa ndonjë paramendim të keq, ai erdhi në skenë aq i pranueshëm, sa heroina u ndodh përpara habitës së spektatorëve: përse nuk e dashka kjo budallaçkë këtë goxha djalë?! Në të vërtetë, drama nuk e kishte këtë ide dhe u bë mirë që iu shtua, sepse forconte idenë tjetër që dashuria nuk e përfill arsyen e ftohtë. Më vonë, kur këtë pjesë e pashë të vënë në skenë nga Teatri Popullor, më erdhi keq për konceptimin grotesk dhe skematik që i kishte bërë aktori kësaj figure. Unë e bëra ashtu siç thashë, ndaj edhe më dhanë medalje argjendi. Medaljen e artë e mori Vjollca Vyshka, që luajti rolin e gjyshes si një «profesioniste e talentuar». Vjollca (ose më saktë ajo historia e vogël e saj me Dyrë Demën kur i kishte shkuar në zyrë për t'i kërkuar që ta kalonin në byronë teknologjike), u bë edhe shkaku i parë që unë të kthehesha në një të padëshiruar për drejtorin tim.

Sa herë që shkëmbejmë batutat e pjesës (dhëndri me gjyshen këmbenin shumë batuta), ne duhej të tregoheshim të kujdesshëm që në vend të tekstit unë të mos i thosha

ashtu siç e kisha dëgjuar nga vetë Dyrri në darkën e «Drinit»: «Ne, moj vajzë, në byronë teknologjike nuk i zgjedhim njerëzit nga bukuria që ka koka nga jashtë, por nga ajo që mban brenda» dhe Vjollca të mos më përgjigjej: «Ashtu?! Më falni, shoku drejtor, unë e shkreta kujtoja se i kishit zgjedhur njerëzit vetëm nga pamja e jashtme.» Por në mbrëmjen e flamurit të olimpiadës s'u përmbajtëm dot pa i thënë. Ata që nuk e dinin, s'e kuptuan mirë, kurse vetë Vjollca shpërtheu në ca të qeshura që nuk i pushoi derisa unë ua tregova të tjerëve. Atëherë e qeshura u bë e përgjithshme dhe vazhdoi më tej kur unë i thashë Vjollcës se tani që kishte dhënë prova edhe për bukurinë e kokës «nga brenda», me siguri që Dyrri do ta çonte në byro. «Më duket se as kaq nuk mjafton», tha Vjollca duke na shkelur syrin. Atëherë të qeshurat u bënë edhe më të zhurmshme. Vetëm Mësall Sula nuk qeshte me ne. Ai na vështronte me ca sy ironikë sikur të na thoshte: Qeshni sot, po nesër do t'ju dalë e qarë, more të shkretë! Megjithatë ne i çuam edhe më tej të qeshurat, aq sa Mësalli u detyrua të ngrihej, kur ne u tallëm hapur me idenë e tij për t'i bërë dramës këtë ndryshim: heroina (Donika), pas ndarjes me Jorgaqin (me mua), të fejohej me punëtor Agronin (me Mësallin).

Por ndoshta ai s'ishte pa njëfarë të drejte në atë vështrimin e tij ironik. Jo më larg se të pasnesërmen e kuptova efektin që kishte bërë shakaja ime te Dyr Dema: Kur unë e përshëndeta, ai jo vetëm nuk ma ktheu, por më vështroi në mënyrë të tillë, si të më thoshte: «More i pacipë, dhe guxon e më thua «mirëmëngjesi?!» — Eh, — thashë me vete, — sikur në atë harenë e mbrëmjes së flamurit vetëm një çast të kisha menduar si Mësalli do ta kisha kuptuar që «me shefin tënd nuk mund të bëhet shaka». Këtë ma kishte thënë im vëlla, Astriti, që unë e doja shumë dhe pothuajse ia mbaja mend gjithçka që thoshte. Megjithatë, si Mësalli nuk mund të mendoja e të bëja kurrë. Dhe për këtë më vinte mirë.

Mua më vinte mirë edhe një një gjë tjetër: Ç'ndieja dhe ç'shijja si jo të drejtë, nuk mund të rrija pa e thënë. Isha përpjekur disa herë për t'u bërë i matur dhe i përmbajtur, por nuk kisha mundur. Dhe atëherë, kur isha bindur se në disa gjëra nuk mund të ndryshoja lehtë, më kishte pëlqyer që më kishin rritur të tillë. Kurse tani më erdhi mirë që Mësalli u largua nga tryeza e tij dhe unë shkova te Donika. E kisha thirrur një herë te vendi im i punës dhe nuk kisha mundur t'ia thosha atë që po mendoja prej ditësh. Por edhe ta thërrisja përsëri, sesi më dukej, si e padrejtë që e hiqja nga puna...

Në të vërtetë në repartin tonë natyra e punës ishte e tillë që na detyronte të shkonim shpesh nga axhusteria në torneri, në kovacnanë apo në repartin termik. Kjo jepte shkak për biseda të shumta, për humbje kohe e sorollatje, sidomos të asaj brigade që quhej eksperimentale. Më kishte bërë shumë përshtypje organizimi dhe përbërja e kësaj brigade. Për një stampë që e bënim edhe ne të prodhimit në seri, ata e kishin kohën e punës të panor-muar, sepse gjoja eksperimentonin. Është edhe pagesa për ata bëhej me një rrögë bazë mesatare, ku përfshihej edhe përqindja jonë e tejkalimit të planit. Në fillim brigada u krijua si një bërthamë shkencore me dy-tre axhustatorë të kualifikuar, por shpejt u fry me punëtorë të kategorive të ulëta dhe u bë brigadë me njëzet veta. Ata që erdhën më pas ishin aq «të zgjedhur», sa patjetër diçka në gjak a në miqësi do të takonin me Dyr De-mën. Ishin edhe tre djem, të tre bij kasapësh, të cilët, si të thuash krijonin edhe atë lezetin e kësaj brigade që shpesh bëhej shkak i të qeshurave të repartit. Më shumë ngacmonin një gjatosh flokëpërpjetë me pamje idioti. I kishin vënë nofkën «pellë», domethënë një gjë e gjatë e petashuqe, dhe gati çdo ditë e pyesnin: «Ç'të futi lala në qese, plëndësa? Kokë viçi apo kokë qengji? Jo, ore, kokë mushke e bythë derri...» Ha-ha-ha, — qeshte reparti, sepse të gjithë e dinin që lalë kasapi çdo ditë i jepte diçka herë për Gentian Spahun e herë për Mësall Sulën,

kurse Dyrr Demës ai ia shpinte në shtëpi... Na vinte inat me këtë brigadë «palle», siç i thoshim ne. Megjithatë, ajo vazhdonte të mbahej vetëm me punën e tre-katër veta-ve.

Për këtë brigadë para një jave, një muaj pas mbrëmjes së olimpiadës teatrale kisha bërë fjalë me Gentian Spahun.

Ai hyri në repart dhe erdhi drejt e te tryeza ime. Aty ishte Donika.

— Dëgjo këtu, — i tha asaj, — është he-  
ra e parë dhe e fundit që të shoh duke bërë  
muhabet në orar të punës! Qartë?

Donika nuk foli. Ai u largua duke marrë  
frymë thellë. Mua m'u duk e ligë vërejtja e  
tij, ndaj e ndoqa pas deri në zyrë. Atje i  
thashë:

— Shef, a ke kohë të bisedojmë pak?

Ai më vështroi me vetullat të ngritura lart  
dhe m'u përgjigj:

— Unë kam kohë, por s'ke ti se je në orar  
të punës.

— Rri më vonë, — ia ktheva dhe u ula në  
karrigen përballë tij, pa i marrë leje.

— Urdhëro atëherë, po të dëgjoj, — tha ai  
dhe priti që unë të flisja.

— Donikën e qortove me të drejtë, —  
ia nisa, — megjithëse faji ishte imi, unë e  
thirra.

— S'ka rëndësi, — më ndërpreu, — ajo e  
kishte lënë punën. Megjithatë?...

Ishte një pyetje si për të më thënë: «Va-  
zhdo, ç'kishe tjetër?» Dhe unë vazhdova:

— Nuk dua të m'i marrësh këto që do të them si inat për qortimin e Donikës. Kam dashur të t'i them më parë, por s'ka qenë rasti...

— Lëre hyrjen, Alfred. Fol si është puna?

— Shumë keq,

— Çfarë?! Kush është shumë keq?

— Puna pra, punët e repartit tonë.

— Ashtu?! Pa hë!

Ai vuri bërrylat mbi tryezë, dhe mbështeti mjekrën midis grushteve, si tepër i habitur nga ato që po dëgjonte.

— Nuk e kuptoj, — vazhdova, — përse për të njëjtën stampë ata të brigadës eksperimentale kanë një kohë pune të pakufizuar dhe jo të normuar si ne?

Ai buzëqeshi me ironi.

— Nuk është nevoja t'i kuptosh ti të gjitha, Alfred. Megjithatë, ta shpjegoj unë përse ndodh kjo. — Ai mori frymë thellë, qëndroi dy minuta i gufuar, pastaj tha: — Kjo ndodh sepse ata bëjnë modele të reja dhe mbi bazën e kohës së harxhuar nga ata vendoset norma. Qartë?

— Jo, aspak. Unë e kisha fjalën për një stampë të normuar që e prodhojnë edhe ata.

— Mirë, Alfred... Ke gjë tjetër?

Ai shfryu me zhurmë dhe e shfaqti sheshit bezdinë

— Kam, — i thashë duke e theksuar fjalën aq sa ai u ngut të më nxiste:

— Po hë, fol atëherë!

— Po, — thashë unë gati duke ia imituar atë mënyrën e tij të të folurit. — Në repartin tonë puna është organizuar aq keq, sa secilit i duhet të interesohet vetë për gjithë procesin e punimit të stampave. Kjo sjell humbje kohe dhe jep shkak për sorollatje. A nuk mund të organizohej më mirë puna?

— Si, për shembull?

Dukej që pyetjen e bënte ashtu kot dhe si për t'u tallur. Megjithatë unë e çova deri në fund mendimin tim.

— Duke i grupuar pjesët e stampave në atë mënyrë që çdo repart të përgjigjet në kohë e me cilësi për atë që i takon. — i thashë dhe i kërkova sytë, por ai i kishte ulur dhe vështronte një si listë që e mbante përpara.

— Ta shohim, — tha me të njëjtën ironi dhe ngriti sytë.

Fillova të nervozohesha. Tani po më shikonte në një mënyrë të tillë si të kishte përpara një fëmijë që bënte pyetje të kota e për të qeshur. Dhe nuk vonoi që ta shprehte këtë:

— Mirë, Alfred; të kuptoj, sepse e ke thënë edhe në një mbledhje këtë. Por... a mendon vërtet ti se duhen këto që thua, apo të shkrepni në kokë ashtu, si për qejf? — Po tallej hapur tani, sepse edhe po qeshte i përmbajtur. M'u ngritën nervat.

— Po ti mos u çudit kaq shumë, Gentian Spahu, — i thashë, — se në repartin tonë ka njerëz që hanë në kurriz të të tjerëve. Bile



ka edhe ndonjë që vjedh veten dhe shtetin.  
Për këtë ju i paguani edhe orë jashtë orarit.  
Apo jo?

— Ashtu?! Pa hë! Një shembull.

E ndjeva në çast se kisha ngatërruar të tjera gjëra dhe nuk po thosha ato për të cilat kisha vajtur të bisedoja me shefin tim të repartit. Më pati ndodhur shpesh kjo: Nisja të thosha diçka që kisha menduar mirë më parë dhe isha i bindur se do ta çoja deri në fund, kur një ndërhyrje e tjetrit, një nënqeshje me keqdashje, bile dhe një mungesë vëmendjeje mua ma ngatërronte fillin dhe më bënte të kërkoja diçka si për një hakmarrje a si për t'i ngritur edhe unë nervat atij tjetrit, ashtu siç m'i kishte ngritur ai mua. E kisha bërë edhe në një mbledhje këtë gjë, kur më kishte ndërprerë po ky Gentiani dhe po për të njëjtin problem. Por atëherë më qenë dukur gjëra të vogla dhe isha tërhequr, kurse tani më duhej t'i jepja një emër këtij njeriu, një emër që me siguri atij nuk do t'i pëlqente. Ndaj me një ton pak si të zbutur e si duke qeshur, i thashë:

— Mësall Sula.

— Ah?! E çfarë bën Mësalli?

— Po ja, stampat dhe pajisjet që kthehen nga presat për riparim, ai i magazinon si të reja. Kjo tregon se...

— Mjaft, e mora vesh!

Ai u ngrit në këmbë. Ishte skuqur në fytyrë e fryrë në kraharor sikur po bëhej gati të buçiste dhe të thërrmonte çdo gjë para tij.

— Ty, — m'u hakërrua, — të është rritur mendja. Të duket vetja më i zoti, më i mençuri e më i përvëluari për punën. Por nuk je i tillë. Je një fodull e mburravec që s'e ke shokun. Dhe, s'ke faj ti! Të kemi përkëdhelur vetë, se na u duke djalë i mirë, kurse ti paske qenë një tip karrieristi i fshehur që ç'të të them. Por edhe karriera nuk bëhet kështu si sillesh ti...

— E di, — e ndërpreva, çuditërisht mjaft i qetë, — por unë s'kam si të bëj ndryshe, se nuk i kam mundësitë e tua, nuk e kam vjehrrin drejtor.

Pata përshtypjen se do të plaste, por nuk plasi. U shfry si përbrenda.

— Dil jashtë, — më tha me zë gati të shuar. — Dhe do ta shohim këtë punën tëndë.

Nuk lëviza nga vendi, sepse nuk po arrija ta kuptoja: isha unë ai që i kisha ngritur nervat atij, apo ai që s'duronte vërejtje për gjëra që mendonte se i dinte më mirë nga të gjithë dhe se i përkisnin vetëm atij. Kjo më fyente edhe më shumë. «Si janë bërë kështu këta spurdhjakë?!» — thosha me vete. Ky djalosh, ky Gentian Spahu kishte qenë vetë punëtor deri para tre-katër vjetësh kur u martua me vajzën e Dyrri Demës. Kurse tani hiqej si të ishte një gjysmëdrejtor ose diçka më shumë. Por nuk ishin aq trima dhe aq të bindur në ato që bënin e thoshin. Ky dhe Mësalli jo e jo, po as Dyrri Dema nuk shiste kollaj trimëri kur dikush vinte t'i ha-

kërrohej si saldator Agron Dhimoja, për she-mbull.

Një ditë në pushimin midis provave të te-  
atrit, të cilat, siç e thashë, Dyrri i ndiqte ire-  
gullisht, Agroni kishte ardhur bashkë me  
furnitorin e ndërmarrjes dhe i kishte shfry-  
rë pa kurrfarë druajtjeje:

«Po mirë, more Dyrri Dema, edhe njëzet  
pako të qelbura elektrodash që mezi i gjeta  
vetë, ti shkon e ua jep të tjerëve? Apo për  
t'u bërë burrë i mirë?...»

Ne kishim shtangur të gjithë. Nuk ma  
merrte mendja se mund të kishte ndonjë në  
ndërmarrje t'i fliste Dyrri me atë gjuhë.  
Por ja që ishte ky Agron Dhimoja, gati i  
së njëjtës moshë me të, që, me sa dukej,  
po t'i jepnin shkak, do të shkonte edhe më  
tutje. Por Dyrri s'e la.

«Agron, — i tha, — kush t'i ngatërron  
në kokë ty këto gjëra, ky? — dhe tregoi me  
dorë furnitorin. — Unë ato elektroda i dha-  
shë për t'i këmbyer dhe ti nuk mund të më  
kërkosh llogari për punët e mia! Apo jo?  
Shko merr ca të tjera aty ku i more të pa-  
rat dhe mbaji në repartin tënd. Dhe mos  
më eja më për këso gjërash!»

Dyrri qe kthyer nga ne duke buzëqeshur  
si me keqardhje për saldatorin, kurse ky, du-  
ket i mërzhitur edhe më shumë nga mënyra  
se si Dyrri i kishte dredhuar sherrit, pati ulur  
kokën dhe qe larguar duke mermëritur në-  
për dhëmbë, i ndjekur nga furnitori. Kur ato  
dolën nga mensa, ku ne bënim provat, Dyrri

tha për saldatorin: «Ky është mistrec dhe llafazan; i duhet hapur rrugë.» Kurse për furnitorin: «Ai është dallkauk, i tregon të gjitha për të ngatërruar e për të bërë sehir. Asnjë punë nuk bën.» Ne qeshëm dhe vazhduam provat... Po ashtu bëra edhe unë kur Gentiani më tha të dilja jashtë: qesha hidhur dhe dola...

Nuk e di përse po i kujtoja këto gjëra jo të këndshme tani kur kisha vendosur t'i flisja Donikës për diçka që më dukej gati e shenjtë. Ndoshta nga prania e syve të Mësall Sulës që më ndiqnin ngado, sikur ai ta dinte se ç'kisha në mendje t'i thosha Donikës. Më në fund iku, por unë tani i kisha harruar fare ato që kisha menduar prej kaq ditësh...

— Dua të të them diçka, — i thashë Donikës që prapa kokës.

Ajo nuk u kthye fare nga unë. Me dy pllaka hekuri në duar, shkoi në trapan me një hap të lehtë e të nxituar, si për të më lënë sa më pak nge t'i vështroja format e derdhura të trupit. Nuk më dëgjoi, thashë me vete dhe fillova t'i vija rrotull shpikjes së Mësall Sulës. Ishte një filetatriçe, siç thoshte ai, po për repartin ajo kishte mbetur vetëm si një send që shkaktonte humor. Do

të shpëtonim sa të mbaronte ajo! Nuk do të filetonim asnjë bulon me krahë a në torno! Bile s'do të kishte më nevojë as për bulonerinë e Kavajës!... Këto i thoshte Kujtim Saku, njeriu më pa gajle i repartit. Megjithatë, Mësalli merrte gjysmën e rrogës nga kjo «shpikje», dhe as që donte t'ia dinte për të tallurat e të tjerëve. Ai vinte buzën në gaz si me përgjimit dhe, cilitdo që afrohej për të parë filetrinë, i thoshte të vazhdonte më mirë punën e tij, se nuk merrte vesh nga këto gjëra. Tek e vështroja atë sajësë, po çuditesha vërtet me fantazinë fëmijërore të Mësallit, që s'ishte axhustator i keq. Ideja e tij për të filetuar vidha e bulona të dimensioneve të ndryshme me anën e regjistrimit të dy thikave, të vendosura në kahe të kundërt, ishte krejtësisht amatore dhe e parealizueshme në atë makinë. I kishin dalë njëqind probleme për tornimin e shufrave, prerjen, kanalet e plot të tjera, e, megjithatë, Mësalli nuk hiqte dorë. Por edhe s'kishte ardhur ndonjë t'i thoshte ta linte atë budalla llëk e të merrej me diçka serioze.

— Mos e shih ashtu se i vjen inat, — më tha Donika kur u kthye.

Ajo vuri pllakat mbi tryezë dhe nisi të montonte një pajisje të vogël. Unë nuk po ia ndaja sytë filetrinës.

— Hë, o, ç'ke me të? — më pyeti Donika dhe buzëqeshi.

Unë u ktheva nga ajo dhe i thashë:

— As që më duhet fare kjo biçim arke.

Unë erdha këtu për të të thënë ty se kam dëshirë të shihemi pasdite. Mirë?

Nuk ma merrte mendja se do t'ia thosha kështu këto fjalë të menduara në aq shumë nuanca... Por më erdhi mirë, sepse e ndjeva veten të çliruar. M'u kujtua diçka e lexuar ku thuhej se dashuria midis punëtorëve ishte më moderne se çdo dashuri tjetër dhe e besova. Asaj i mungonte lumi i fjalëve të kërkuara e të zgjedhura me një mund aq të madh e të kotë. Punëtori, sipas autorit, thoshte fare pak fjalë, dy a tri, por ato shprehnin gjithçka: edhe fërgëllimat e zemrës, edhe dëshirat e trupit, edhe dyshimet e mendjes. Ishin, pothuajse, fjalë të ngjashme me ato që i thashë edhe unë Donikës. Dhe po ashtu, të ngjashme, duhej të ishin në përgjithësi edhe përgjigjet e vajzave. Ndaj nuk po më pëlqente që Donika po e vononte përgjigjen, nuk më kishte dëgjuar apo mendohej? Më në fund, pa e ndërprerë punën e me trupin gjithnjë të përkulur mbi pajisje, ajo më pyeti:

— E përse të shihemi?

— Që të rrimë, — i thashë.

Ajo drejtoi trupin dhe më vështroi në sy.

— I ke me të vërtetë këto fjalë ti apo si?

— Sigurisht.

Ajo u përkul përsëri mbi pajisje.

— Mirë atëherë, — tha, — veçse...

Por, nuk vazhdoi më tej; në atë çast erdhi Mësalli. Duket kishte pirë ndonjë gotë,

sepse i ndrisnin sytë dhe ishte i gëzuar. Nuk e di ç'më përmbajti që s'i thashë të zhdukej në çast e të na linte rehat, por nuk fola. Bile, pas pak, i kënaqur nga përgjigjja e Donikës, e ngacmova pa të keq, i thashë se, me sa dukej, atë ditë e kishte bërë festë.

— Dëgjo, Alfred, — ma ktheu Mësalli, — njeriu nuk duhet ta prishë zemrën. Duhet të bëjë mirë, vetëm mirë, se nuk i dihet jetës...

Ai e ndërpreu një çast qëllimisht moralizimin, qeshi pa zë po me plot gojën dhe më zgjati një cigare. Paska blerë edhe paketë, thashë me vete. Duhej të kishte dëgjuar diçka të gëzueshme që shkëlqente ashtu i tëri. U bëra kureshtar për fundin e atij moralizimi dhe e nxita:

— Vazhdo, Mësall, se ashtu si thua ti është.

— Nuk besoj se flet me sinqeritet.

— Nuk beson? E përse?

— Se ti e thua nganjëherë ndonjë fjalë të keqe për shokët që të duan...

— Ashtu?!

«E qartë, — thashë me vete, — po nxjerr atë që i ka treguar Gentiani.» E vështrova Mësallin në sy në një mënyrë të tillë që ai të nxitej e të vazhdonte më tej, dhe ai vazhdoi:

— Unë kam thënë vetëm fjalë të mira për ty, Alfred, kurse ti... — Ai i bëri bisedës një kthesë të menjëhershme. — Mua, — tha, më vjen keq që ke folur ashtu jo se më bëhet

vonë, por se ti më pëlqen dhe do të doja që bashkë të shkonim mirë... Ja, i shikon këto letra që kam filluar t'i mbaj çdo ditë këtu përpara? — Ai tregoi disa fletë të shkruara imët që unë e dija se ç'ishin. E kishte marrë vesh gjithë ndër marrja që Mësalli po mësonte frëngjisht.

— I shikoj, Mësall, — i thashë. — Dhe e di se ç'janë.

— Hë, pra! — ia bëri. — Po nuk e mësoj kot frëngjishten dhe nuk gëzohem kot. — Ai bëri një kthesë tjetër edhe më të fortë. — Dëgjo këtu, Alfred. Të flas si vëlla. Ti duhet t'i mendosh ndryshe punët e tua. Ne jemi dorë e fortë këtu... Ti e di këtë. Di edhe se ne nuk ta duam të keqen... — Prapë bëri kthesë Mësalli. — Pse, këtu do ta kalosh gjithë jetën ti, me hekura? Ha-ha! Mua, Fred vëllai më ke a s'më ke edhe dy-tre muaj këtu dhe, çfarëdo që të thuash ti, pak rëndësi ka për mua. Por ti duhet të mendosh për vete... Prandaj po ta përsëris, se të flas si vëlla, si vëlla pak më i madh se ti, që ka parë e dëgjuar më shumë, mos u merr me të tjerët! Sidomos me Dyrrin. Po edhe me ndonjë tjetër. Shiko punën tënde, se do të të dalë më mirë. Më dëgjo mua!

E kisha dëgjuar me shumë vëmendje Mësall Sulën dhe e kisha kuptuar mirë. Po buzëqeshja me fjalët e tij, po matesha t'i thosha se e njihja atë lloj mendjeje, dhe se ajo s'më hynte kurrkund. Po Mësalli vazhdoi në të tijën:



— Lëri të tjerët, Fred!

Këtë ai e tha si të më jepte urdhër dhe më shkeli syrin. Duhej të më kishte trembur sadopak kjo mënyrë të foluri, ose duhej të më kishte ngritur nervat. Kurse, krejt ndryshe, sikur më nxiti një gjendje hareje që të shtyn të ngacmoh të tjerët, por pa të keq ose me pak ligësi.

— Mirë, o Mësall, — i thashë, — drejt e ke ti, po a mund ta lësh edhe ti rehat këtë «arkën» tënde që ka zënë pluhur mbi tavolinë?

Mësalli u ngërdhesh me përçmim si të më thoshte: Prapë me këto vogëlsira ti?! Unë e ngava më tej, sepse nuk mund t'ia duroja atë lloj sigurie për «shpikjen» e tij.

— Më thuaj të vërtetën, Mësall, nuk të vjen pak si turp që merr paratë për një gjë që vetë ti e di se është pa kuptim, që është si për të luajtur me punën dhe me veten?!

Mësalli lëvizi dhe rrudhi buzët. Tani nuk e kishte më atë sigurinë dhe humorin e mëparshëm.

— Dëgjo, Alfred, — tha. — E para, kjo është në planin e novacioneve. E dyta, s'është e thënë që çdo novacion të dalë menjëherë me sukses. Unë kam bërë një filetatriçe që nuk arrita ta përfundoja të përsosur. Ç'të keqe ka këtu? Nesër merre ti dhe mbaroje. Puna aty është, nuk ka shkuar kot.

— Kot ka shkuar, — i thashë.

— E përse?

E mata me sy.

— Sepse, Mësall, ti e dije që kjo s'do të mbaronte kurrë qysh kur e fillove. Apo jo?

Ai buzëqeshi hidhur.

— Qoftë edhe ashtu. E prapë, këtu s'ka asnjë të keqe.

Ai rrudhi përsëri buzët dhe filloi të merrej me pajisjet e vendosura rrëmujë mbi tryezë. Dhe me këtë veprim po më thoshte se nuk kishte dëshirë ta vazhdonte më tej bisedën. Por as unë s'e kisha atë dëshirë, megjithëse ca fjalë më kishin ardhur në mairë të gjuhës.

U ktheva në vendin tim dhe fillova të axhustoja një stampë. Mezi prisja sa të kalonin ato dy orë punë e pastaj edhe dy të tjera, derisa të vinte koha e takimit me Donikën.

Në orën gjashtë të mbrëmjes ajo zbriti nga autobusi i kinostudios dhe erdhi drejt pemës ku po e prisja, me një hap të ngadalshëm, si e menduar. Kishte veshur triko të bardhë dhe fund blu, të ngushtë në bel e të gjerë poshtë. Dukej më e gjatë.

— Hë, — tha duke qëndruar para meje dhe buzëqeshi.

— Nga do të shkojmë? — e pyeta.

Ajo ngriti supet.

— Ecim atëherë, — i thashë dhe u nisëm drejt rrugës së Dibrës.

Dita kishte qenë e nxehtë. Pasditja kishte mbledhur ca re të murrme dhe sikur e kishte shtuar zagushinë. Temperatura nuk duhej të ishte më shumë se njëzet e tre gradë e megjithatë disa djem kishin dalë me këmbishë. Ktheva kokën nga Donika dhe i thashë:

— Edhe ti je veshur hollë.

— Është shumë ngrohtë, — tha ajo dhe u fut në një pastiçeri.

Unë i shkova pas pak i habitur. Ajo seq foli me arkëtarin dhe e mora me mend ç'kërkonte: akulllore. Aty kishte aq shumë djem e vajza, sa do të duhej një gjysmë ore për të marrë një akulllore. Por Donika u kthye te tavolina ku isha mbështetur unë pas gjysmë minute. Kishte gjetur rrugën më të shkurtër e ndoshta më të padrejtë. Ia kishte dhënë bonon djalit të parë në radhë. Unë s'haja kurrë akulllore, sidomos me kupë, por s'kisha si t'ia prishja Donikës. E mora akullloren që më dha ajo dhe gjeta një mënyrë për ta ngacmuar.

— Tamam si Mësalli, — i thashë. — Kështu do të kishte vepruar edhe ai.

— Si?! — u habit ajo.

— Do t'i kishte buzëqeshur ëmbël ndonjë vajze e do t'i lutej t'i merrte dy akulllore.

— Kurse unë i buzëqesha një djali, — tha ajo.

— E pashë, — ia ktheva, — prandaj edhe

akullorja nuk po më duket fare e ëmbël. Apo s'ka vërtet sheqer?

— Jo, ka.

— Epo, paska të drejtë Mësalli.

Donika më vështroi me vëmendje.

— Ç'ke me atë ti?

Qesha me vete.

— Hiç, — i thashë. — M'u kujtuan këshillat e tij. Më mësoi plot gjëra; më propozoi të bëhesha shok i tij, por edhe më kërcënoi qerratai...

— E di ç'të ka thënë. E njoh mirë..,

— Ashtu?!

Këtë ia thashë kot, sa për ta nxitur. Doja të dija mendimin e saj për Mësallin. Kishte ca shakaxhinj në repart që thoshin se dy gjëra nuk duronte Mësalli t'ia ngacmonin, bile as t'ua hidhnin sytë: Donikën dhe filetatriçen. Dhe, si i thonë, ku ka zë, s'është pa gjë.

— Është llafazan, por jo budalla, — tha Donika. — Mua vazhdon të më mërzitë. Më dërdëllit gjithë ditën. Shpreson të shkojë në Tregti të Jashtme. «Nuk e sheh se ç'po bëhet, më thotë. Nga klasa punëtore po marrin kudo. Unë pres sa të vijnë e të kërkojnë në ndërmarrje një kuadër, se të tjerat i di vetë pastaj». Po mëson edhe frëngjisht, se «atje, thotë, duhet të dish pak ndonjë gjuhë të huaj». Është njeri i lig. Qesh e bën sikur s'i ngelet qejfi për asgjë, por përbrenda bëhet ujë. Ruhë prej tij!

— Të ruhëm prej tij?! E përse? Ç'mund të më bëjë ai mua?

— Ai mund të bëjë gjithçka, po ta ngacmoh, bile edhe pa e ngacmuar fare, mjafton të të marrë inat

— Ai është njeri fare i parëndësishëm, Donika, dhe një njeri i parëndësishëm s'ka ç'të bëjë.

— Nuk është ashtu, jo. Por a dalim më mirë dhe e lëmë këtë bisedë?

— Si të duash, veçse thonë që Mësalli të pëlqen shumë ty.

Ajo qëndroi, u kthye nga unë dhe më vështroi në një mënyrë të tillë që më bëri të pendohesha për atë që thashë. I buzëqesha, si për t'i treguar se vetëm doja ta ngacmoja dhe ajo sikur e pëlqeu këtë lloj pajtimi.

U desh të binte mbrëmja dhe ne të ishim në unazë, bregut të Lanës, që të harronim çdo gjë rreth nesh dhe të shkriheshim në mrekullinë e kureshtjes dhe të dëshirave tonë... Unë i preka faqen Donikës me majat e gishtërinjve. Ajo ma largoi dorën dhe, si një kalama, më tha: «Shsht, jo këtë, e majta është e mamit.» Unë i preka po ashtu faqen e djathtë. Ajo bëri prapë. «Shsht, kjo është e babit.» Atëherë unë ia mora të dyja faqet në duar dhe i çika lehtë buzën që i ndizej. Ajo nuk foli. Kurse unë u binda që, veç faqeve, qysh nga ai çast çdo gjë e saj e mirë më përkiste mua.

Grindjet me njerëzit që punon, e sidomos me ata që të drejtojnë, nuk të sjellin asgjë të mirë, veçse shqetësime e dyshime edhe për vogëlsira të tilla që më parë s'i ke përfillur fare. Dhe më vinte inat që për këtë po bëhesha përditë e më i vetëdijshëm. Nuk doja të isha i vëmendshëm ndaj ndonjë shakaje si pa të keq të Mësall Sulës dhe as ndonjë sjelljeje pak harbute e fyese të Gentian Spahut. Këto, në mënyrë të veçantë, ishin shumë pas u morën vesh lidhjet e mia me Donikën. Dhe, ndoshta, pikërisht për këtë nuk doja të isha i vëmendshëm ndaj ngacmimeve të tyre. Nuk doja t'ia pranoja vetes si mëri inatin e Dyr Demës që ende mezi më përshëndeste qysh nga mbrëmja e olimpiadës teatrale, megjithëse kishte kaluar më shumë

se një vit. Nuk doja të sillesha ftohtë as me Gentian Spahun, i cili, që kur i shkova në zyrë për brigadën eksperimentale, më shikonte me përbuzje. Ndërsa me Mësallin tani nuk flisnim fare. Ndaj, kur Besnik Zajmi, brigadieri im, bashkë me një skicë që mban-te në dorë, më dha edhe urdhrin për t'i ndërprerë të gjitha punët e tjera dhe për t'u marrë vetëm me një stampë, unë dysho-va.

— Kjo, — më tha ai, — kërkohet urgjen-tisht nga drejtorja. Ka rëndësi për mbylljen e planit vjetor të ndërmarrjes.

— Planit të ndërmarrjes?!

— Po. Është për një detaj të domosdo-shëm dhe me shumë copë, rreth katërqind-pesëqind mijë.

E vështrova skicën gjatë e pa folur. Një-farë përshtypjeje për atë tip stampe e krijo-va në çast, ndaj nuk po e kuptoja pse ia kishin ngarkuar brigadës sonë prodhimin e saj, dhe pikërisht mua.

— Këtë duhet ta bëjnë ata të eksperi-mentales, — i thashë Besnikut, — kjo nuk na takon neve.

Ai buzëqeshi në mënyrë kuptimplote.

— Nuk pret puna për eksperimente, Fred, — më tha. — Duhet shpejt dhe e një cilësie që të mos ketë nevojë për stampë tjetër.

E pashë në sy i habitur. Besniku ishte axhustator me përvojë dhe e dinte mirë që pesëqind mijë copë mund të mos i përfun-donte një stampë, sidomos në ato presat tona

që kishin filluar të llaskoheshin. Ai e kup-  
toi habinë time dhe tha:

— Ti e bën këtë, Fred. Mos e merr me  
frikë.

Jo, unë s'e merrja me frikë, por me atë  
dyshimin që thashë më parë. Përse ma ki-  
shin besuar mua pikërisht atë tij stampe që  
s'ishte prodhuar ndonjëherë te ne, kur kishte  
axhustatorë të tjerë që lavdëroheshin çdo dy  
muaj? Mos kishin kurdisur ndonjë shkak për  
të më ngarkuar me përgjegjësi, që dreqi e  
dinte ç'pasoja mund të më sillte në rast dësh-  
timi? Sepse, me atë antipati që shprehnin  
ndaj meje Dyr Dema e Gentian Spahu, nuk  
ma merrte mendja të kënaqeshin nga sukse-  
si i punës sime. Pastaj, jo më shumë se pa-  
ra dy ditësh, me Mësallin kishim pasur një  
grindje të fshehtë që askush s'e dinte, me  
përrjashtim, ndoshta, të shokëve të tij të  
ngushtë.

Ishte fillim dhjetori, datë katër, ditë rro-  
gash, si atëherë kur shkua në «Drini», por  
një vit më vonë. Bënte ftohtë dhe retë e shi-  
ut kishin zbritur fare poshtë. Sapo hyra në  
repart, Donika më pëshpëriti:

— Kam marrë me vete një qese plot me  
llokume, t'i ndaj?

— Ndaji, — i thashë, — po këta na kanë



fejuar para se të kujtoheshe ti për llokumet.

— Megjithatë...

Ajo shkoi në repartin e tornerisë nga ku u kthye bashkë me Shpresa Bilalin. Qeshnin të dyja dhe ishin kapur dorë më dorë. Shpresa m'u afrua dhe m'u hodh në qafë. Më puthi në faqe me zhurmë. Në çast repartin e përshkoi një «uhhuu» e zgjatur.

— Është urim për fejesën, — thirri Shpresa duke u skuqur lehtë. Ajo i mori Donikës letrën me llokume dhe nisi t'i ndante vetë. Filluan të dëgjoheshin urime nga të gjitha anët. Xha Kasemi erdhi te ne dhe na mori për qafe të dy. Donikës i tha: «Qengji i urtë pi dy nëna.» Kurse mua: «Këputja kaptinën maces qysh tashti, se nesër ka për të të thënë «u desh me vakt, more torollak.» Ah, jo, — e kundërshtova unë, — nuk e kemi me «kaptina të këputme.» «Ashtu?! — bëri sikur u habit xha Kasemi. — Epo atëherë, — vazhdoi ai, — më dëgjo mua: mbaje kalaqafë e mos e zbrit hiç, as për të rregulluar një çikë qafën, dhe mbaj vesh se mbas ca kohësh ka për të të thënë: «Ti më ke mbajtur mua në qafë?! Kurrë ndonjëherë!»» Qeshëm dhe, përmes të qeshurave, erdhën edhe urime të tjera. Kujtim Sauku u largua nga vendi i tij i punës dhe hipi mbi një stol midis radhëve të tryezave. Urimet u ndërpreën. Të gjithë u kthyen nga ai dhe pritën ç'do të thoshte. Kujtimi e ngriti llokumin lart, si një prestidigjitor që kërkon të tërheqë vëmen-

djen para se ta zhdukë a ta shndërrojë objektin dhe thirri.

— Mësall Sula, të të trashëgohet Donika!

Shpërthyen prapë të qeshurat, por të mbytura. Mësalli u bë prush në fytyrë. Unë ula kokën. Edhe pse e kisha fare të qartë kuptimin e atij urimi, nuk më erdhi mirë. Ishte diçka tepër e rëndë për atë tjetrin, kurse për mua... Prapë, edhe për mua nuk ishte ndonjë gjë për t'u mburrur që i kisha «marrë» një tjetri vajzën, të cilën ai e kishte pandehur aq pranë tij e ndoshta edhe e kishte dashur. I fola Kujtimit, por ai ma ktheu në çast:

— E, o, mirë ia bëra, se ka tre vjet që bën poza sikur ta kishte Donikën krejt të tijën, veç të hapte gojën e ajo do të vdiste për të... Mirë ia bëra! — përsëriti.

Dhe Kujtimi kishte pasur të drejtë.

Më vonë u krijua një gjendje tepër e vështirë, gati qesharake midis ne të treve. Mësalli filloi të mos largohej më fare nga reparti dhe gjatë gjithë kohës seç i pëshpëriste Donikës. Vinte edhe tek unë e më thoshte se ne duhej të bëheshim shokë të ngushtë, një «treshe» që askush të mos dyshonte për singëritetin e shoqërisë sonë. Megjithëse nuk më pëlqente si njeri, këto fjalë ia kisha marrë si të vërteta. E kuptoja gjendjen e tij dhe i jepja njëfarë të drejte në atë që kërkonte: Duke ndenjtur me ne, askush nuk do të mendonte më për xhelozinë apo zilinë e

njërit e të tjetrit. Çdo gjë do të ishte si midis shokësh, ku secili respekton atë që i takon tjetrit. Dhe, në këtë kuptim, edhe unë vetë kisha dëshirë që kështu të ishte marrëdhënia jonë, e qetë, e natyrshme, shoqërore, Por kështu nuk mund të ishte. Patjetër dikush do të fitonte dhe dikush do të humbishte. E unë nuk doja të humbisja...

Pa menduar gjatë për propozimin e Mësallit, një ditë ne shkuam të tre te klubi i Avdiut dhe pimë verë me salsiçe. Kur u kthyem në repart, e kuptova që kisha bërë një gabim të pafalshëm. Nuk duhej ta kisha pranuar ftesën e Mësallit. E kuptova që kur hyra në repart, por më të qartë këtë ma bëri Kujtimi. Dikush kishte pyetur si i habitur mos vallë ishim fejuar të dy me atë vajzë, ndërsa të tjerët, merret yesh, disa kishin qeshur e disa kishin ulur kokat.

— Po bëhesh gesharak, Fred, — më tha Kujtimi. — Ti u ke kthyer shpinën dhe nuk e sheh se ç'punon ai tërë ditën. I afrohet Donikës dhe bën sikur i thotë diçka me zë të ulët, pastaj largohet dhe buzëqesh si i kënaqur nga përgjigjja që ka marrë. Kërkon me çdo kusht të krijojë te të tjerët përshtypjen se diçka ka midis tyre. Por unë e pres kokën në qoftë se ai nuk bisedon me Donikën vetëm për punën... Ç'palaço që është!.. Prandaj unë të them të jesh i kujdesshëm me të.

— I kujdesshëm?! E pse i kujdesshëm. Ja, ore, në vend e rregulloj këtë punë, — i thashë Kujtimit dhe shkova te Mësalli e i fu-

ta krahun gjoja miqësisht. E nxora jashtë repartit dhe i thashë:

— Shiko këtu, Mësall! Që nga ky çast nuk dua të dëgjoj më që ti bisedon me Donikën. Me të do të flasësh vetëm për punën dhe jo çdo tri minuta. Qartë? Kurse bashkë s'kemi më asnjë fjalë, as përshëndetje. Qartë edhe për këtë?

Ai u ngërdhesh në fillim, pastaj më zuri për krahu dhe u mundua të shpjegohej. Por unë nuk e lashë.

— S'ka nevojë për shpjegime, Mësall, — i thashë. — Në qoftë se ti nuk do të bësh kështu si po të them, llafet e tjera do të jenë ndryshe.

— Po më kërcënon... Po... — filloi të belbëzonte ai, por unë i ktheva shpinën dhe e lashë në këmbë, aty ku ishte.

Që të nesërmen Mësalli nuk u duk gjithë ditën në repart dhe unë nuk e përshëndeta kur e pashë në mensë duke pirë kafe me Gen-tian Spahun.

Thua të ma kishin besuar atë stampë vetëm për arsye të aftësive të mia si axhustator, një stampë të ndërlikuar e «me rëndësi për planin e ndërmarrjes»? Sidoqoftë, nuk u mundova shumë me hamendje, por fillova të mblihdhja materialet e nevojshme për prodhimin e saj. Gjithë ditën u mora me prerjen e

matricës e të puansonit, të bazamentit e të pllakave të ndryshme që do të shërbenin si mbështetëse, dhe, vetëm kur kisha siguruar një pjesë të tyre, kuptova se ç'punë më duhej të bëja e ç'vështirësi teknike më dilnin përpara. Duhej të konsultohesha patjetër me Luftar Zykën, autorin e projektit. Dhe ai erdhi në repart para se të shkoja unë në byro. Ishte mjaft i kënaqur që atë stampë ma kishin dhënë mua.

— Ngula këmbë që ta bëje ti, — më tha. — U vura kusht që, po të mos ta jepnin ty, unë si projektues nuk mbaja asnjë përgjegjësi për gabimet teknike që mund të bëheshin gjatë prodhimit. Më përkrahu edhe Besniku, ndërsa Dyrri tha se, meqë «autori» është dakord, kryeinxhinieri dakord, brigadieri dakord, përse të mos e pranojmë edhe ne që Alfred Mara na qenka axhustatori më i mirë?!

«Ama ti e paske bërë këtë», — thashë me vete dhe nuk i tregova për dyshimin. Ishte shumë më mirë kështu, se do të punoja më me qejf dhe pa asnjë lloj shqetësimi, pa asnjë lloj brengje profesionale. Sepse (unë nuk e di për profesionet e tjera, por për axhustatorin këtë e di mirë), po nuk e pati mendjen të kthjellët gjatë gjithë kohës që punon një stampë, me siguri në fund, kur të jetë duke e montuar ose duke bërë provat, atij do t'i dalin patjetër gabime që nuk do t'i ndreqë kurrë më. Veç kësaj, unë do ta bëja me qejf atë stampë edhe për njëfarë ambicieje profe-

sionale. Që prej pesë-gjashtë vjetësh ishte bërë një listë axhustatorësh për lavdërime e shpërblime dhe të njëjtët emra dëgjonim çdo tremujor e çdo fund viti. Do të më vinte mirë sikur të bëhesha unë shkaktari i ndryshimit të asaj liste.

— Tani, — tha Luftari, — nga pamja e përgjithshme dhe nga vizatimet e ke të qartë se ç'tip stampe kërkohet. Nesër do të të sjell edhe një libër me stampa të ngjashme dhe atëherë do të diskutojmë hollësisht. Gjëja më e rëndësishme është se kërkohet një detaj me shumë saktësi dhe me sasi të madhe. Dhe, ç'është më e keqja, kërkohet shumë shpejt, kurse forma është e vështirë. Nuk e di se si do ta zgjidhësh ti axhustimin, por... Nejsë, nesër bisedojmë. Mirë?

— Në rregull, Luftar. Sot unë po merrem vetëm me përgatitjen e materialit.

— Dil edhe pasdite.

— Ah, këtë e kam pak të zorshme.

— Pse?

— Sepse punoj në pallat, për shtëpinë. Duhet biseduar me Dyrin që orët e punës atje të më shënohen, ose të merren parasysht në fund.

— Rri rehat. S'ke përse të bëhesh merak. E bisedoj unë me atë.

— Dakord, atëherë! Do të punoj edhe pasdite.

Dhe ashtu punova për dhjetë ditë me radhë, me gjithë dy të dielat. Vija në gjashtë

e gjysmë të mëngjesit në repart, pushoja dy orë në drekë, nga treshi deri më pesë, dhe pastaj punoja deri më dhjetë a njëmbëdhjetë të natës. E kisha nisur me qejf atë stampë që po më tërhiqte gjithnjë e më tepër. Kisha gjetur një zgjidhje të thjeshtë, por të saktë dhe të shpejtë për axhustimin. Ngaqë stampa ishte komplekse (me tri operacione: shpim, kuposje e prerje) dhe detaji me përmasa shumë të vogla, detyroheshja ta punoja në tri pjesë e me thika të profiluara posaçërisht për të. Pasi pashë edhe librin që më dha Luftari, ku kishte dhjetëra tipa të ngjashëm stampash, kjo m'u duk rruga më e përshtatshme. Dhe deri tani punët po më shkonin mirë.

E kisha mbaruar matricën dhe po merresha me puansonin. Ishte ditë e mërkurë kur aty rreth orës gjashtë erdhi Luftari. Kishte ardhur edhe herë të tjera për të parë si shkonte puna me stampën, por atë ditë sesi m'u duk. Kishte një shprehje të veçantë në fytyrë. Dukej i gëzuar, por me një gëzim si të trishtuar. E pyeta:

— Ç'paske kështu, Luftar?

Ai buzëqeshi.

— Pse, si të dukem?

— Si i trishtuar, si i përmalluar.

— Jo, — tha. — Jam i gëzuar, por edhe i shqetësuar. Të kujtohet që të kërkova një ditë të rrinim bashkë?

Po, më kujtohej, por vetëm tani që ma thoshte ai. Që kur kisha nisur atë stampë,

kisha harruar edhe shumë gjëra të tjera. Luftari qeshi dhe më tha se, sidoqoftë, ai nuk kishte pritur sa ta përfundoja stampën, ndaj kishte ardhur të më merrte. Ku të shkoni?

— Te klubi i Avdiut që është më afër.

— Në rregull. Më prit dy minuta sa të laj duart e të vesh xhaketën.

Luftari pohoi me kokë dhe nxori nga xhepi një paketë DS. «Paska filluar të pijë cigare edhe ky?!» — u çudita, por atij s'i thashë gjë.

Klubi i Avdiut ishte plot me tym dhe me njerëz. Pritëm në banak derisa u lirua një tavolinë pranë derës. Era e bërnxollave dhe e qofteve që piqeshin në skarë të ndilte oreksin dhe dëshirën për një gotë verë. Ashtu bëmë. Morëm nga dy bërnxolla dhe verë secili. Luftari nuk më lejoi të paguaja. Bile u duk i fyer dhe më tha:

— Unë kisha kaq ditë që doja të rrija me ty, kurse ti...

Nuk i kundërshtova, vetëm i buzëqesha dhe nisa ta vështroja me vëmendje. Kishte një fytyrë vezake, të hequr, që të ngjallte menjëherë besim e simpati. Sytë pak si të mjegulluar e bënë të dukej ëndërrues dhe një tip disi i mbyllur në vetvete. Qeshte si fëmijë dhe po si fëmijë pezmatohet e turpërohet kur tregonte për diçka që s'i pëlqente apo që e quante të pahijshme. E doja këtë njeri, ia doja edhe ato lëvizjet pak të ngathëta e si të druajtura kur shkante nga tavo-



lina në banak për të sjellë bërçollat dhe goatat me verë. Shkurt, ishte nga ata për të cilët, sapo i njeh, krijon përshtypjen: njeri i mirë.

Por kjo gjë mua më kishte bërë të pyesja shpesh veten: vallë janë thjesht këto lëvizje që krijojnë te ne përshtypjen e njeriut të mirë apo diçka tjetër? Sepse njeri të mirë unë quaja atë që nuk sheh te tjetri me smirë, që e ka zemrën të bardhë, që nuk merr njerëzit nëpër gojë, që më shumë u buzëqesh të tjerëve sesa pret t'i buzëqeshin, që... nuk e di çfarë tjetër... Por a mund të dallohen këto cilësi edhe nga mënyra e lëvizjeve apo njeriu i mirë vetëm të tilla lëvizje mund të bëjë? Këto gjykime luhateshin aq argëtueshëm tek unë, sa nuk kisha dashur të pyesja njeri, as tim vëlla, i cili ndoshta do të më kishte dhënë një përgjigje të plotë e të saktë, por do të ma kishte hequr kënaqësinë që do të ndieja kur një ditë t'u jepja vetë përgjigje këtyre hamendjeve.

— Alfred, më përmendi Luftari, — e di si është puna... Çudi... Nganjëherë turpëroresh edhe për ca gjëra që... Nejse... Desha të të them... Kam rënë në dashuri...

Nuk kisha parë ndonjë që të skuqej e të sikletosej aq shumë pse po i thoshte një shoku që kishte rënë në dashuri. Mendohej të gjente fjalët më të thjeshta për të thënë atë që njerëzit e kanë stolitur me fjalët më të mëdha të të gjitha gjuhëve të botës. Kurse Luftari pëshpëriste me zë të ulët si të ki-

shte bërë ndonjë faj të madh që ishte dashuruar pas një vajze.

— Jo, nuk është vajzë, — tha dhe uli kokën si të priste një qortim.

— E kush është kjo? — e pyeta. — E njoh unë?

— Po, — tha. — Bile kujtoja se ti e dije. Mua më duket sikur e ka marrë vesh gjithë ndërmarrja, sepse të gjithë sesi më shohin, si më ndryshe. Edhe ajo ashtu thotë, se kanë filluar ta vështrojnë me një sy tjetër.

— Ëhë. Po cila është, pra?

Luftari u gëlltit.

— Maria, — tha, — Marie Vogli.

Nuk do të më kishte befasuar më shumë se ky emër as gjëja më e padëgjuar. Marie Vogli! Kjo grua për të cilën e kisha pyetur veten disa herë se ç'ishte e që më dukej si një koketë komediantë, që s'dihej si do ta mbaronte jetën e saj, e ndoshta jo vetëm të sajën...

Jo më shumë se para dy muajsh, ajo më kishte thirrur në byronë teknologjike për të më saktësuar skicën e një stampe. Nuk më bëri përshtypje që në byro s'kishte njeri, sepse ndodhte kjo gjë. Por nuk mund ta mendoja kurrë se do të hyja ndonjëherë në një rol aq të çuditshëm e komik.

Maria më vuri duart në supe dhe më tha:

«Alfred, më fal që veprova kështu, por isha e detyruar. Nuk gjeja mënyrë tjetër për

të të pasur pak çaste pranë. Oh, a më kup-ton? Pak çaste, vetëm pak çaste, sa për të më qëlluar me shuplakë...»

«Me shuplakë?!»

«Po, Alfred. Të lutem më qëllo, pa humbur kohë.»

«Po... ç'kuptim ka kjo?»

«Mos kërko asnjë arsye, por bëje këtë për mua. Të lutem edhe një herë: më qëllo, ja këtu në faqe! Bëje, Alfred, bëje! Nuk do të ta harroj për gjithë jetën.»

Nuk dija si të sillesha. Por nuk u mendova gjatë. Maria më vështronte me ca sy plot përgjërime që të këpusnin shpirtin. Më vinte edhe keq për të, por edhe për të qeshur. Nuk e zgjata më dhe e qëllova lehtë në faqen e majtë.

«Oh, jo! — thirri ajo. — Më fort, më fort, të lutem!»

E qëllova prapë, pak më fort. Ajo mori frymë thellë dhe qëndroi ashtu si të shijonte goditjen. Pastaj psherëtiu e më tha:

«Dhe tani më puth!»

«Çfarë?!» — u çudita jashtë mase.

«Më puth», — përsëriti ajo duke ngritur kokën lart me sytë të mbyllur, si në një pritje ëndrre.

Nuk mund ta vazhdoja më rolin. Nuk e di ç'urdhër do të më detyronte ta jepja atë puthje të kërkuar, por një gjë e dija mirë: atë çast dëshiroja t'i jepja me të vërtetë ca shuplaka për ta sjellë në vete atë grua të lajthitur. Megjithatë, vetëm sa i rraha supin dhe

u largova pa i folur, duke e lënë atë midis dosjeve e librave me shkencë, si gjënë më jashtëshkencore. Në fillim më çuditi pa masë kjo sjellje prej të dalldisurë, por më pas, duke rikujtuar skenat dhe duke bërë ca lidhje me rrethanat e mia, kuptova që Maria kishte dashur të tallej me mua. Loja e saj më dukej se kishte këtë synim: Unë djalë i ri, i sapofejuar, me propozimin e parë të një gruaje të bukur, isha i gatshëm për ta tradhtuar vajzën e zemrës sime. Ja ç'ishin burrat! Por ja që Maries nuk i doli ashtu siç e kishte parashikuar... Kurse ky Luftar Zyka na kishte rënë në dashuri me Marie Voglin! Ç't'i thosha?

— Po mirë Luftar, — e pyeta, — ç'ke ndër-mend të bësh?

Ai ngriti supet.

— E njeh ti atë grua? — vazhdova ta pyesja.

— Po, — tha.

— A të do edhe ajo kaq sa e do ti?

— Më shumë.

— Je i bindur?

— Po, ma ka thënë vetë.

— Ashtu?! E ç'të ka thënë?

— Se është gati të ndajë burrin për mua. Dhe unë jam po aq i gatshëm ta marr bashkë me djalin. Por kam hallin e pasojave që mund të kemi, sidomos ajo, prandaj desha të bisedoja me ty.

— Po mirë, a të pyes edhe për diçka?

— Urdhëro.

— E di ti që ajo është thjesht një koketë?

— Koketë?! E ç'do të thotë kjo?

— Që ajo luan me ndjenjat e tua e mbase edhe me të sajat... Që ajo dashurinë e ka një argëtim për të kaluar kohën e mbase edhe për të fyer ata që i besojnë asaj...

Luftari qeshi si me keqardhje për ato që i kisha thënë.

— Jo, — më tha krejt i sigurt, — ajo është tepër e ndjeshme... Ka shumë emocione... Jo, nuk besoj se është e zonja të fyejë njeri... Nuk besoj.

E vështrova në sy, por ai i uli pa më lejuar ta hetoja mirë. Kisha një mendim: nuk duhej të rrija pa ia thënë këtij naivi të gjitha ato që dija e mendoja për atë grua. Ndaj e pyeta:

— Po e ndershme, a është?

— As që e vë në dyshim.

— Gabohesh.

— Aspak.

— Ashtu?!

— Sigurisht.

Luftari tani po e tregonte hapur keqardhjen që ndiente për mua. Mbase ishte edhe i zhgënjyer e i penduar që më kishte besuar një intimitet, të cilin unë nuk mund ta kuptoja. Nisi të më mernte me të mirë, duke më afruar më pranë gotën e verës e pjtën me bërçolla, ashtu siç bëjnë me një fëmijë, të cilit ia kanë falur gabimin.

Duhet ta ndihmoj këtë njeri, thashë me vete. Duhet ta bëj të njohë më mirë Marie

Voglin, të hapë sytë dhe të trembet nga marrëzia e tij. Ndaj i thashë:

— Maria nuk është e ndjeshme vetëm për ty, por me secilin që i duket se ajo e pëlqen. Nëse Maria të thotë ty që të dashuron aq shumë sa është gati t'i ndajë burrin, këtë ajo nuk e bën aspak për ty, por për atë që ajo ka sajuar në trurin e saj të djallëzuar... Maria mund ta ngatërrojë emrin tënd me atë të një tjetri sapo ky t'i duket më interesant për t'u vënë në lojë dhe, në vend që të vijë te ti në mbrëmje, do të shkojë tek ai tjetri. Maria nuk mund të dashurojë seriozisht. Ajo... — Dhe i tregova se ç'më kishte ndodhur dy muaj më parë.

Gjatë gjithë kohës që unë flisja, ai më vështronte me një buzëqeshje gjithë mosbesim. Mua m'u kujtuan prapë fjalët e Dyr Demës për Vjollca Vyshkën, që kishte kërkuar ta merrnin në byro, sepse ishte po aq e bukur sa edhe të tjerat. Bile një ditë, gjatë provave të teatrit, ajo sikur e theksoi më shumë ironinë e saj, kur tha për rolin e një gruaje mendjelehtë: «Ua, sa do t'i shkonte ky rol Marie Voglit! Përse nuk e marrim atë ne? Apo është e pazëvendësueshme në byro?» Shpresa Bilali kafshoi buzën për t'i thënë që të heshte dhe mua më qenë kujtuar fjalët e Dyrrit: «Ti, moj vajzë, mendon se ne i marrim në byro...» e të tjera. Kur mbarova, Luftëtari më tha:

— Nuk të besoj, Alfred, por e kuptoj qëllimin tënd: ti mundohesh të ma ftohësh

Marien, të më bësh që ta neveris. Të kuptoj, Alfred, po kjo s'ka për të ndodhur kurë...

E megjithatë, unë e ndjeva që fjalët e mia e kishin gërvishtur diku dhe një ditë mbase ajo e çjerrë që i kisha bërë do t'i kthehej në plagë. Atëherë do të bindej vetë se kjo që ai quante dashuri, s'kishte qenë gjë tjetër veçse një lojë ndjenjash. Po unë, unë a kisha të drejtë t'ia thyeja zemrën këtij njeriu, qoftë edhe i bindur se i bëja mirë? Ia kam bërë kaq shpesh vetes këtë pyetje, sa përgjigjja e saj ka marrë një kuptim mjaft të përgjithshëm: nëse dhimbja që të shkaktojnë tani fjalët e mia është më e vogël se dhimbja që do të kesh nesër kur të jesh përballë të vërtetës së hidhur, unë e them atë që duhet, ndryshe jo...

Kur u ndava me Luftarin, ora ishte tetë. U ktheva në ndërmarrje për të punuar edhe nja dy orë. Te reparti i zdrukthëtarisë më tërhoqi vëmëndjen një skenë e dyshimtë. Një burrë po ngarkonte dërrasa në makinën e drejtorit. Ishte Safeti, shoferi i tij. Iu afrova dhe i thashë:

— Hë, Safet, ç'i ke këto?

Ai u tremb dhe u kthye me vrull nga

unë. Më vështroi si i shushatur pa ditur ç'të thoshte. Pastaj e mblodhi veten.

— E, mor ti, se më trembe, — tha.

— Pse u trembe, Safet? — e ngacmova.

— Se më mbive pas shpine si lugat.

Qesha.

— Po mirë, — i thashë, — për cilin i ke këto dërrasa? Oh, paska edhe rimeso!

Në ndenjëset e pasme pashë një tufë të madhe të lidhur me spango e të vendosur mbi dërrasat. Safeti nuk u përgjigj menjëherë. Rregulloi edhe diçka në makinë, uli mushamanë nga prapa dhe shkoi në timon. Unë e ndoqa pas. Safeti ktheu pak kokën dhe, me ton të rëndë, më tha:

— Janë të Dyrrit, nuk i kam për vete.

Ai ndezi makinën dhe bëri të nisej.

— Pa faturë i ke marrë? — e pyeta.

Ai zgurdulloi sytë, që, edhe pse natë, iu dukën tepër të habitur.

— More, si e ke hallin?

— Unë mirë e kam, — i thashë, — por më duket se ti nuk je në rregull.

— Ç'më çan kokën! Shiko, ore, punën tënde dhe mos fut hundët aty ku s'të takon.

Dhe e tërhoqi derën e makinës gjithë inat e shpërfillje. Nuk e zgjata me Safetin, por shkova te roja e i thashë:

— Në makinën e drejtorit kanë ngarkuar dërrasë dhe rimeso. Po të mos kenë dokument mos e lër makinën të dalë nga ndër-marrja.



Portierja, një grua e moshuar, më vështroi si me përçmim.

— Çin të mos lej me dalë, — më pyeti, — maqinën e drejtorit?! Po Safeti hyn e del sa herë i teket. Atij i jep urdhën drejtori, po edhe mu drejtori më jep urdhën...

— Mirë, po ti ke për detyrë të mos lejosh të dalë asgjë nga ndërmarra pa dokumente, sikur në makinë të jetë edhe vetë Dyrri.

Gruaja më tundi kokën në shenjë kundërshtimi.

— Jo, — tha, — këtë s'e kam ba kurrë. Dyrri Dema më ka marrë në punë mu. Ai më ka marrë, ai më heq...

Atë çast u afrua makina dhe gruaja e hapi derën pa thënë asnjë fjalë. Kamionçina kaloi para këmbëve të mia dhe çau në errësirë me një zhurmë çjerrëse të padurueshme. Pas saj dola edhe unë. Nuk kisha më asnjë dëshirë për të punuar. Nuk mund të rrija më aty. Ndihesha i fyer dhe i poshtëruar, i mërzhitur në kulm dhe i pafuqishëm për asgjë. Si guxonte ky njeri të vinte e të bënte ç'të donte si në mall të babait? Dhe unë, aty, punëtor e djalë që s'më trembej syri kollaj, të bëja sehir me duar në xhepa? Si ishin këto punë kështu? Si? Po të mos ishte emri i Dyrri Demës që i merrte ato materiale, a do të rrija unë ashtu, si guhak?... Jo. Do t'i thosha atij tjetrit t'i shkarkonte në çast ç'kishte ngarkuar dhe, po të mos ia kishte qejfi, do ta bëja të kërcente me një këmbë... Po ndaj Dyrri Demës pse s'e bëra, pse gëlltita

edhe harbutërinë e shoferit e përçmimin e portieres?... Eh, si ishin këto punë kështu! Po ç'isha unë vërtet? Ç'isha përpara Dyrrit? Një i vogël, i pafuqishëm?... Kështu mund të pandehte cilido, kurse unë atë çast ndieja një dëshirë të shfrenuar ta kisha Dyrin aty dhe t'i shfryja ashtu siç nuk ia kishte bërë asnjë deri më sot. Bile, njëherë, thashë t'i shkoja në shtëpi dhe aty, në sy të gruas e të kalamajve, t'i thosha: Mirë se batakçi e dinim që ishe, po edhe hajdut na qenke zotrote?! Por nuk shkova... Ideja e shtëpisë së Dyrrit më solli në mendje Donikën dhe sikur më ra pak inati që pata. Ishte ende herët dhe mund të rrija pak kohë me të. Që prej disa ditësh s'po shiheshim veçse gjatë orarit të punës. Më kishte marrë malli për të, ndaj më erdhi inat me veten që s'kisha gjetur një orë kohë për të ndenjtur bashkë në aneksin e kuzhinës apo në qoshen e pallatit, ku qëndronim zakonisht para se të ndaheshim.

Ajo kishte vënë bigudi në kokë dhe i erdhi turp nga unë. Po unë nuk e vura re as kur më pyeti me shaka se si dukej. Atëherë më pa si me inat dhe më tha:

— Pse, kaq i pavëmendshëm qenke ndaj meje ti?!

— Jo, — iu shpjegova, — po ti je aq e

mirë për mua, sa, çfarëdo që të bësh, mbe-  
tesh po ajo që unë e kam këtu, — dhe vura  
dorën në gjoks.

Ajo qeshi dhe më nxori gjuhën me mos-  
besim.

— Ditke edhe ti nga këto?! — më tha.

— Pse, ç'jam unë?

— Ti? Ti di veç punën. Ja se ç'je.

— Aha! Po, moj zonjushë, po! — qesha  
dhe i thashë të dilnim.

— Jo, Fred, është vonë dhe unë dua një  
orë të bëhem gati, — më tha. — Rrimë këtu.  
Do të të bëj një kafe?

— Po mirë, — i thashë dhe u ula në  
divan.

Nuk më hiqej nga mendja skena me dë-  
rrasat. Ia tregova Donikës ndërkohë që ajo  
zjente kafënë në plitkë. M'u duk se nuk i  
bëri dhe aq përshtypje. Kur po hidhte ka-  
fenë në filxhan, tha:

— Me siguri i duhen për mobiljet e të  
birit. E marton për Vit të Ri. Vajzës ia bë-  
ri në ndërmarrje. Seç pagoi Gentiani nja dy  
mijë lekë, të rinj, merret vesh. Kurse djalit,  
me sa duket, do t'ia bëjë në shtëpi, se ato  
të parat ranë shumë në sy. Ishte një gjë me  
të vërtetë përrallore dhe s'mbeti vajzë pa i  
parë... Po ty, s'të kujtohet ty?

— Diçka, por mobiljet nuk i kam parë.

— Po në shtëpinë e Dyrrit ke qenë ndo-  
njëherë?

— Jo.

Donika buzëqeshi me nënkuptim.

— Asgjë, as edhe një filxhan nuk gjen nga të tregut.

— Nga e di ti?

— Ishim për vizitë kur kishte Dyrri pësëdhjetëvjetorin... Po hë, pije kafënë.

Mora filxhanin në dorë dhe nisa ta pija kafënë pa shije. Më vinte çudi me Donikën. Ajo e kuptonte jetën aq thjeshtë, sa të bënte të besojë se edhe gjërat më të padëgjua-ra nuk i dukeshin aq të jashtëzakonshme.

— Nuk të bën ty përshtypje kjo, Donika?  
— e pyeta.

— Jo dhe aq shumë.

— Si kështu? Po kjo është vjedhje, moj! Ajo tundi kokën.

— Jo plotësisht.

— Si «jo plotësisht»? — gati sa nuk i bërtita.

— Domethënë jo krejt si thua ti. Dyrri nuk është aq budalla sa të dërgojë shoferin për të vjedhur dërrasa e rimeso në ndër-marrje. Diçka do të ketë rregulluar ai, formalisht. Mund të ketë paguar edhe ndonjë lek. Kështu që nuk e quan dot vjedhje.

Kishte të drejtë. Dyrri Dema nuk mund të ishte aq budalla; përkundrazi, shquhej për zgjuarsinë. E, megjithatë, unë isha i bindur që ai i merrte ato materiale në rrugë jo të ndershme.

U ngrita, e putha Donikën dhe dola në rrugë. Të nesërmen do të bisedoja me Shpresa Bilalin.

Ë prita që herët në mëngjes te freza e saj dhe ia tregova të gjitha me hollësi. Ajo më dëgjoi me vëmendje dhe, kur mbarova, më pyeti:

— Ti, Alfred, a do ta pohosh po të vijë puna të ballafaqohesh me Safetin?

— Sigurisht, — i thashë, — ç'është kjo pyetje? Unë për këtë erdha te ti!

— Mirë, atëherë, — tha dhe vështroi orën e dorës.

Edhe unë pashë timen. Duheshin dhjetë minuta që të fillonte puna.

— Po shkoj që tani, — tha Shpresa dhe u nis për në drejtori.

Në repart u kthye në shtatë e gjysmë. Kishte ndenjur atje më tepër se ç'e kisha llogaritur unë. Nuk më tregoi menjëherë ç'kishin biseduar. Në pushimin e drekës erdhi në tryezën ku po hanim unë e Donika dhe tha:

— Ishte ashtu siç mendoje ti. Materialet janë nxjerrë jashtë ndërmarrjes pa fletëdalje. Por do t'i bënte sot veprimet. Për këtë thirri si dëshmitare Natali Hajredinin dhe magazinierin. Atij i paska thënë një ditë më parë që të bënte dalje nga magazina në emër të tij për dy tabakë kompesatë, një çerek metër kub dërrasë dhe dy fletë rimesoje. E pohan të dy. Megjithatë, kjo nuk e shfajëson plotësisht. Pastaj, kaq materiale pe ti?

— Jo, ishin më tepër. Vetëm fletë rimesoje mund të ishin, të paktën, tridhjetë.

— Në rregull, — tha Shpresa, — iu shtua edhe një punë Dyrrit. Doni nga një krem

ju? — ndërroi bisedë dhe u ngrit pa marrë përgjigje nga ne.

Por Dyrri Demës nuk iu shtua vetëm «edhe një punë», siç tha Shpresa. Më duket se iu shtuan dy, dhe brenda dy ditëve. Të pasnesërmen e historisë me dërrasa dhe rimeso, ai erdhi vetë për të parë se si shkonte stampa. Ishte bashkë me Mësallin dhe kryeinxhinierin, kurse Luftar Zyka ndodhej aty, me mua. Dyrri nuk tha asgjë për stampën, veç sa tundi kokën në shenjë miratimi dhe pakënaqësie njëkohësisht. Ashtu e kishte zakon kur dëshironte t'i befasonte të tjerët. Dhe po ashtu na befasoi edhe ne. Ai iu kthye Naim Muratit dhe, gjithë ironi, i tha:

— Si e shpjegon ti, shoku kryeinxhinier i ndërmarrjes, që një punëtor si ky (ai më tregoi mua), i cili nuk është axhustatori më i mirë, ngarkohet të bëjë këtë stampë?! Përse ky dhe jo ata të brigadës eksperimentale? Apo ti i ruan për punime më speciale? Apo të dhimbsen? Apo çfarë? Apo nuk është detyra jote t'i vësh njerëzit në punët që u takojnë? Apo, ... ç'ta zgjas edhe unë, ka kush merret me çdo gjë në ndërmarrje?

Ky lumë pyetjesh nuk kishte habitur vetëm kryeinxhinierin; ai na kishte shtangur

edhe ne. Kishim mbetur si të ngrirë dhe, ndoshta, me përjashtim të Mësallit, të gjithë kishim të njëjtën gjë në mendje: si flet ky njeri kështu?! Por edhe kjo gjë ishte një mënyrë e veçantë e Dyrri Demës për t'ua hedhur të tjerëve ato që duhej t'i mbante për vete. Kisha qenë i vëmendshëm ndaj taktikës së tij dhe më dukej se ai vepronte kështu: bëheshin vërejtje të ndryshme, një këtu dhe një aty, që preknin në radhë të parë atë, drejtorin, dhe Dyrri i linte të grumbulloheshin aq sa atij i dukeshin të mjaftueshme për të nisur një fushatë. Dhe e niste, ja, kështu, si në këtë rast, duke bërë përgjegjës për të metat një emër dhe një mbiemër konkret. Këtë, në fillim, e bënte papritur dhe si rastësisht. Prapë si në këtë rast. Pastaj, në një mbledhje të caktuar, vërejtjet që kishte bërë një këtu dhe një aty (por që në të vërtetë ishin vërejtjet e të tjerëve në drejtim të tij), i zyrtarizonte. Atëherë përfundimi ishte fare i qartë: kishte qenë Dyrri Dema dhe vetëm ai që i kishte vënë re të metat e punës, dhe po ai kishte ditur t'i vinte pikat mbi i. Këtë po fillonte edhe tani. Por a do t'i shkonte vallë me Naim Muratin, sepse ai dukej aq i qetë dhe aq i vendosur për ta kundërshtuar, sa Dyrri e ndjeu dhe bëri të largohej, por Naimi i tha:

— Dëgjo, shoku Dyrri, dhe, meqë e hape ti, tani më dëgjo po deshe!

Dyrri u kthye nga ai me një buzëqeshje

të hollë, gjithë ironi dhe shpërfillje. Naimi vazhdoi:

— Në radhë të parë, këtë brigadë e ke sajuar ti dhe ti e mban. Unë kam përgjegjësinë time si kryeinxhinier, por ti, si drejtor dhe si iniciator këmbëngulës që ke qenë dhe je, ti e ke përgjegjësinë kryesore...

— Ashtu?! — bëri Dyrri gjithë tallje. — Po në radhë të dytë, çfarë mund të më thuash? Sepse, derisa e nise me një «radhë të parë», me siguri që e ke edhe një të dytë, apo jo?

Mësalli qeshi, por ne e pamë me inat dhe ai ktheu kokën mënjanë.

— Në radhë të dytë, — vazhdoi Naimi, — kjo që bën nuk është gjë e mirë, është e turpshme.

— Ashtu?! Pa hë! Çfarë bëj unë?

Tani Dyrri nuk ishte më ironik e tallës. Edhe pak dhe unë isha i sigurt që ai do të fillonte të dridhej.

— Pa hë! — përsëriti ai. — Çfarë është e turpshme, pra?

— Kjo, — i tha Naimi, — që vërejtjet e adresuara ndaj personit tënd, ti kërkon t'ua hedhësh të tjerëve. Por edhe të tjerët mos kujto se hanë bar.

— Ah, këtu qenka fjala! — bëri prapë ironi Dyrri. — Radhë të tretë a të katërt ke më? — pyeti duke i dhënë të kuptonte se kishin ku i shihnin më mirë këto mendimet e tij.



— Jo, — i tha Naimi, — të paktën tani dhe këtu nuk kam.

— Epo atëherë...

Dyrri bëri përsëri për të ikur, por unë thashë:

— Ka të drejtë kryeinxhinieri. E dinë të gjithë se atë brigadë pa norma ju e mbani. Unë kam bërë fjalë edhe me Gentianin për këtë gjë...

Nuk më dëgjoi deri në fund. Më buzëqeshi si të më thoshte të mos ngatërrohesha në gjëra që s'i kupoja dhe u largua me hapa të vegjël e gjunjë pak të përthyer. Unë u ktheva nga stampa dhe nisa të shtrëngoja një bulon, pa e pasur mendjen aty. U çudita kur dëgjova Mësallin që më pëshpëriti (i kisha thënë të mos më fliste fare): «Ç'të duhet ty që ndërhysh në punët e peshkaqenëve...» Ngrita kokën menjëherë dhe iu ktheva, por me zë të lartë:

— E di se ka njerëz si ti, Mësall, që të këshillojnë të mos përzihesh në punë që nuk të takojnë, e di edhe se ç'kuptim u japin ata fjalëve «nuk të takojnë». Por unë, këtë dije mirë ti, këta njerëz nuk i dua dhe, meqë nuk i dua, nuk i dëgjoj fare, lëre më t'u besoj. Ik, Mësall, ik, se s'është më Dyrri këtu!

Por ai nuk iku. Bënte sikur merrej me ca pajisje të tij për të dëgjuar se mos thoshim ne ndonjë fjalë tjetër për Dyririn. Dhe ne thamë...

Të nesërmen në zyrën e drejtorit unë dëgjova këto fjalë prej gojës së tij:

— Alfred Mara, jemi shumë të kënaqur nga puna jote. Më thanë se stampa mund të kalonte edhe numrin e caktuar të prodhimit. Të lumtë! Për këtë unë do të të jap një javë pushim... Sigurisht do të t'i paguajmë edhe orët jashtë orarit... Po ty të lumtë edhe për një gjë tjetër...

Ai heshti një çast. Unë po çuditesha me fjalët e tij, sepse nuk i besoja ato që thoshte. «Të lumtë» në gojën e tij më dukej si një paralajmërim «kujdes» për atë që do të vinte më pas. Ndaj, kur më tha «po ty të lumtë edhe për një gjë tjetër», e mora me mend për çfarë e kishte fjalën dhe prita.

— Parmbrëmë, — tha ai, — ti kishe parë makinën e vogël të ndërmarrjes të ngarkuar me ca dërrasa. Shumë mirë që kishe ndërhyrë...

Nuk e besova, megjithëse e tha mjaft natyrshëm dhe si të ishte fjala për diçka që nuk i përkiste atij.

— Sigurisht, — vazhdoi, — që një gabim imi dhe neglizhencë e këtyre që merren me formalitetet. Por ti, kuptohet, s'mund t'i dije këto, prandaj të them se bëre shumë mirë që ndërhyre. Bile, bëre mirë që ndërhyre edhe në fjalët që bëmë me kryeinxhinierin.

Këtë nuk e besova fare, ndonëse prapë toni ishte po aq i natyrshëm. U përgatita për diçka jo të mirë, kurse ai tha:

— Prandaj, për këto punë e sjellje do ta kem parasysh të të vë në krye të listës së shpërblimeve të Vitit të Ri, se ja, u afrua. Pastaj, ma treguan edhe atë shakanë që kishe bërë pasi u largova unë nga reparti juaj. Më pëlqeu, veç kujdes, se kështu thellon konfliktet midis kuadrove drejtues të ndërmarrjes.

Këtë ai e tha si kalimthi e duke qeshur dhe, me sa dukej, shakanë time e kishte marrë si për të ngacmuar kryeinxhinierin e jo Dyr Demën. Mbase ashtu ia ka çuar Më-salli, thashë me vete dhe m'u kujtua biseda që kisha bërë me Naim Muratin...

Kur iku drejtori nga reparti, unë nisa provat e para të stampës. Luftari dhe kryeinxhinieri më qëndronin mbi kokë. «Shumë mirë, — tha Naimi kur pa dy-tri copët e detajit të sapostampuar, — s'ka ç'të thotë më shoku Dyr, sepse u arrit në kohë dhe me cilësi.»

— Përse, — e pyeta, — edhe për këtë paska pasur ankesa Dyrri?

Kryeinxhinieri bëri një lëvizje me dorë si për të më thënë «gjëra të zakonshme dhe pa rëndësi». Ndërsa mua nuk e di pse më kapi një dëshirë për ta ngacmuar pak shoqërisht, ndoshta për t'i ndërruar humorin e prishur.

— Përse thotë Dyrri që ti e «mban veten për burrë të zotin», kur në të vërtetë ti je i zoti? — i thashë me shaka dhe i shkela syrin Luftar Zykës.

Kryeinxhinieri i mori pjesët e stampuara anash presës dhe u kthye nga unë.

— Si thua ti? — më pyeti ai me të njëjtin ton.

— S'e di, — thashë unë si naiv.

— Është fare e thjeshtë, — tha ai. — Dyrri ka frikë mos i zë vendin, ndaj flet lart e poshtë duke më paraqitur te të tjerët si njeri më shumë të llafeve sesa të punës. Dhe këtë di ta bëjë mirë ai.

Kryeinxhinieri u nis të largohej, por unë e ngacmova edhe një herë, sepse e dija që ai s'ma merrte për keq.

— Po mirë, — i thashë, — a nuk do t'ia zësh vërtet ndonjëherë vendin Dyrrit?

— Ah, jo tani, — tha. — Dyrri i kanë mbetur edhe disa «merita» që do ta mbajnë për ca kohë aty ku është.

Ne qeshëm, kurse ai u largua. Pas tij edhe Mësalli. Me sa dukej, e merrte me mend se ato që mund të thoshim ne s'kishin shumë interes për të. U habita kur e pashë që iku pas kryeinxhinierit, sepse kisha harruar që ishte aty. Më erdhi inat që na dëgjoji, por nuk e çava shumë kokën dhe vazhdova provat e stampës me Luftarin. Pastaj, kur po dilnim nga reparti i presave, m'u kujtuan fjalët e kryeinxhinierit dhe e pyeta Luftarin:

— E pse tha ashtu Naimi? Çfarë ka pasur Dyrri me stampën?

Luftari nuk u përgjigj menjëherë. Lëvizi edhe ai dorën në ajër si të thoshte «gjëra të

zakonshme për nazet e Dyrrit», dhe pastaj, si me bezdi, tha:

— E, o, deshi të bënte teori njëherë, por, kur e kundërshtuam unë dhe Naimi, e ktheu.

— Pse, çfarë kërkonte?

— Që stampa të mos bëhej kështu e përbërë, por me operacione më vete.

— Vërtet?! — u çudita unë, sepse kjo ishte si të ktheheshe së paku dhjetë vjet prapa në teknologji.

— E, o, e! — bëri prapë Luftari dhe qendroi te shkallët e byrosë teknologjike, por unë vazhdova ta pyesja:

— Po përse i interesonte kjo gjë?

— Për çështje kostoje dhe plani, — tha Luftari. — Ti e di se, sa më e lartë të dalë kostoja e një prodhimi të porositur, aq më shumë plan i hyn ndërmarrjes...

— Nuk e marr vesh, — e ndërpreva.

Luftari buzëqeshi, u ul në shkallë dhe, si mori një copë shkop në dorë, nisi të më shpjegonte duke bërë në ajër ca llogaritje që unë s'po i merrja vesh. Me sa duket, ai e vuri re këtë, prandaj m'u drejtua:

— Shiko, — tha, — po të bëheshin tri stampa, do të punonin tre axhustatorë; do të harxhoheshin tri herë më shumë materiale; do të punonin tri punëtores në presa me trefishin e kohës që do t'i duhej vetëm njëres. Kjo jep shumë mundësi në «hesapet» e fundit për rritjen e shifrës së kostos, por edhe për t'u mburrur «kapërcyem shumë vështirësi teknike», «ç'sakrifica bëmë» etj...

— E qartë, — i thashë se në mendje më erdhi një çudi edhe më e madhe, për të cilën kisha dashur ta pyesja më parë Luftarin: Ç'ishin këto «meritat» e Dyr Demës që, sa herë i dëgjoja nga të tjerët, më ngriheshin nervat? Ç'gjë të mirë kishte bërë ai konkretisht? Mos vallë këto marifete për të rritur koston e kishin bërë kaq të famshëm?

— Jo, ore, jo. I ka bërë disa gjëra, — tha Luftari, — sidomos në fillim, kur ne u kthyem nga kooperativë artizanati në ndërmarrje të industrisë.

— Ti ke qenë këtu në ato kohë? — e pyeta.

— Po, fare i ri... Këtu e bëra edhe shkollën.

Luftari heshti pak, si të kujtonte diçka. Unë vazhdova ta pyesja:

— E çfarë zhvillimi sheh ti në këtë ndërmarrje?

— Oh, mos e tepro, — tha ai. — Mbase ndërmarrja nuk ka ecur aq sa kërkohet, por zhvillim ka.

— Doemos, sepse nuk mund të mbetesh kooperativë artizanati, megjithëse nga pamja e tillë është.

Luftari buzëqeshi prapë. Dukej i menduar dhe sikur dëshironte të më tregonte gjëra që unë nuk i dija. Dhe ashtu që.

— I ke parë ato dy tornot që janë vendosur në fillim të repartit të tornerisë? — më pyeti.

— Po, — i thashë.

— Ato, — vazhdoi Luftari, — i ka sjellë vetë Dyrri në vitin 1956 nga jashtë. Kishte shkuar atje disa muaj për shkëmbim eksperience dhe që miqësuar me drejtorin e një uzine të madhe. Ia mbaj mend edhe emrin, sepse, kur e dëgjoja historinë të treguar nga Dyrri, ky drejtor më dukej si një personazh përrallash. Më vonë mora vesh se përrallë kishte qenë e gjitha ajo që tregonte Dyrri. Ai, kuptohet, i kishte blerë tornot me paratë e shtetit, por thoshte se ia kishte falur miku i tij, drejtori i uzinës, për të na krijuar neve përshtypjen se çdo gjë në ndërmarrje ishte fryt i punës dhe i mendjes së Dyrrit, e, bile, edhe i miqësive të tij.

Luftari heshti papritur dhe më kërkoi një cigare.

— Megjithatë, ti ke njëfarë të drejte, — vazhdoi. — Mjaft gjëra në ndërmarrjen tonë kanë mbetur aty ku ishin. Por siç duket, ne jemi mësuar me këtë ritëm të përgjumur dhe nuk e kuptojmë. Vetëm një fakt po të të them, ti do të çuditesh: ne e kemi kategorinë mesatare të kualifikimit të punëtorëve jashtëzakonisht të ulët, dy pikë një, megjithëse jemi një ndërmarrje jo e re. Dhe kjo është punë e Dyrri Demës. Me Naimin ka pasur gjithmonë debate për këtë gjë. Dyrri mendon se ndërmarrjes nuk i intereson ngritja e punëtorëve në kategori. Puna, thotë ai, do të të jetë po ajo, rendimenti po ai, cilësia po ajo, veçse paga do të ndryshojë, punëtorët do të marrin më shumë, ndërkohë që

ndaj ndërmarrjes do të rriten kërkesat për plan më të madh e cilësi më të lartë. Naim Murati, sigurisht, mendon krejt të kundërtën, dhe ka të drejtë.

— Atëherë, përse nuk kundërshtohet, por lihet të bëhet siç thotë Dyrri?! — u çudita unë.

— Këto që të thashë unë, janë më tepër komente të miat, sepse Dyrri nuk mund të dalë hapur me pikëpamje të tilla.

— Po mirë, a s'e sheh Dyrri që ndërmarrja ka mbetur prapa? — vazhdova ta pyesja.

— Mbase jo, sepse edhe vetë ai ka mbetur prapa. Tani ne po zgjidhim probleme të tilla që nuk ngriheshin më parë në këto përmasa e me këtë thellësi. Këtë Dyrri nuk e kupton. Dhe më e keqja është se nuk bën asnjë përpjekje të mësojë nga të rejtat e shkencës, të teknikës, të organizimit. I duket se mund të vazhdojë të drejtojë po me ato koncepte e mënyra që, si të them, ishin të pranueshme e ndoshta të avancuara sot e njëzet vjet të shkuar...

— Jo, nuk mund të jetë kështu! — e ndërpreva Luftarin.

— Çfarë nuk mund të jetë?... — pyeti ai.

— Që këto mënyra e koncepte mund të kenë qenë ndonjëherë të avancuara...

— Ah, jo! — u ngut të shpjegohej Luftari. — U shpreha unë gabim. Por mendjen e kisha tjetërkund... — Ai heshti një çast, u përqendrua pak, pastaj, si ta kishte gjetur



fillin e mendimit; vazhdoi: — Dyrri nuk është budalla. Në fillim, kur kjo u kthye në ndërmarrje industriale, dolën mjaft probleme të organizimit të prodhimit. Në atë kohë Dyrri filloi të shkëlqente ngado. E drejtoi ndërmarrjen nga disa prodhime të vogla që dikur i bënin zanatçinjtë dhe që s'i kishte shkuar në mendje njeriu se mund të industrializoheshin ndonjë ditë. Kjo i dha mundësi Dyrrit të hapte linja të reja prodhimi dhe të fuste shumë njerëz në punë, sidomos ish-gra shtëpiake. Aq rëndësi patën këto ndryshime në kohën që u bënë, sa mund të themi që sot pothuajse nuk ka lëvizur as numri i punëtorëve (sigurisht, me disa përjashtime), as edhe numri i asortimenteve të prodhuara, gjë që tregon më mirë se çdo fakt tjetër se sa ka bërë dikur Dyrri si drejtues dhe sa nuk bën tani.

— Dhe vetëm kaq janë meritat e tij?

Luftari tundi kokën në shenjë mohimi, hodhi cigaren që i qe shuar pa e thithur as dy herë dhe tha:

— Qoftë edhe kaq, për mua nuk janë pak...

Unë prapë nuk isha i bindur, sepse kisha mendimin që njeriu me merita shpërblehet në kohën që i shfaq këto merita, ndaj s'ka përse ato të kthehen në një paradhënie të përjetshme. Ia thashë këtë Luftarit dhe ai e pranoi si gjykim të drejtë.

— E pra, përse e mbajnë atëherë Dyrri

Demën në atë vend? — u nguta të përfundoja.

— Këtë nuk mund ta them, — mblodhi supet ai, — por besoj se shpejt do të zbulohet që është bërë krejtësisht i paaftë dhe atëherë, siç thua ti, do ta heqin që andej.

Mua nuk më pëlqeu ky gjykim i Luftarit, ndaj i thashë:

— Epo, or ti, Luftar, kështu si mendon ti, është si puna e hoxhës që ra nga minarja. A e di si ra?

— Jo, — tha, — si? — dhe qeshi.

— Po ja, — tregova unë, — thonë se një hoxhë i vinte rrotull një gruaje të bukur. I biri i kësaj gruaje e shikon dhe shkon e i tregon të atit. I ati e dëgjon, por e këshillon të birin që të mos shqetësohet, sepse hoxha do ta gjejë të keqen nga allahu. Mirëpo hoxha po bëhej përditë e më i bezdisshëm për nënën e djalit dhe nga allahu s'po e gjente gjë. Atëherë djali nuk duron më dhe një mbrëmje, kur hoxha ngjitet në minare për të thirrur ezanin e akshamit, ngjitet edhe ai pas tij dhe i jep të shtyrën nga mbrapa. Të nesërmen i ati i thotë të birit: «E shikon, more evlat, se si e gjeti hoxha nga allahu?» I biri i përgjigjet: «E shikoj, babë, por u desh pak edhe ndihma ime.»

Luftari qeshi dhe i pëlqeu morali i fabulës. Pas pak u ngrit si me përtesë dhe tha:

— Unë po iki.

Ai u largua me hap të ngadalshëm, ndër-

sa mua m'u kujtua biseda që kishim bërë dy net më parë për Marie Voglin. Ndjeva keqardhje për të. Si ka mundësi, thashë me vete, që ky njeri t'i kuptojë aq mirë punët e ndërmarrjes dhe të mos jetë në gjendje të marrë vesh që po luajnë me ndjenjat e tij?

Keqardhje po ndieja tani edhe për vete, kur Dyrri po më lësharte për të më vënë në gjumë. Ose kështu më dukej mua, ngaqë kisha përshtypjen se priste një reagim e një fjalë timen. Por unë nuk fola fare, sepse nuk i besova asgjë nga ato që më tha. Megjithatë, e përshëndeta me kokë dhe dola.

Gjithë pasditen mendova për ato që më tha dhe më erdhi një si frikë. Kishte diçka, një si shtresë të sipërme në fjalët e tij që unë, edhe pse nuk e dija ç'fshihej nën të, e merrja me mend se një gjë të ligë e vërtisnin nëpër fugën e tyre. Dyrri, që me sa dukej qe trembur nga ajo që kisha bërë unë, po mendohej të mos e tregonte veten, për të më lënë të harrohesha e pastaj të gjente rastin të më hiqte vizën, të më fuste në rrethin e kuq. Kështu, tregonin, kishte bërë edhe me disa të tjerë: u kishte rrahur supet kur prisnin ndonjë qortim dhe u kishte dhënë rrugët pikërisht kur e ndienin veten më të harruar se kurrë.

Por këto i mendova vetëm gjatë rrugës nga zyra e Dyrrit në repart, sepse këtu fillova të gjykoja krejt ndryshe dhe me një kthjell-

tësi që po më habiste. Tani e kisha aq të qartë se ç'kishte qenë ky Dyrr Dema dikur dhe ç'ishte sot, sa mund ta shprehja me pak fjalë dhe pikërisht kështu: Kishte qenë një burrë i ri me ambicie të drejta për punën, ndaj kishte bërë në fillim edhe ato gjërat e mira, për të cilat e kishin vlerësuar dhe shpërblyer. Atëherë ai kishte provuar shijen e sigurisë dhe të asaj fuqie që i kishin dhënë. Që këtu, ambiciet për punë të mira kishin nisur t'i ndërronin kah, derisa një ditë atij iu duk se po zbulonte gjeniumin e vetvetes. Dhe, që nga ajo ditë, ai kishte rendur për të ardhur te ky Dyrr që ishte sot: një gjysmëperëndi e vogël që donte shumë për vete dhe pak për të tjerët, që priste gjithmonë të merrte më shumë sesa jepte. Në thelb, ky ishte për mua Dyrr Dema dhe i tillë duhej të ishte për cilindo që kishte menduar sadopak për atë dhe veprimet e tij.

Nuk kisha pasur kurrë ndonjëherë ditë kaq të lira dhe më pa kuptim sesa këto që Dyrrin më tha t'i bëja pushim. E parashikoja me kohë se ku do të kaloja lejen e zakonshme, ndërsa tani, tek ecja rrugës i vetëm, po mendoja se ç'mund të bënte një si unë, kur të gjithë shokët e miqtë e tij ishin të zënë me

punët e tyre. Mund të shkohet në kinema, thashë me vete dhe për atje u nisa kur dëgjova një zë që më thirri prej diku nga e majta. E njoha menjëherë dhe u ktheva andej. Shpresa Bilali më ngriti dorën që nga trotuari tjetër dhe e kaloi rrugën me nxitim.

— Nuk paske shkuar në punë? — më pyeti.

— Jo, — i thashë, — më ka dhënë Dyrri një javë pushim.

— Ah, shumë mirë. Ku do të shkosh?

— Në kinema. Do të vish ti?

— Jo, dhe; po të duash; mos shko as ti.

— As unë? E pse?

— Kot. Rrimë pak bashkë ose... Si të kesh qejf.

Kuptohej që dëshironte të më thoshte diçka, ndaj nuk ngurrova.

— Nuk po shkoj, — i thashë. — Po ku të rrimë?

Ajo ngriti supet.

— Ecim këtej, — tha dhe bëri me dorë nga rruga e Elbasanit.

— Jo, ulemi më mirë në ndonjë kafe.

— Si të duash.

Shpresa tha se mund të rrinim te «Drini», që ishte lokali më i afërt dhe më i rehatshëm.

Porositëm kafe. Unë mora edhe një raki. Më pas, filluam të vështroheshim në sy e t'i buzëqeshnim kot njëri-tjetrit, si dy nje-

rëz që kanë dhe nuk kanë ç'të thonë midis tyre. Nuk mund ta duroja atë gjendje.

— Hë? — e pyeta Shpresën.

— Hiç, — ia bëri ajo dhe mori në duar pjtën bashkë me filxhanin e kafesë. Si e piu të gjithë, serioze, më tha:

— Isha në Komitetin e Partisë.

Ajo vuri filxhanin në një cep të tavolinës, si t'i pengonte pamjen, dhe heshti. Unë prita të vazhdonte, pa e nxitur.

— Ti, Fred, ke diçka të veçantë, që të ngjall shpejt besimin e të bën të të tregosh ca gjëra që nuk mund t'ia tregosh kujt do...

Pata përshtypjen se ajo po ndërronte bisedë, por Shpresa vazhdoi:

— Ne kemi ardhur në ndërmarrje gati në një kohë dhe qysh në fillim m'u duke djalë i sinqertë, ndaj u bëmë shokë shumë shpejt. Të kujtohet?

— Si jo. Për herë të parë kemi folur për ekspozitën e hapur me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Partisë.

— Po... Pastaj ti u fejove me Donikën dhe... Nejse, ne tani jemi shokë si më parë, e ndoshta më të ngushtë, sepse unë me Donikën jam rrftur... Po pse t'i them këto? Nuk e di. Tjetër gjë kisha në mendje.

— Thuaje.

— Po.

Megjithatë, ajo heshti aq sa unë e mbarova rakinë dhe kafënë.

— Të thashë se isha në Komitetin e Partisë, të rrethit, — filloi ajo. — Do të bëhet një mbledhje e gjithë ndërmarrjes, për të parë edhe te ne se si, «kur flet klasa, nuk flet burokratizmi»... Nejse...

Unë buzëqesha lehtë me të folurit e saj si me hope, me «nejse» të përsëritura. Shpresa më vuri re.

— Ç'ke?

— Asgjë, — i thashë. — Vazhdo.

— Po, do të bëhet, pra, një mbledhje e madhe, këto ditë ose pak më vonë.

— E përse pak më vonë?

Ajo u mendua para se të përgjigjej, pastaj tha:

— Ti e di, Fred, këto punë bëhen të matura. Shokët e rrethit kërkuan të informoheshin edhe nga unë për disa probleme që e shqetësojnë kolektivin tonë dhe që ata mendojnë se duhen trajtuar në këtë mbledhje. Kishin biseduar edhe me Musa Zhurin, ndaj më kërkuan t'u flisja qartë dhe hollësisht. Nejse... Ua thashë të gjitha. U fola edhe për fërkimet me punëtorët dhe për atë rastin e dërrasave... Nejse... Puna është që në atë mbledhje të flasim të gjithë...

— Dhe besoj se do të flasim, — e ndërpreva.

Ajo ngriti vetullat.

— Varet, — tha

— Nga se?

— Nga përgatitja për mbledhjen, për

rëndësinë e saj, për rëndësinë që ka ajo për të gjithë ne...

— Do të flasim, — rregula këmbë, — sepse ka kohë që në ndërmarrje kanë filluar pëshpëritjet, dhe dihet, kur nisin pëshpëritjet, vjen një ditë që zërat ngrihen.

— Po. Bukur! — tha ajo — Por njerëzit duhet edhe të nxiten, t'u hiqet druajtja që kanë, sepse disa ende rrinë nën hijen e drejtorit, disa janë indiferentë e ca të tjerë, për shkak të ndonjë gabimi që mund të kenë bërë, struken e nuk ndihen. Edhe këta duhet të flasim... Kurse për ty është ndryshe. Ti nuk ke heshtur edhe kur mund të heshtje... Nejse...

— Pse, kam bërë gabim që nuk kam heshtur «edhe kur mund të heshtej»? — e ironizova pa të keq.

— Jo, — tha, — por ke qenë... s'di si të shprehem.. ke qenë... spontan.

— Spontan? Në ç'kuptim?

— Po ja, në atë kuptim që... që ke folur, ke kundërshtuar, ke quajtur të padrejtë një gjë që e ke pasur pranë, para syve, pa kërkuar shkaqet e të metave, pa menduar thellë për organizimin në përgjithësi të punëve në ndërmarrje... Ja, pak a shumë, kjo është për mua spontane.

Nuk fola. Nuk më pëlqente fjala «spontane». Më dukej pa kuptim, si një grua e bukur që shfaqet e zhduket si për të të provokuar, sa për të të ngritur rervat. Megji-



thatë, edhe pse bëra një gjest mospërfilljeje, në vërtetë po mendoja për ato që thoshte Shpresa. E kuptoja dhe i jepja njëfarë të drejte, por më tepër më dukej se nuk ishte puna ime t'i shihja gjërat aq thellë.

— Ashtu është, — i thashë, — veçse nuk më takon mua të merrem me ato që u përkasin të tjerëve.

Shpresa më vështroi në një mënyrë që s'e durova. M'u duk sikur me atë shikimin e saj po më thoshte: I shkreti ti, pse nuk i kupton gjërat siç janë? Po ajo vetë, i dinte të gjitha apo bënte sikur i dinte? Kush e kishte bërë atë të ishte aq e sigurt dhe aq e padruajtur për çdo gjë që i bluante koka e saj e vogël?

— E ke gabim, — tha.

Unë nënqesha.

— Mbase, — i thashë, — por unë mendoj se, derisa ka një organizatë partie, një drejtori e një administratë të tërë që merren me drejtimin e ndërmarrjes dhe i dirë mirë detyrat e tyre, ne punëtorëve na mbetet të shohim ato që lidhen ngushtë me punën tonë, me cilësinë, me rendimentin, me disiplinën...

Shpresa më kapi dorën dhe ma shtrëngoi lehtë. Mua më erdhi inat dhe e tërhoqa dorën time. Gjeste të tilla më dukeshin profesionale, domethënë një e drejtë që asaj ia jepte pozita si zëvendëssekretare partie. Ose, në mos kjo, ishin tepër autoritare. Dhe as këtë nuk e duroja... Ajo e ndjeu tkurrjen

time, por nuk më pyeti ç'kisha. Vazhdoi mendimin e saj.

— Po. Mirë. Nejse... — tha. — Kjo është njëra anë, e drejtpërdrejta, po e quajmë. Kurse ana tjetër, ajo që të duket se s'ka të bëjë shumë me ty, për mua është më e rëndësishmja. Pse, do të thuash ti. Sepse, kur një punëtor është në gjendje të kuptojë se si funksionon administrata, bie fjala, se si bëhet qarkullimi i prodhimit dhe se si raportohet plani i ndërmarrjes, se ç'masa merren e si organizohet përqendrimi i një prodhimi, se si janë lidhjet midis Partisë dhe drejtorisë, se si zbatohen ligjet e shtetit në ndërmarrje e të tjera si këto, ky punëtor sigurisht që do të dijë t'i kuptojë më mirë edhe ato gjëra që lidhen drejtpërdrejt me punën e tij. Dhe ky punëtor kërkohet sot, apo jo?

— Jo, — e kundërshtova, — ky punëtor do të ketë më pak kohë për të mësuar mirë frezën a tornon e tij. Teorikisht, ky është punëtori ideal i socializmit. Kurse praktikisht, ky punëtor do të kërkonte më shumë te të tjerët dhe më pak te vetvetja, si punëtor them, jo si qytetar. Dhe ky punëtor, vetvetiu, do të bëhej çdo ditë e më tepër një shef sesa një mjeshtër i mirë i punës, sepse edhe kohën më të madhe për këtë gjë do ta harxhonte.

I fola pak ashpër, i shtyrë nga një dëshirë e fortë për ta kundërshtuar. Nuk isha i bindur për ato që thosha, ndaj prisja me

kureshtje se si do të më përgjigjej Shpresa Por ajo nuk u përgjigj menjëherë, si zakonisht. Me sa dukej, gjykimi im ia kishte turbulluar pak mendimet. Megjithatë, pas pak, me zë të ulët dhe si t'i vinte keq që ne s'kishim të njëjtat mendime, ajo tha:

— Sikur njerëzit të kishin vuajtur vetëm për mungesën e kohës, s'do ta kishin fare të vështirë të mësonin se si ta zotëronin plotësisht atë. Por, e shkreta kohë, ajo ra është dhuruar me aq bollëk, sa ne s'dimë ç'të bëjmë me të...

Po, kishte të drejtë. I pari isha unë që s'dija ç'të bëja me kohën që më kishte dhënë Dyrri Dema. Dhe, aq e vërtetë ishte që s'dija ç'të bëja e ku të shkoja tërë ato ditë, sa isha i bindur se të nesërmen apo të pasnesërmen do të kthehesha përsëri në punë.

E kisha admiruar Shpresën. Po e admiroja edhe tani, megjithëse ende e kisha atë dëshirën për ta kundërshtuar. Ajo ishte aq e re, sa duhej të bëje përpjekje të mëdha për ta bindur veten se ishte pikërisht ajo që fliste e jo një tjetër nëpërmjet gojës së saj. Dhe, çuditërisht ishte gati e pamundur ta pranoje aq të ditur... M'u kujtuan fjalët që më kishte thënë Dyrri në mbrëmjen të «Drini». Unë kisha treguar një histori akcioni për të qeshur, ku kisha përdorur edhe fjalët «ndërmjetësi horizontale» që Dyrri i qenë dukur mjaft të intelektualizuara dhe ai më kishte thënë: «Ti nuk je punëtor, Al-

fred, veçse nga puna që bën.» «Nuk jam punëtor?! E përse?» «Sepse punëtori nuk flet kështu si ti.» «Ha-ha-hii!» kishte bërë kovaçi. «Punërrëtëhë, felrë sirrëhë ur» Çfarë? «Punëtori flet si unë», i kishte përkthyer Mësalli fjalët e kovaçit dhe ne ia kishim plasur të qeshurit... Si e kuptonte Dyrr Dema punëtorin dhe si e kuptonte Shpresa që s'kishte mbushur as njëzet e tre vjeç...

— Ashtu duhet të jetë, Shpresa, — i thashë, — si thua ti, — dhe nisa ta vështroja përmes tymit të cigares që ia mjegullonte fytyrën. E largova tymin me dorë dhe ia ngula sytë më fort...

Para se të fejojhesha me Donikën, disa kohë kisha menduar për Shpresën, por gjithnjë me një ndjenjë si të përzier, si me respekt e dashuri bashkë. Atë kohë ne takoheshim e rrinim duke biseduar. Dy herë kishim hyrë në të njëjtën kafe dhe unë e kisha përcjellë vonë në shtëpi. Një mbrëmje mund të ishte vendosur diçka më shumë midis nesh por, për fat të mbrapshtë, pikërisht atë natë kishin vënë një llabë elektrike në hyrje të pallatit të Shpresës. Edhe ajo tha: «Uh, paskan vënë dritë këtu?!» Dhe mungesa e errësirës më bindi që nuk isha burrë. Kishim qëndruar fare pranë njëri-tjetrit, dhe nuk e di ç'më përmbajti që s'e putha. Isha gati i bindur që ajo e priste këtë nga unë dhe prapë nuk guxova. I thashë natën e mirë dhe u largova.

Vetëm të nesërmen e kuptova përse kisha

ngurrUAR. Jo nga drita. Kisha paqur frikë nga ajo, një frikë që më vinte ndoshta më shumë nga respekti për të. Sepse, ç'është e vërteta, ajo më dukej më tepër nga sa mund të meritoja dhe se, po të ma prishte do ta ndieja për gjithë jetën turpin që kisha guxuar të kërkoja një gjë që s'më takonte. Dhe, me këtë mendim, nuk i thashë më të shiheshim. Por edhe ajo, nuk e di për çfarë arsyeje, nuk e nxiti më tej ndjenjën time dhe ne kishim mbetur shokë.

Tani që ajo rrinte aty, përballë meje, po provoja diçka të pakuptueshme, një si paralajmërim për kujdes që më mrekuallonte e më trembte njëkohësisht, aq sa u ngrita nga tryeza pa i kërkuar mendim Shpresës.

— Ilkim, — tha edhe ajo sikur ta kishte kuptuar ç'po provoja në ato çaste.

Kur po ndaheshim, Shpresa më zgjati dorën.

— Do të bisedojmë prapë në ndërmarrje, — më tha — Ose, po të mos keni ndonjë plan dalim në mbrëmje bashkë me Donikën.

— Po, patjetër, — u nguta t'i përgjigjesha dhe sikur e ndjeva veten disi të çliaruar nga ajo gjendje e pakëndshme.

Më vonë, kur u shryva në drekë për të pushuar, mendova qetësisht për atë gjendje aq të papritur dhe kuptova që ndjenja për Shpresën ndryshonte nga ajo që kisha për Donikën. «Është një ndjenjë fare e kuptueshme».

me dhe tepër sublime,» më tha im vëlla  
kur i tregova se ç'kisha ndier atë pas-  
dite

Dhe ashtu duhej të ishte, vërtet. Sepse,  
duke ndenjur në mbrëmje me Shpresën dhe  
Donikën, të fejuarën time e desha më shumë  
se çdo herë tjetër. Këtë e ndjeu edhe ajo  
vetë, që më tha se atë natë isha më i dashur  
dhe më i afërt

Është e vështirë ta gjykosësh drejt një njeri, për të cilin ke një ndjenjë simpatie e aq më tepër një lidhje miqësore. Për sytë dhe mendjet tënde, ky njeri është më shumë ashtu siç e dëshiron ti. Një anë e karakterit apo e sjelljeve të tij patjetër që do të mbetet jashtë vëmendjes sate. Pak a shumë, këtë kishte dashur të thoshte edhe një shok i vëllait tim, mjek, që kishte ardhur njëherë për ta vizituar në shtëpi. Ai kishte marrë me vete edhe një kolegun e tij. «Unë nuk mund të jem krejt i saktë në përcaktimin e diagnozës së njerëzve që njoh, e aq më pak të atyre që i dua. Prandaj mora edhe këtë shokun me vete», — pati thënë ai atëherë. Kështu më dukej edhe mua tani: për të njohur mirë Shpresa Bilalin, duheshin

gjykimet e të tjerëve, duheshin marrëdhëniet e të tjerëve me të. Se ja: unë e njihja mjaft të zgjuar dhe për këtë e admiroja; e njihja tepër tërheqëse dhe për këtë e pëlqeja. Por as që mund ta merrja me mend se si mund të ishte ajo «e egër, agresive»; siç e quajti Natali Hajredini. Ajo kishte qerë e prani-shme në bisedën «aq të ashpër» që kishte pasur Shpresa me Dyr Demën dhe që habitur se si mund të fliste një vajzë njëzetetrevjeçare në atë mënyrë, sidomos me drejtorin e saj dhe me një burrë në moshë e të pjekur si Dyrri. Në të vërtetë, as mua nuk më pëlqenin vajzat e «egra» dhe «agresive», por Natalinë nuk e besoja plotësisht. Ndaj e pyeta se çfarë i kishte thënë Shpresa Dyrri konkretisht.

— Që t'i përsërisja, do të më vinte rëndë nga vetja, — tha ajo, — por ty do të t'i them, sepse e di që e ke shoqe të ngushtë dhe ndoshta ndien edhe njëfarë dobësie për të...

— Fol, Natali, — e ndërpreva, sepse më erdhi inat me djallëzinë e saj.

Ajo bëzëqeshi duke e theksuar akoma më tepër djallëzinë e fjalëve të saj dhe u afrua aq pranë morskës sime, sa më pengoi të punoja.

— Si thua ti Alfred, — vazhdoi, — është e hijshme për një vajzë të re që të hakërrohet gjithë arrogancë, kur duhet të jetë e qetë dhe e dashur me njerëzit?

— Si ti, për shembull, — nuk m'u durua pa e ngacmuar.



— Oh, — tha ajo, — ndoshta si unë është e vështirë të bëhet ndonjë vajzë nga këto të sotmet. Por unë nuk e kam fjalën këtu. Çfarë gjëje interesante mund të gjejë një djalë si ti te një shoqe që s'i vjen turp t'i thotë një burri të nderuar fjalë sharëse nga më banalet? Ti nuk mund ta marrësh me mend se ç'skenë u krijua! Në vend që t'i ulërinte drejtori asaj dhe ta flakte përjashta pa e duruar deri në fund, çirrej ajo dhe largohet nga zyra duke i tundur gishtin. Prandaj, Alfred, çuditem me ty, si mund ta kesh ti shoqe këtë vajzë kaq të harbuar? Më fal për fjalën që përdora, por e tillë është.

— Mirë, Natali, — i thashë, — faleminderit që më dhe një këshillë të vlefshme, por tani duhet të më lësh të punoj.

— Patjetër, — tha Natalia dhe u largua duke lënë prapa një nga ato buzëqeshjet e saj që i dhuronte bujarisht.

Deri në drekë unë mendova për Shpresa Bilalin. E kërkova dy herë në repartin e saj, por s'e gjeta. Nuk doja t'i besoja Natalisë por edhe nuk më vinte mirë që ajo të grindet ashtu me Dyr Demën. Sesi më dukej ajo mënyrë, si e lejueshme vetëm për burrat. Gratë, thosha me vete, kanë të tjera armë lufte, jo hakërrimet dhe të bërtiturat. Do t'ia thosha këto Shpresës, por nuk po e gjeja. Sidoqoftë, do ta bisedoja me Donikën dhe në mbremje mund t'i shkonim bashkë në

shtëpi. Por, pikërisht kur ne po dilnim nga puna, ajo na zuri të dy nga krahu dhe na tha:

— Më prisni një minutë, sa të vesh pallton.

Ne vazhduam të ecnim ngadalë drejt portës së ndërmarrjes. Ndaluan një çast dhe kthyem kokën prapa. Shpresa erdhi e u fut midis nesh, duke na zënë prapë nga krahët.

— Ju ndava, — tha. — Në punë ju ndan Mësalli, jashtë pune unë.

Donika qeshi.

— Ah, jo! — tha. — Nuk na ndani dot, edhe sikur t'i bashkoni forcat. Hë, Fredi? — ajo përkuli pak kokën nga unë.

Por mua s'më vinte për të qeshur. E kisha mendjen te fjalët e Natalisë dhe, veç kësaj, Mësall Sula po vazhdonte vërtet të na bezdiste. Kërkonte gjithfarë mundësisë për t'u gjetur në bisedë me Donikën dhe, si gjithmonë, nënqeshte me ironi, për të lënë të nënkuptohej se midis tyre ende nuk kishte mbaruar çdo gjë. Por vallë a kishte pasur gjë ndonjëherë midis tyre? Më torturonte kjo pyetje sa herë që më shkonte në mendje, por Donikës nuk kisha guxuar t'ia bëja. Për Mësallin e ndonjë tjetër, dyshimet, grindjet, mërzitia ime do të ishin një kënaqësi e vërtetë. Ca gjëra me kuptim e pa kuptim do të mblidheshin aq sa të bëheshin një xhelozie e pashërueshme. Kështu thoshte im vëlla për pyetjet e pafundme që i bënte e shoqja kur punonte me diplomën e

ndonjë studenteje. «Kjo, — më thoshte mua për Ketin, — ka pasur një fatkeqësi, por nuk është bërë kurrë e vetëdijshe për atë fatkeqësi. Kjo dëshironte të më kishte mua udhëheqës diplome, por, meqë unë isha pedagog i saj dhe nuk mund t'i bëja edhe drejtimin e diplomës, u detyrua ta punonte temën me një njeri që nuk ndodhi korrekt. Dhe aq shumë i bëri përshtypje kjo gjë, sa do të ishte prishur edhe me mua, sikur marrëdhëniet tona të mos kishin shkuar larg. Ha-ha-ha! Nuk e kupton kjo se jo çdo udhëheqës diplome e ngacmon studenten e tij. Përkundrazi. Jo çdo udhëheqës guxon ta ngacmojë...»

— Fredit nuk i pëlqeu shakaja, — tha Shpresa. — Por më duket kishte të drejtë. Qe fare pa kripë. Nejse... E dimi që sot më ka habitur ai Mësall Sula?!

— Pse çfarë? — pyeti Donika.

Unë nuk tregova asnjë kureshtje. M'u kujtuan përsëri fjalët e Natalisë. Shpresa e ndjeu mosinterisimin tim dhe sikur i mbeti qejfi. Kishte nisur të tregonte me gjallëri, por gjallëria iu shua dhe ajo më pyeti me zë të zvargur:

— Nuk ke dëshirë të dëgjosh, Alfred?

— Jo, vazhdo, — i thashë.

Por ajo nuk vazhdoi menjëherë dhe një copë rrugë ecëm në heshtje. Pastaj Shpresa filloi të fliste me një humor krejt të ndryshuar, si e menduar, si e pezmatuar, si e trishtuar.

— Nuk e kisha dëgjuar kurrë Mësall Sulën t'i kundërvihet Dyr Demës, — tha. — Nuk arrija të kuptoja ishte lojë apo një inat i mbledhur me kohë që tani po niste të derdhte vrerin... Nejse. Por nuk ishte një gjë e zakonshme që Mësalli t'i thoshte në sy se shefja e planit, Natali Hajredini, nuk duhej të qëndronte në atë post. Unë nuk e kuptoj se si është lejuar deri tani që një person me cene në biografi të mbajë një post kaq të rëndësishëm, — tha, — dhe për këtë përgjegjësinë e mban drejtori, shoku Dyr. Nuk po u besoja veshëve, Donika! Dyrri e pranoi gabimin dhe premtoi se do ta ndreqte këtë punë. «Si ndryshuan këta?» thosha me vete... Nejse. Se ç'paska Alfredi sot...

— Jo, asgjë. Të dëgjova me vëmendje, — i thashë. — Po ti përse ishe grindur me Dyrin? — e pyeta pas pak.

Shpresa më vështroi e habitur.

— Kush të tha ty?

— Natali Hajredini, — i thashë. — Më tregoi edhe se si i qe hakërruar ti Dyr Demës... si e kishe sharë...

Shpresa uli kokën mjaft e zymtuar dhe si e fyer. Donika pyeti gjithë kureshtje:

— Vërtet jeni zënë?!

— Po, — tha, — po nuk i jam hakërruar Dyr Demës dhe nuk e kam sharë ashtu siç mund t'i ketë thënë Natalia Alfredit. — Ajo heshti gjatë, pastaj vazhdoi:

— Unë i shkova vetë në zyrë. Desha ta rrahmoja për mbledhjen që do të bëhet për luftën kundër burokratizmit, t'i thosha ato që mendoja për të dhe për drejtimin e ndërmarrjes nga ai, desha ta vija edhe në dijeni të atyre gjërave që kisha biseduar në Komitetin e Partisë të Rrethit, sidomos të disa qëndrimeve që s'më qe dhënë rasti t'ia thosha më parë as në organizatë e as në byro. Në fillim ai më dëgjoi qetë, siç e ka zakon, por pastaj më tha se unë isha karrieriste, se dëshiroja t'i zija vendin Musa Zhurit, e më pas ndonjë tjetri, e kishte fjalën për veten, se unë isha dembele, se i bëja këto presione për të fituar ndonjë vend të rehatshëm dhe se, kështu, më në fund, me këto kushte, mund ta gjeja edhe unë një burrë. Atëherë as unë nuk e durova më dhe i thashë se ç'ishte ai, jo vetëm sipas meje, por për të gjithë punëtorët e ndershëm të ndërmarrjes. Po nuk u hakërrova. Fola qetë, natyrisht, me ton ironik, si Dyrri. Natalia hyri në zyrë kur po flisja unë dhe nuk i dëgjoi ato që tha Dyrri. Po, edhe sikur t'i kishte dëgjuar... Nejse. Unë prapë do t'i dukeshja e hakërruar... Sigurisht, nuk jemi njësoj... Ajo shquhet për mirësjellje...

Tani që ajo fliste kështu unë po zbuloja një anë tjetër të karakterit të saj: vendosmërinë. Dhe po më dukej vetja i keq, ndaj u mundova të gjeja ndonjë fjalë të mirë, ndonjë shaka a diçka për t'i thënë Shpre-

sës se tani isha në humor, por, duke u kthyer te biseda e saj e parë për Mësall Sulën, gjeta një gjë fare pa lezet.

— Më duket, — i thashë, — se Mësalli e ka mbajtur atë qëndrim për t'u dukur ty tërheqës. Bile, kohët e fundit, e kam vënë re që të ndjek me vështrim nga prapa. Dhe, si pamje, shkoni ju...

U pendova në çast dhe prita që Shpresës t'i mbetej qejfi, por ajo vetëm buzëqeshi.

— Jo, nuk e bëri për t'u dukur tërheqës tek unë — tha. — Ndërsa, për atë tjetrën, që më ndjek me vështrim, më vjen keq që s'e kam vënë re...

Qesha me zë, më tepër ngaqë e ndjeva veten të lehtësuar. Qeshën edhe ato pas meje.

Shpresa qëndroi papritur,; na doli përpara si të na ndalonte të ecnim dhe tha:

— Kam një ide: ejani tek unë për drekë. Jam fare vetëm. Kanë ikur të gjithë te gjyshi në Kavajë. Ejani!

Donika më pyeti me vështrim. Unë ngrita supet. Shpresa nuk priti përgjigje tjetër. Hyri përsëri midis nesh, na zuri nga krahët dhe na futi në një rrugicë, në të dy anët e së cilës ngriheshin ca shtëpi të vjetra dhe, aty-këtu pallate të saponduarta. Në pallatin e dytë, në shkallën e dytë dhe çuditërisht në katin e dytë banonte Shpresa Bilali, që i ngjiste edhe shkallët dy e nga dy.

Aq shpejt e bëri gati tryezën Shpresa, sa mund të besoje që kishte qenë e shtruar më parë. Nga aneksi i kuzhinës solli dy pjata, njëren me djathë të prerë në feta të gjata dhe tjetrën me domate serash të ndara në katërsh. Në bufe mori dy shishe dhe tri gota. Atë me raki ma vuri përpara mua, atë me verë Donikës. Nga frigoriferi nxori sallam dhe kos.

— Kaq sa për të filluar, — tha. — Pastaj skuqim nga një vezë me gjalpë.

— Oh, s'ka nevojë për gjë tjetër! — thamë ne gati me një gojë dhe nisëm të pinim e të flisnim po me atë shpejtësi që na kishte shërbyer Shpresa.

Shpejt, ende pa e pirë një gotë, e ndjeva veten si të dehur. Po më pëlqente çdo gjë në atë kuzhinë të thjeshtë të tipit të përgjithshëm: me një bufe në faqen e murit përballë, me një divan e dy kolltukë rreth tavolinës së mesit, me perde damasku e najloni, me lule shqiponje e fikus, me një kalendar muri, me një peizazh bregdetar dhe me portretin e shokut Enver në vendin më të dukshëm. Por, mbi gjithçka, më pëlqenin të qeshurat e atyre të dyjave që kujtonin histori të kohës së shkollës teknike. Ato flisnin me aq dëshirë për gjëra që i dinin vetëm ato të dyja, sa dikush tjetër do të qe bezdisur dhe fyer, por unë jo. Më pëlqente t'i dëgjoja, ndoshta pikërisht pse të dyja i ndieja pranë...

Por kënaqësia e një njeriu nuk mund të zgjatka shumë, derisa nuk qenka edhe këna-

qësi e të tjerëve. Sepse, ja, mjaftuaka të hyjë në të kujtimi i një gjëje të pakëndshme, një fjalë a një emër i padëshiruar, që ajo të prishet e të mos mbetet më asgjë nga mrekullia e një çasti më parë. Kështu ndodhi edhe me mua. Nuk e di si, i mbaruan historitë ato apo Shpresa ndërroi bisedë papritur, që u kujtua të më pyeste prapë për Mësall Sulën. Një zot e di ç'më përmbajti të mos i thirrja: «Ç'më çan kokën me gjithë Mësallin!» Bëra sikur s'e dëgjova dhe ndeza një cigare.

— Fred, — Shpresa më vuri dorën në parakrah si për të më marrë me të mirë, — të pyeta për Mësallin. Përse thua ti iu kundërvu drejtorit ai?

— Sepse, — thashë me inat, — njerëzit kështu janë. I kuptojnë gabimet e tyre dhe ndreqen, bëjnë kritika e autokritika. Edhe Mësallit, i lumtë që e paska kuptuar se s'mund të rrijë gjithë jetën në hijen e Dyr Demës! Pastaj, tani ai sikur po mëson edhe frëngjisht, e kjo me siguri ia rrit ca personalitetin...

Donika më vështroi e habitur. Por unë e dija vetë që kisha thënë gjëra të fryra. Veçse jam i bindur se kushdo që të ishte në vendin tim, ashtu do të fliste, po ta detyronin të shkëputej nga mendimet e tij të këndshme për të thënë diçka krejt të pakëndshme. Ndaj e piva rakinë e mbetur në gotë me fund dhe ktheva vështrimin nga dritarja i pezmatuar.



— Oh, të mërzita shumë më duket, — tha Shpresa dhe më mbushi gotën me raki duke më buzëqeshur si të më kërkonte ndjesë.

Më erdhi vërtet turp. Po më përkëdhelnin, ndoshta ngaqë isha vetëm unë midis atyre dy shoqeve të ngushta. Ula kokën dhe fillova të pija raki me gllënjka të vogla, pa e hequr gotën nga dora. Pas pak, kur të nxehtët m'u largua nga fytyra, e ngrita kokën dhe pyeta Shpresën:

— Po ti si thua, pse e bëri Mësalli këtë?

Ajo duket e dinte përse, ndaj e kishte hapur atë bisedë, për të na e bërë edhe neve të qartë se si dinin të ndërronin lëkurë disa njerëz, kur ndienin se po u rrëshqiste toka nën këmbë.

— A i lexon përditë gazetat ti, Alfred? — nisi ajo dhe s'priti përgjigje. — Nejse... Ti e di se si po zien i gjithë vendi nga lufta kundër burokratizmit, se si po ngrihen punëtorët kudo nëpër mbledhje për të dënuar qëndrimet burokratike, arrogante e prepotente të shefave dhe të kujtqë i shfaq ato... Nejse. Ti di, gjithashtu, që së shpejti do të bëhet mbledhje edhe në ndërmarrjen tonë dhe ca nga ata, që ne i njohim si kanë punuar deri më sot, sigurisht që kanë filluar ta ndiejnë breshrin që i pret, e në një mënyrë a në një tjetër, do të mundohen të dalin sa më pak të lagur. Mësalli gjeti këtë mënyrë, e ndoshta më të zgjuarën. Ai ka ndenjur shumë me Dyrin dhe i di mjaft gjëra. Duke dalë kundër tij, Dyrri do të jetë i dety-

ruar ta heqë qafe duke e çuar në një vend më të mirë. Prandaj edhe ato fjalët se Mësalli po mëson frëngjisht, ngaqë e kanë kërkuar në një punë ku duhet gjuha e huaj, s'janë pa gjë... Nejse, do ta shohim...

Ajo heshti dhe piu verë.

— E qartë fare, — tha Donika. — Ai është i prerë për djallëzira. Ku s'i vete mendja. Dhe, sa për atë punën e mirë ku do të shkojë, pothuajse nuk e vë fare në dyshim... Po më duket se lllomotit ca si tepër, vetëm për t'u mburrur.

Shpresa u ngrit.

— Po skuq vezët, — tha. — Për dy minuta janë gati.

— Ulu, Shpresa, unë u ngopa! — i tha Donika.

— Rri, nuk duam asgjë, — i thashë edhe unë, por ajo iku në aneks, mori ca pjata në duar dhe pas pak ne dëgjuam kërcëllitjen e vezës në gjalpin e shkrirë dhe era e tij erdhi deri te ne.

Mbetëm vetëm. Donika më buzëqeshi, pastaj më puti në faqe. E puti edhe unë.

— Mirë? — ia bëri ajo.

— Shumë mirë, — i thashë. — Shpresa është vajzë e rrallë.

Donika më vështroi gjatë në sy e në një mënyrë që më bëri të mos e duroja vështrimin e saj.

— Ti e do atë? — më pyeti.

Ndjeva një si të rrëqethur në të gjithë trupin dhe, plot habi, i thashë:

— Në ç'kuptim?

Ajo ngriti supet.

— Në atë kuptim që duhen njerëzit...

Me sa duket, më dogji kjo pyetje, sepse ndjeva që u nxiva në fytyrë dhe i thashë:

— Unë të dua ty. Për Shpresën, nuk e di mirë ç'ndjenjë respekti e admirimi kam, por jo një dashuri si kjo që kam për ty... Se...

— Mos fol më...

Ajo u skuq, qeshi e kënaqur dhe më shpurishi flokët.

Kisha kohë pa vajtur te motra e madhe, por, po të mos kisha lexuar një artikull në Zërin e Popullit, nuk do të kisha shkuar as atë pasdite. Ishte fillim prilli a fund marsi, nja dy javë para se të niseshim për në Sarandë, dhe artikuj që kritikonin shfaqje të burokratizmit dhe burokratë botoheshin herë pas here në shtypin e përditshëm. Në shkrimin që lexova nuk kishte asgjë të jashtëzakonshme përveç emrit të një zëvendësministri që kritikohet me fjalët «arrogant e prepotent» e që unë e njihja si mik të kunatit tim. Këtë burrë tepër të mbajtur e shumë të kujdesshëm ndaj vetvetes, unë e kisha gjetur një herë në shtëpinë e motrës. Me mua nuk pati këmbyer as edhe një fjalë, por as ato që ai i kishte thënë me të tjerët,

unë s'i mbaja mend. Më kishte mbetur në kujtesë vetëm përshtypja që ai ishte shok me tim kunat. Ndaj edhe tani po shkoja te motra me një parandjenjë jo të mirë. Dhe parandjenja s'më kishte gënjyer.

E shtyva derën pa i rënë ziles dhe hyra në kuzhinë. Motra ishte ulur në divan pranë sobës dhe me një rënë dorë mbante bish-tin e xhezves. Nuk lëvizi kur hyra unë. Më tha vetëm «ulu» e më tregoi me kokë divanin tjetër përballë. Divani kërciti. U bezdisa nga kërcitja e tij, se motra dukej e mërzi-tur.

— Si je, Sadete? Ç'kemi këtej?

— Do kafe ti? — më pyeti ajo e me atë pyetje më dha edhe përgjigjen.

Dukej më shumë se e mërzi-tur, e lodhur. Kafshonte thonjtë me nervozizëm dhe duart i dridheshin. U shqetësova për të, por nuk dija ç't'i thosha e si ta pyesja. Ajo ishte dhjetë vjet më e madhe se unë dhe, kur nxehej, më shante me ç't'i vinte për gojë. Unë e kisha duruar gjithmonë, bile shpesh e nxisja që të nxehej më shumë dhe qeshja me të e largohesha duke e ngacmuar. Por, që kur isha fejuar, më vinte rëndë kur më shante, qoftë edhe me shaka. Ndërsa tani unë nuk e pyeta edhe për një arsye tjetër; e dija që do të fliste vetë, sepse po bëhej gati të thoshte diçka.

— Pije! — më tha duke më vënë filxhanin e kafesë përpara. Të sajini filloi ta rrufiste pa e lënë të ftohej asnjë çast. — Ke cigare?

Ajo e mori shkrepësen mbi tavolinë pa pritur përgjigje. E ndezi cigaren që i dhashë dhe e thithi dy-tri herë radhazi, pa e hequr nga buza.

— E shkarkuan Lavdimin, — tha.

Unë heshta. Prita të vazhdonte më tej, sepse atë që tha më dukej se e dija që më parë. Por ajo nuk foli menjëherë. Dukej sikur e kishte mendjen vetëm te kafeja që po pinte.

— Ashtu?! Po pastaj? — pëshpërita si për ta nxitur, sepse, në të vërtetë, nuk e kisha shumë të qartë se ç'donte të thoshte shkarkimi i tij nga ajo detyrë.

— Si pastaj?! — u nxeh Sadetja. — S'ka më «pastaj». Tani që e shkarkuan nga ajo punë, prit kur ta transferojnë në ndonjë qytet të humbur, në mos e hedhshin fare në fshat...

Nuk fola. Fillova të pija kafënë. Duhet të kem pasur një pamje shpërfillëse ndaj fjalëve të sime motre, që ajo më vështronte si të donte të më hidhej në grykë. E kuptova se nuk duhej të kisha heshtur. Duhej të kisha shprehur ndonjë habi të madhe, të isha shtangur si të kisha dëgjuar gjënë më të padëgjuar, ose të isha zemëruar me atë «poshtërsi» që i kishin bërë tim kunati, pastaj ta kisha ngushëlluar motrën me fjalë të mira dhe pastaj... E kështu me radhë. Mirëpo unë nuk mund të thosha asgjë nga këto, sepse nuk më kishte bërë ndonjë përshtypje të veçantë shkarkimi i burrit të motrës sime. Ndaj,

pija kafënë dhe e vështroja atë në një mënyrë aq të qetë sa asaj iu ngritën nervat.

— Ç'më sheh ashtu?! — më shfryu. — Nuk e dëgjon ç'po të them?

Unë lëviza kokën për t'i thënë se dëgjoja.

— E pastaj... — përsërita dhe e ndjeva se kjo do ta tërbonte fare atë, por s'dija vërtet ç'ti thosha tjetër.

Ajo u ngrit me vrull. Mori filxhanët dhe i shpuri në lavapjatë. Atje u thye njëri. M'u duk se e përplasi me qëllim. Ktheva kokën anej. Ajo po më vështronte me inat. U ul përballë meje dhe më tha:

— Dëgjo, Alfred! Ti je me gjithë mend i trashë. Rri si buf dhe s'di të thuash fjalët të tjera, vetëm «e pastaj, e pastaj»! Po s'ke faj ti! Se mos ke kokë për më shumë se ato hekurat e tu. Kurse për të tjerat as që të bie ndër mend. As që do t'ia dish për punët që i prish gjithë familjes shkarkimi i Lavdimit...

Po më mërziste me tërë ato fyerje dhe po bëhesha gati t'ia prishja keq, por fjalët e fundit sikur ma shuan inatin. Gati sa nuk qesha kur i thashë:

— E çfarë punësh i prishka gjithë familjes shkarkimi i Lavdimit?

Prita që ajo të fillonte prapë nga të sharrat, por jo. Dukej si e habitur nga ato që i thashë dhe po më shikonte si me keqardhje e dyshim.

— Ti nuk kupton vërtet, — tha, — apo

si? Se po më duket sikur të vjen mirë që e kanë shkarkuar Lavdimin...

— Flet kot, — i thashë prerë.

Sigurisht që s'më vinte mirë për shkakimin e kunatit. Por atë lloj alarmi, s'di pse s'mund ta duroja. Se mos kishte ndodhur ndonjë hata, se mos kishte vdekur njeri që ajo të ishte aq e hidhëruar?

— Ti nuk mund ta kuptosh, Fred, ç'do të thotë kjo, — vazhdoi ajo pak më e zbutur dhe si të bënte një përpjekje të kotë për të më mbushur mendjen. — Lavdimi ka qenë e vetmja mbështetje për ne. Atje mund të rregullonte edhe shkollën e fëmijëve. Mund të bënte shumë edhe për tët vëlla...

— Për Astritin? E përse?!

— Sepse ka gjithmonë një punë më të mirë se ajo që bëjmë, — filozofoi ajo dhe ndezi një cigare tjetër. Më erdhi për të qeshur me time motër, që i thoshte ato fjalë të huazuara kushedi nga ç'drekë a ç'darkë me njerëz të ditur. — Pastaj, — vazhdoi, — ai kishte kohë që mendonte për gjithë familjen. Bile, — këtë fjalë e theksoi, — edhe për ty. «Do ta heq nga ajo ndërmarrje, më pati thënë një ditë, dhe do ta çoj në një vend që s'e ka parë as në ëndërr...»

Ngrita sytë që i kisha ngulur mbi take-tuke dhe e vështrova gjatë. M'u kujtua Mësalli që mësonte frëngjisht. Sesi më erdhi. Si turp, si inat.

— Për mua s'kishte ç'të mendonte, — i thashë. — Unë s'di të bëj punë tjetër.



Edhe ajo më vështroi me vëmendje, si të donte të bindej që fatkeqësisht kishte përpara një vëlla tanimë pa dyshim të trashë e të pazotin për asgjë. Ajo u ngrit duke pshe-rëtitur dhe e mërzhitur më shumë prej meje. Dukej qartë që s'kishte më asnjë dëshirë të më shpjegonte më tej se ç'donte të thoshte për të gjithë ne të familjes shkarkimi i burrit të saj. Por këtë as unë nuk e doja. Fjalët e saj, ai shqetësim plot mëri e ai hidhërim i saj sikur çfarë të ishte përmbysur, më kishin goditur si një dritë e papritur dhe e fuqishme që t'i verbon sytë para se të mësohesh me të. Po shihja ca gjëra që as i kisha çuar ndonjëherë në mendje; po ndieja një fyerje të padurueshme; po më dukej vetja fare i vogël e i shpërfillur në mënyrë të turpshme. E ç'paskam qenë unë për këtë motër? — thirra përbrenda dhe ajo drita që më kishte verbuar në fillim, më solli një kthjelltësi e vetëdije tronditëse. Tani unë mund ta përcaktoja më mirë se kushdo tjetër marrëdhënien time me motrën e madhe. Dhe ja: unë kisha qenë për atë një vëlla punëtor, të cilin s'kishin dëshirë as t'ua njihnin atyre që u vinin në shtëpi. Ndaj, kur ndodhesha rastësisht tek ata dhe aty kishte ardhur ndonjë mik i rëndësishëm, kunati i thoshte vetëm «vëllai i vogël i gruas», pa më përmendur as emrin dhe as punën që bëja, kurse për Astritin tregonte edhe titujt që do të merrte në të ardhmen. Dhe vetëm po të pyeste vetë i ftuari se ç'punë bëja, atëherë motra ngutej

të thoshte kështu: «Është punëtor, po punëtor i mirë, se i ka duart flori...» Unë qeshja gjithmonë me këtë lloj sëkëlldie të motrës sime, sepse e quaja si dëshirë të saj për të më parë në një punë sa më të mirë. Kurse tani jo. Dhe po bëja çudi me kthjelltësinë time. Motrës i paska ardhur turp për mua, prandaj kërkonte patjetër një cilësi më shumë se ato të një punëtori të zakonshëm! Motrës i paska ardhur turp për pozitën time shoqërore, prandaj edhe i shoqi do të më gjente një punë që të mos e kisha parë as në ëndërr! Motra më donte në një rang tjetër shoqëror, kurse unë nuk isha veçse thjesht punëtor. E pra, a mund ta çoja më parë në mendje një gjë të tillë?! A mund të mendojë njeriu se puna që bën e ndaka nga gjaku i njëjtë? Dhe pastaj: ç'e paskan quajtur veten kjo motër e ky kunat?!

Tani sikur po më vinte vërtet mirë që e kishin shkarkuar Lavdimin. Ndoshta do të kujtoheshin një ditë që s'ishin aq larg vëllait të vogël «punëtor, po punëtor i mirë».

Kur isha i vogël, sa herë binte shi, unë dilja e rrija nën strehët e shtëpisë, në oborr, dhe prisja aty sa të më lageshin pak këmbët e pantallonave e të ndieja një lloj rrëqethjeje që më jepte kënaqësi në të gjithë trupin. Edhe atë mëngjes binte një shi i imët e i dendur. Duhej të merrja autobusin e unazës që më ndalonte te porta e ndërmarrjes, por zakonin për ta bërë rrugën gjithmonë në këmbë nuk e prisja as këtë ditë të lagur e të përhime. Ndoshta edhe nga ajo që thashë: që do të më lageshin pak këmbët e pantallonave e unë do të ndieja atë rrëqethjen e këndshme të fëmijërisë...

Isha si i përhumbur kur hyra në ndërmarrje dhe dëgjova Dyr Demën të më tho-

shte ta ndiqja pas në zyrën e tij. M'u duk çudi që rrinte te porta me çadër në dorë. Nuk më pëlqeu që më thirri në zyrë, sepse, me siguri, nuk më kërkonte për ndonjë gjë të mirë në pikë të mëngjesit e në mes të shiut. Një çast, thashë me vete mos kishte lidhje me kunatin që e kishin shkarkuar nga detyra, por në zyrë hyra pa asnjë hamendje. Atje prita që Dyrri të fliste dhe ai foli:

— Dje, Alfred, këtu ishte një shoku yt gazetar. Donte të bënte një reportazh të mirë për ndërmarrjen tonë... Ti i kishe thënë të vinte?

E theksoi fjalën «të mirë» dhe heshti disa çaste. Po më hetonte me një buzëqeshje që s'ia merrja vesh kuptimin. Nuk kisha ndonjë shok gazetar, ndaj heshta edhe unë, duke parandier diçka të keqe.

— Po ç'pate që u ngryste?!

U skuqa, se i ndjeva faqet të nxehta. Ky që po më vërtit nëpër ca fjalë të errëta, thashë me vete, e ka një qëllim të lig. Diçka do të kishte kurdisur me Mësallin apo Gentianin, sepse e dija mirë: nuk do të m'i harronte ca gjëra të vogla e sidomos atë punën e makinës së tij që ngarkohej natën me dërrasa e rimeso. Pastaj, nuk po ia duroja më as atë buzëqeshjen e ngrirë, që më dukej sikur e vinte me dorë në fytyrë qëllimisht për t'u tallur me mua.

— Unë, o drejtor, nuk kam asnjë shok gazetar dhe nuk i kam thënë askujt të vijë

të shkruajë për ndërmarrjen tonë, as për të mirë, as për të keq.

I fola kështu sepse nuk i besoja asaj hyrjes së tij të përzemërt, sikur ne të ishim moshatarë e miq të ngushtë. Por kjo atij nuk i bëri përshtypje, vetëm ngriti vetullat dhe tha i çuditur si të më merrte me të mirë:

— E ke një shok gazetar, Alfred, si jo! Më tha vetë ai. Kishte mbaruar shkollën me vëllanë tënd; dje deshi të të takonte edhe ty...

Kishte të drejtë. M'u kujtua menjëherë. Ishte Arian Tula, shok i tim vëllai, jo imi. Megjithatë... Tani sikur po më vinte pak turp dhe s'dija ç'të bëja. Me siguri do t'i kem qeshur shumë trashë, që ai u ngut të thoshte:

— Si, ore, harron miqtë dhe gjërat e mira që than për ndërmarrjen?! Po ti nuk je as në moshën time që të të zërë skleroza! Se unë nganjëherë harroj edhe emrin e gruas...

Qeshëm. Dyrri nxori nga sirtari disa shkresa dhe i vuri mbi xhamin e tryezës. Tani fytyra i kishte marrë një hije të rëndë, të menduar.

— Këtu, — tha, — në këto lista janë disa artikuj që ne nuk i kemi tregtuar, sepse i kanë quajtur gjoja skarco ose me cilësi të ulët. Mund t'i dish edhe ti këto gjëra. Jo? Mirë. Por unë ia thashë edhe atij mikut tënd që, para se të zgjidhet cili është shkaktari i këtyre stoqeve, ne nuk duam asnjë lavdërim për punën tonë. Dhe ia thashë se si e kupta zgjidhte këtë lëmsh që e ka bërë një... një

edepsëz atje në ministri. Por e lëmë. Për ty më vjen mirë që e ke sjellë gazetarin...

Ai vuri prapë në fytyrë buzëqeshjen e tij të parë dhe unë kuptova se mund të shkoja. Njëherë thashë të largohesha duke e lënë me mendimin se e kisha sjellë unë gazetarin, meqë ishte fjala për një «reportazh të mirë». Por, prapë, sesi më dukej të më dhuronin ndere që nuk i kisha bërë.

— Megjithatë, shoku drejtor, — i thashë, — atë nuk e kam sjellë unë në ndërmarrje.

— E mirë, — ma preu, — s'i ke folur ti, i ka folur yt vëlla. Njësoj është.

Nuk e zgjata më. S'kishte kuptim t'i thosha se im vëlla s'futej kurrë në gjëra të tilla. Ai nuk dinte as edhe çfarë pune bëja unë; dinte vetëm që isha mekanik dhe kaq i mjaftonte. Epo, në fund të fundit, kur drejtori yt është i bindur që ti ke bërë një punë të mirë, s'ka ndonjë të keqe të madhe që ai ta mbajë atë bindje. Kështu është, thashë me vete dhe dola nga zyra.

Në repart Mësalli po vdiste gazit. Diçka po i tregonte Yllit, se edhe ky po qeshte. Kur u afrova te tryeza ime e punës, dëgjova Yllin që tha:

— Do të ketë qenë gomar ai gazetari...

Më dogjën këto fjalë, por nuk e pyeta Yllin menjëherë. Shkova në garderobë dhe veshja rrobat e punës. Nuk më pritej sa të largohej Mësalli e ta pyesja Yllin përse e kishte quajtur ashtu Arian Tulën. Çfarë mund t'i kishte thënë Mësalli? Por, pas pak, Ylli erdhi vetë te tryeza ime. Më preku me bërryl në ije dhe më tha:

— Pehlivan i madh ky Dyrri! I ka shkuar në zyrë një gazetar për stoqet e ndërmarrjes dhe ai i ka bërë teatër. Pasi e ka dëgjuar me vëmendje gazetarin, që i paska thënë se në redaksi ka vajtur një letër e shkruar nga një punëtor, Dyrri qenka ngritur në këmbë dhe i ka bërë komedi. — Ylli qeshi. — Pehlivan i madh! — përsëriti. — Ka shkuar te rafti përballë, ka marrë nga ato lodrat speciale për fëmijë, që ne i bëmë vjet për ekspozitë, dhe i ka përplasur mbi tryezë, para syve të gazetarit. Hë, e ka pyetur, si të duken? Gazetari na qenka çuditur dhe paska thënë: Shumë të bukura! Atëherë Dyrri i ka marrë prapë lodrat, i ka vënë në raft dhe është kthyer nga gazetari. Dëgjo këtu, i ka thënë, atje në ministri, në katin e dytë, në derën e tretë është një kufomë që nuk i pëlqen këto prodhime, që nuk pëlqen asgjë të mirë, që dridhet nga çdo artikull i ri e që ka frikë edhe nga vetja. Atë shko e pyete për stoqet. Gazetari paska tundur kokën disa herë, i paska buzëqeshur me respekt, i paska shtrënguar dorën me përzemërsi dhe paska

ikur duke e falënderuar Dyrriin disa herë... Kështu më tha Mësalli. Pastaj, palo burrë është, më pyeti se kush mund ta kishte bërë atë letrën. Dyshonte për ty. Se ti, më tha, kishe bërë fjalë me atë Lilianën, magazinieren poshtë, dhe i paske thënë se e kishin mbushur magazinën me prodhime skarco... Ika, — tha Ylli, — se kam lënë një bazament në retifikë.

Dhe mirë e bëri, sepse as unë nuk kisha nevojë të dëgjoja më shumë. E kisha çdo gjë fare të qartë. Dyrri kishte luajtur komedi edhe me mua dhe unë kisha qeshur si idiot, isha treguar naiv, kisha pranuar gjëra që s'lidheshin me mua, kisha vërtetuar hamendjet e tyre dhe tani më duhej të bëhesha gati për marifetet që do të më bënte më pas. Se Dyrri, dihej nga të gjithë, ishte shumë i ndjeshëm ndaj këtyre gjërave dhe s't'i falte kurrë. Por për këtë as që po e çaja kokën. Plasje më vinte me vetveten. E njihja ç'burrë ishte ky Dyrri Dema dhe isha mashtruar prej fjalëve të tij; e dija që ai s'të thërriste kurrë në zyrë pa një paramendim të djallëzuar dhe nuk kisha ngulur këmbë deri në fund për ta bindur që ai gazetari s'kishte asnjë lidhje me mua. Dhe ja tani. Për Dyrriin unë isha autor letrash anonime. Isha përgjues i punëve të tij. Isha armik i tij.

Më vinte plasje. Më bëhej ta lija punën, t'i shkoja në zyrë e t'i thosha: «Dëgjo këtu ti, Dyrri Dema! Me mua nuk bën dot peh-



livanllëqe ti, sepse unë nuk merrem me letra anonime e as me lloqe nëpër tavolina kafenesh si ti. Me mua...» As vetë nuk dija se ç'mund t'i thosha tjetër. Dhe, si për çudinë e inatin tim, sa më shumë nxehesha, aq më pak gjeja për t'i thënë, derisa, kur u qetësova disi, m'u duk se nuk mund t'i thosha asgjë. Çdo shpjegim imi për Dyrrin do të ishte shfajësim, dhe çdo shfajësim atij do t'ia bënte më të fortë bindjen se isha unë autori i letrës.

Nuk do t'i thosha asgjë. Le të mendonte e të bënte si të donte. As që doja t'ia dija. Kisha shumë punë të tjera dhe këtyre gjërave s'ua kisha ngenë. Pastaj, nuk isha as edhe i zoti. Me siguri, duke dashur të ndreq, do të këpusja ndonjë të pamenduar dhe do ta prishja më keq. Më mirë kështu, thashë me vete. Secili ta dijë vetë punën e tij dhe le të mbajë po vetë përgjegjësi për atë që bën. Unë, për pjesën time, do të vazhdoja të axhustoja stampat e mia dhe s'do të më duheshin fare punët e Dyrrit. Ai le të bënte si të donte. Po të më binte në qafë, do të dija edhe unë t'i kthehesha. Kaq. Nuk kisha pse ta vrisja mendjen. Dhe ashtu bëra. Nisa të montoja stampat dhe i harrova të gjitha.

Në mbrëmje, duke parë një film në televizion, fillova të mendoja për Donikën, për shtëpinë që do të merrnim, për martesën dhe për atë jetë të qetë që bënte im vëlla me të shoqen dhe fëmijët. Gjithçka tek ata ishte rregulluar si në një marrëveshje të hollësish-

me, dhe mua kjo më pëlqente. Im vëlla, që fillonte punën në orën tetë, bënte gati djalin për shkollë dhe ndërronte vajzën që e shpinte në kopsht. Më parë merrte qumësh-tin për dy ditë, pastaj bënte gati fëmijët. Gruaja, që vinte më vonë, mbledhte rrobat e fëmijëve pa zhurmë, fshinte a rregullonte diçka dhe nuk flinte asnjëherë në drekë. Në mbrëmje ajo bënte përsëri ca punë që unë s'arrija kurrë t'i dalloja. Pastaj, kur vinte vajzën në gjumë, ulej në divan dhe shihte televizion. Kurse im vëlla shihte shumë rralle televizion. Ai ose lexonte, ose shkruante. Pas gjumit të drekës, pinte një kafe dhe shkruante deri në orën tetë, kur fillonin lajmet. Pas lajmeve lexonte libra në gjuhë të huaja... Më pëlqente jeta e tij e pasur dhe plot kuptim, megjithëse e dija që unë s'do ta bëja kurrë atë jetë. Sepse, unë as nuk shkruaja dhe as nuk lexoja si ai. Mua më pëlqente kjo jetë edhe sepse më kujtonte Donikën e më sillte ca përfytyrime të këndshme që, sidoqoftë, i ngjanin kësaj pamjeje me një grua që rri në divan e sheh televizion dhe me një burrë që, në një mënyrë a në një tjetër, bën një punë, ose sheh edhe ai televizion.

Mendova për pallatin që po ndërtonte ndër-marrja jonë dhe më erdhi mirë që pas disa kohësh do ta liroja pak vëllanë. Desha ta pyesja se si shkruante e lexonte kur televi-zioni këndonte e fëmijët luanin, por u kujtova që një herë më kishte thënë se nuk e shqetësonin zhurmat e zakonshme dhe nuk

foli. Vështrova gruan e vëllait, që i mbante gjithnjë sytë nga ekrani, pastaj vëllanë që vazhdonte të lexonte, pastaj i rrotullova nëpër të gjithë kuzhinën dhe sesi m'u duk që rrija edhe unë aty, si kot.

U ngrita dhe dola. Ora ishte nëntë. Mund të shkoja të rrija ca nga Donika. Ndoshta edhe mund të dilnim pak, sepse nuk binte më shi dhe nuk bënte ftohtë.

Kalova nga rruga që të shpinte më parë te pallati i Shpresës, pastaj tek ai i Donikës. Në cepin e një hyrjeje dy hije m'u dukën të njohura. Desha të ndërroja rrugë, por nuk munda, sepse do të më duhej të kthehesha prapa. Dhe kjo s'do të kishte fare kuptim.

Kur i dallova cilët ishin, në fillim u shtanga. Por shpejt kur ata më buzëqeshën si fajtorë, buzëqesha edhe unë.

— Po ju, — u thashë, — ç'bëni këtu në mes të natës?

— Siç e sheh, numërojmë yjet, — tha Ylli dhe qeshi.

Shpresa nuk foli. Uli pak kokën dhe mua m'u duk se u skuq. Ishte po ajo hyrje ku shumë kohë më parë ajo kishte vështruar lart dhe kishte thënë: «Çudi, këtu s'ka pasur kurrë llambë!» As tani nuk kishte dritë dhe, ndoshta, pikërisht kjo gjë i kishte bërë të guximshëm ata.

Vjen një ditë dhe njeriu nuk di as si të silllet. E ke pasur një mendim për dikë, ke vendosur edhe se çfarë qëndrimi do të mbash me të, kur vë re që papritur ca gjëra nisin e ndërrojnë.

Unë prisja që Dyrri Dema të hakmerrej ndaj meje, kurse ai filloi të bëhej përherë më i dashur, dhe me të gjithë. Edhe në punë tani vinte që në gjashtë e një çerek të mëngjesit. Rrinte te porta e ndërmarrjes derisa vinin të gjithë punëtorët dhe ata të vonuarit i veçonte. I qortonte, u thoshte se, po ta përsërisnin, do t'i kthente në shtëpi, por këtë e bënte pa të bërtitura, me një ton të qetë e bindës. Dhe të vonuarit bëheshin përditë e më të paktë, derisa nuk qe më nevoja që ai të rrinte te porta. Por Dyrri va-

zhdonte të rrinte. Pastaj kthehej në zyrë dhe për dy a tri orë merrej me letrat e shkresat e punës. Pas pushimit të orës dhjetë, e bëri zakon që të vizitonte çdo repart deri më dy-mbëdhjetë, kur mbyllej prapë në zyrë dhe dilte që andej më tre e gjysmë pasdite, bashkë me punëtorët.

Por nuk ishte vetëm sjellja e Dyrrit që binte në sy. Ishin edhe disa masa administrative që ai i mori shpejt dhe në mënyrë të prerë. Natali Hajredinin e shkarkoi zyrtarisht nga posti i shefes së planit dhe e la që ta kryente provizorisht atë detyrë, derisa të gjen-dej njeriu që do ta zëvendësonte. Nga byroja teknologjike hoqi shtatë gra dhe dy burra, të gjithë teknikë të mesëm, të cilët i solli në repartin tonë. Midis tyre edhe Marie Voglin. Ndërroi përgjegjësin e presave si dhe disa brigadierë në reparte të ndryshme. Shkurt, drejtori ndërroi, e bashkë me të, edhe shumë të tjerë.

Gentian Spahu, që mbyllej gjithë kohën në zyrë ose zhdukej për orë e ditë të tëra nga puna, tani rrinte shumë në repart dhe herë pas here kapte ndonjë stampë a diçka rregullonte. Nuk mbante më poza kur fliste. Dhe kjo qe gjëja më e çuditshme, se sikur zbulonte një natyrë tjetër të tij, të thjeshtë e të shtruar. I dëgjonte punëtorët kur i anko-heshin për ndonjë material a vegël pune që mungonte, dhe një ditë solli edhe disa lime e punto të reja, të cilat ua ndau atyre që kishin më shumë nevojë. Kishte filluar të

bëhej vërtet më kërkues ndaj punës, aq sa edhe brigadës eksperimentale i caktoi norma të përafërta me ato të brigadës sonë.

Edhe Mësall Sula, megjithëse prapë lëvizte sa andej-këndej dhe vazhdonte t'i mban-te letrat e frëngjishtes mbi tryezën e punës, filetatriçen e kishte larguar në një cep të tavolinës dhe tani bënte stampa si gjithë të tjerët. Për Dyrin fliste më rrallë dhe, siç i kishte thënë Yllit, të shtunave nuk shkonnin më në «Drini», sepse Dyrri nuk donte. Megjithatë (dhe këtë e tha me zë të lartë, si për ta dëgjuar qëllimisht të gjithë), ai tregoi se si e kishin kaluar një mbrëmje në shtëpinë e Dyrrit, ku kishte qenë edhe ministri ynë. Pata përshtypjen që gënjente dhe e bënte këtë vetëm për të na kujtuar se sa të forta i kishte pozitat Dyrri Dema. Por për mua nuk kishte rëndësi kjo gjë. Mua më bënte më tepër të mendoja ajo mënyra e Dyrrit për t'u shoqëruar me njerëz kaq të ndryshëm. Ai rrinte me një kovaç që nuk dinte të fliste as shqip; rrinte me një banakier miniere që tregonte për fërgesën me plëndësa si për ndonjë shpikje të çuditshme; rrinte me një drejtor ministrie, siç ishte im kunat, apo edhe me një ministër, siç thoshte Mësalli. Ç'ishte atëherë Dyrri Dema? Shumëkush, sidomos jashtë ndërmarrjes sonë, atë mund ta mendonte si model të njeriut të thjeshtë e të zgjuar që di t'i bashkojë brenda tij caqet e një demokracie. Dikujt mund t'i dukej edhe si një i ngratë që nuk i përket

askujt dhe pikërisht për këtë kërkon të ketë nga pak në çdo anë. Kurse unë e kisha të qartë se kush ishte Dyrri Dema, ndaj po më habiste ai ndryshim i menjëhershëm për të cilin dëshiroja të isha sa më i vëmendshëm.

Kishte disa ditë që edhe Musa Zhuri, sekretari i partisë në ndërmarrje, marangoz nga profesioni dhe përgjegjës i repartit të zdrukthëtarisë, kishte vënë në fytyrë një buzëqeshje që sikur të thoshte të të vinte pak keq për këtë burrë të urtë, por të pazotin. Flitej se nuk do ta zgjidhnin më sekretar dhe se mund ta shkarkonin edhe si përgjegjës. Mbase ishin këto fjalë që të bënin ta merrje atë lloj buzëqeshjeje si një lutje për keqardhje.

Kryeinxhinieri dukej krejt ndryshe, si një njeri i ushqyer dhe i përtërirë nga s'dihet ç'forcë. Ai gjithmonë kishte qenë njeri i gjallë, veçse tani sesi lëvizte, plot vrull e anë më anë ndërmarrjes, duke mbajtur diçka në dorë, një kalibër a një projekt, për të cilin fliste pa pushim.

Ndërsa Shpresa Bilali kishte mbetur ajo që kishte qenë, ndoshta sepse kishte një mendim krejt të saj in për këtë ndryshim, të cilin, në njëfarë mënyre, na e pati shprehur edhe neve atë ditë në shtëpinë e saj. Mbledhja e organizatës-bazë të Partisë, edhe pse ishte zhvilluar me një frymë jo aq të fortë autokritike, kishte bërë efektin e një paralajmërimi të Dyrri Dema dhe ata që i shko-

nin pas. Por, pikërisht, kjo arsye e bënte Shpresa Bilalin që të mos i besonte plotësisht këtij ndryshimi. Megjithatë, ajo vazhdonte të ishte po aq aktive në punët e saj si frezatore dhe në ato të Partisë apo shoqërore. Bile, po të merrej parasysh edhe koha që tani i merrte Ylli Berati, si i sapofejuari i saj, sigurisht që ajo ishte më e gjallëruara në ruajtjen e këtij ekuilibri të ri të ndërmarrjes sonë.

Por mua nuk po më pëlqente ky ndryshim i papritur. Nuk më pëlqente sepse nuk besoja fare që do të vazhdonte gjatë. «Kush është mësuar nuk rri pushuar», thotë populli dhe kjo më ishte ngulitur në mendje në një mënyrë aq të çuditshme, sa më dukej se më shoqëronte edhe në ritmin e hapave, edhe në ritmin e limës mbi hekur. Unë e kuptoja kështu këtë ndryshim të Dyr Demës: një kohë e ndërmjetme në pritje të mbledhjes së kolektivit për të lënë ca mbresa të freskëta në mos si drejtues shembullor, së paku si njeri që ka ndryshuar dhe që premtonte se në të ardhmen mund të bëjë gjëra të mira. Dhe kjo do të ishte shumë. Po a do të duronte dot Dyr Dema të mbetesh i tillë deri në ditën e mbledhjes? Dikush mund të thoshte



po, se fundja punë ditësh ishte, e shumta dy javë. Kurse unë as këtë nuk e besoja. Dhe kisha pasur të drejtë.

Është turp dhe gjë e ligë që njeriu të gëzohet për të keqen. Por unë u gëzoja kur pashë që Dyrr Dema, jo më vonë se pas dhjetë ditësh, filloi të mos rrinte më te porta dhe të mos vinte më nëpër reparte. Kur Gentiani nisi të merrte prapë frymë thellë para se të fliste dhe kur Mësalli i tha Yllit që të shtunën e kaluar, «pas kaq kohësh», kishin qenë prapë me Dyrrin te «Drini», atëherë Shpresa më tha:

— Alfred, nuk mund të ndryshojnë gjithë ato gjëra kaq shpejt. Veçse çuditëm përse Dyrrin nuk priti ditën e mbledhjes së kolektivit, të paktën sa për t'u treguar të tjerëve që ka filluar të ndryshojë?!

— I është dukur me siguri një taktikë e trashë dhe tepër e vonuar, — i thashë unë. — Ose ka marrë vesh se mund të mos bëhet fare mbledhje.

— Ndoshta, — tha Shpresa dhe ndezi frezën.

Unë e pyeta nëse do të vinte në ekskursionin e Sarandës dhe ajo më tha se do të rrinte në ndërmarrje, ngaqë mund ta kërkonin.

Ne do të niseshim pas katër ditësh.

Ne vërtet do të shkonim pas katër ditësh në Sarandë, por një ditë para se të niseshim ndodhi diçka që mua ma ngatërroi edhe një herë mendimin për Dyrë Demën.

Gani Beshiri (ne ishim mësuar ta thërrisnim Gani tornitori, jo sepse kishte ndonjë Gani tjetër axhustator apo frezator, por sepse kishte ardhur që kalama në ndërmarrje e se ashtu i kishte thënë dikush e ashtu i kishte mbetur) na ngrihet një mëngjes e na vë mu te dritarja e drejtorit një fletërrufe që bëhet gazi i të gjithëve. Ky Ganiu që prej disa vjetësh kërkonte kategorinë e pestë, por nuk ia kishin dhënë. Megjithëse komisionet e kualifikimit të punëtorëve nuk mblidheshin rregullisht, disa punëtorë vazhdonin të kategorizoheshin herë pas here. Këtu kapej edhe Gani Beshiri në fletërrufenë e tij. Midis shumë radhëve të bëra me një shkrim komik që i shkonte mjaft mirë përmbajtjes, ai thoshte se, përderisa i kishin dhënë kategorinë e katërt Belul Cimit, djalit të kasapit që «nuk di të lidhë as brekët e veta», përderisa edhe kovaçi që «është më analfabeti në botë» kishte marrë kategori të shtatë, përse të mos ia jepnin edhe atij të pestën, bile të gjash-tën fare? Në fund të fletërrufesë ai kishte shkruar se nuk do të lëvizte nga vendi ku kishte varur fletërrufenë pa ia shënuar kategorinë e pestë aty në dorë dhe në librezën e punës.

Sigurisht, nga kushdo mund të merret me mend qëndrimi ndaj një punëtori që e tepron në kërkimin e të drejtave të tij. Por Dyrri, megjithëse këtë mund ta dinte shumë mirë, as nuk dha urdhër që ta hiqnin fletërrufenë dhe as nuk thirri njeri që ta merrte Ganiun e t'i thoshte ta mblidhte pak mendjen. Ai vetëm sa i hodhi një sy fletërrufesë dhe u mbyll në zyrë. Aty thirri edhe dy-tre anëtarë të komisionit të kategorizimit, të cilëve u mori nga një firmë dhe ngriti telefonin e u tha atyre të llogarisë që Gani Beshiri, nga data një e atij muaji, të paguhej me kategorinë e pestë.

Mua më habiti kjo sjellje e tij, dhe jo vetëm mua. Ata që e njihnin, thoshin se Dyrri e dinte mirë ç'bënte. Të tjerët mendonin se e kishte trembur vrulli i Ganiut. Kurse Ylli Berati tha se duhej t'i kishte ardhur turp nga përmbajtja e fletërrufesë dhe se duhej të kishte pasur frikë mos Ganiu e vinte edhe në qendër të qytetit. Mua më dukej se këto ishin të vërteta, por secila nga pak. Mbi të gjitha, Dyrri nuk i pëlqente zhurma për shkak të namit të mirë që kishte te njerëzit që s'punonin te ne. Kurse brenda ndërmarrjes, atë e përmbante diçka tjetër: grindjet që kishte pasur me ne punëtorët dhe me disa drejtues të ndërmarrjes, si, për shembull, me kryeinxhinierin. Po të mblidheshin këto grindje, nuk do të ishin pak për ta cilësuar të paaftë si drejtues. Megjithatë,

Mësall Sula kishte krejt tjetër mendim. Ai tha vetëm kaq: «Mos flisni budallallëqe, nuk trembet Dyrri nga një copë letër e një tornitori! Po a ia vlen të merret me njëfarë Gani Beshiri?»

Dhe me sa duket Mësalli kishte të drejtë. Nga unë Dyrri Dema jo vetëm nuk u tremb, por u bë më i egër dhe më trim se kurrë ndonjëherë.

Prej shumë kohësh, qysh kur kisim marrë shtëpi të re, tim vëlla e mbaja mend në të njëjtin vend, te tavolina e vogël në qoshe të aneksit, duke bërë të njëjtën punë. Hapte libra të trashë, shënonte diçka nëpër skedat që i mbante në një sirtar të bufesë, të cilin e nxirrte dhe e vinte aty pranë mbi tavolinë. Kështu çdo pasdite, deri në mbrëmje vonë. Që prej një viti a më shumë, ai ishte bërë gati mospërfillës ndaj bisedave tona ose programeve të televizionit, sepse përgatiste disertacionin. Ngrinte sytë një çast mbi ekranin, thoshte ndonjë fjalë dhe përkulej përsëri mbi fletët e bardha, që mbusheshin pa mbarim me shkrimin e tij tepër të qartë dhe të bukur, si shkrimi i një vajze të kujdes-

shme. Ashtu ishte dhe atë mbrëmje, i zhytur në letrat e tij, kur i thashë se më kishin pushuar nga puna. Ngriti kryet, më pa një çast, si të mos kishte kuptuar ç'i kisha thënë, dhe pyeti:

— Të pushuan nga puna? E përse?

Ai vazhdoi të shkruante dhe unë nuk folë. Pastaj i mblodhi letrat e librat, i vuri nëpër vendet e tyre dhe u ul prapë pas tavolinës së vogël në qoshe të aneksit.

E kisha vështruar gjatë gjithë kohës duke thënë me vete: Si janë këta që shkruajnë, si të humbur. Kisha përshtypjen se jo vetëm këtë që i thashë unë, por çdo lajm tjetër, sado të rëndësishëm, kështu do ta priste ky, ky dhe shokët e tij, të gjithë ata që merreshin me letra. Do të ngrinin një çast sytë, si pa kuptuar asgjë, dhe prapë do të zhyteshin për disa kohë në punët e tyre, si të trembeshin mos u ikte mendimi. Dhe vetëm kur të kishin përfunduar të kënaqur atë që kishin në mendje e në dorë, vetëm atëherë do t'i ngrinin përsëri sytë dhe, si të kujtoheshin për diçka të largët, do të pyesnin si ky Astriti im.

— Pa hë?

Unë heshta edhe pak, ngrita kokën, buzëqesha kot, pastaj nisa t'i tregoja. Në kuzhinë hyri Ketë, gruaja e tim vëllai, dhe mua m'u desh t'ia filloja nga e para, që ta dëgjonte edhe ajo historinë e ekskursionit. Kur mbarova, Ketë tha:

— Ua, Astrit, si u pushuakan kështu punëtorët?! Sa grinden rrugëve... Ç'hyn kolektivi këtu? Ç'hyn ndërmarrja?

Ajo i drejtohej të shoqit, sikur unë të mos isha i zoti t'i kuptoja ato që thoshte, ose sikur im vëlla të ishte përgjegjës për vendimin që kishte marrë Dyr Dema.

— Nuk do ta kenë pushuar vetëm për këtë, — iu përgjigj ai së shoqes. — Arsyet do të jenë më të thella. — Ai m'u drejtua mua: — Ti do t'u kesh prekur interesat, dhe prekja e interesave të një shefi të vogël në shpirt, në përgjithësi merret nga ai si një luftë klase që i shpall atij punëtori. Ka një luftë klase midis jush apo jo?

— Në ç'kuptim? — e pyeta.

— A u ke prekur qoftë edhe fare pak interesat shefave të tu, në kuptimin shoqëror dhe moral? Le pastaj ta kesh bërë këtë edhe në kuptimin shtetëror... ë?

— Po, — i thashë.

— Ha-ha! E shikon? — ai iu kthye prapë së shoqes, i kënaqur që e kishte gjetur arsyen e vërtetë, pa ditur asgjë më parë. — Se ka disa gjëra... — Ai tani na drejtohej të dyve ose asnjërit, siç e kishte zakon. — Ka disa gjëra, — përsëriti, — që kanë vlerë të përgjithshme, që hyjnë kudo si një kod. Ti, për shembull, je gruaja ime. Derisa unë, burri yt, nuk kam bërë asgjë që të të cenojë ty sadopak, ekonomikisht, politikisht, moralisht ose thjesht praktikisht, unë jam shumë i mirë për ty. Unë nuk kam asnjë të metë

për ty. Shkurt, unë jam për ty ideal. Ky, pra, është kodi i marrëveshjes sate me mua. Mirëpo, qysh kur unë filloj e të cenoj pak, kodi priset. Po ta rrah unë djalin, bie fjala, sepse ai të mori ty dhjetë lekë dhe iku e i prishi pa të pyetur, ty të vjen mirë dhe të pëlqen ajo që bëj unë. Sikur unë ta rrah djalin sepse mori nga xhepi im dhjetë lekë, që ti nuk i dije se unë i kisha, dhe t'i dha ty, kjo nuk të pëlqen dhe thua se bëra gabim që e rraha...

— Ohu, dhe ti!...

— Dëgjo dhe diçka tjetër. Ky, — ai më tregoi mua, — mund të thotë se unë nuk e njoh drejtorin e tij. Dhe vërtet nuk e njoh, sepse vetëm një herë kam pirë kafe me të, fare rastësisht dhe as pesë minuta s'kemi ndenjur. Por edhe kaq kohë mjaftoi për të krijuar një përshtypje të përgjithshme për të. Dhe jo vetëm nga ato pesë fjalët që shkëmbyem, por më shumë nga pamja e jashtme. Ja, ta pyes unë këtë, — ai më tregoi prapë mua, — si është drejtori yt? T'i them: ma përshkruaj me pak fjalë dhe më thuaj ç'dallon ti në pamjen e tij, ky nuk di.

Unë ngrita supet dhe buzëqesha.

— E shikon? — vazhdoi im vëlla. — Ky ngre supet sepse nuk e ka parë me vëmendje drejtorin e tij. Kurse unë, për pesë minuta që ndenja me të, mund të them se ishte një njeri me buzëqeshje aziatike, me ca këmbë arabe dhe me duar si të një plake të aristokracisë evropiane.



Qesha me të madhe, se vërtet s'kisha vënë re gjëra të tilla, ndërsa tani që Astriti e përshkruante ashtu, thashë me vete se ai kishte vërtet diçka nga kjo përzierje. Duart e tij ishin tepër të lëmuara, me një cipë të hollë e të rrudhur. Hapat i bënte të vegjël e me gjunjë pak të përthyer. Por buzëqeshja nuk më dukej aziatike, ose unë nuk isha i zoti ta dalloja një buzëqeshje të tillë. Megjithatë, nuk isha krejt në një mendje me tim vëlla, sepse unë nisesha nga të tjera gjëra për të njohur dikë; nisesha nga ajo që ai bënte, që mendonte e që shprehte në rrethana të ndryshme, me njerëz të ndryshëm...

— Po ku e ke takuar Dyrin? — e pyeta me njëfarë kureshtjeje.

— Nejse, — tha ai, — me një shokun tim gazetar. Donte t'ia hidhte për ca artikuj skarco që keni prodhuar. Edhe ai shoku u hoq sikur e hëngri. Nuk shkroi artikull, se ashtu qe puna, por relacionin e bëri.

U kënaqa. Astritit nuk i thashë gjë për provokimin e Dyr Demës, por u kënaqa që e mora vesh mirë këtë lojë me gazetarin. Kjo s'do të mbetej pa zë, edhe pse zërin do t'ia dëgjoja tani që unë nuk isha më në atë ndërmarrje.

— Kështu, pra, — vazhdoi im vëlla. — Ti i ke ngacmuar ata dhe ata të kanë gjetur rastin. Për këtë unë s'kam ç'të bëj, sepse ti e di vetë si i ke ngatërruar punët e tua dhe po vetë duhet t'i zgjidhësh. Unë, si vëlla, mund të të ndihmoj vetëm me këto që kam

mundësi: sa kohë të jesh pa punë, këtu nuk ka nevojë të sjellësh asnjë lek, dhe të mos shqetësohesh fare për këtë.

Kaq. Dhe më shumë se kaq unë nuk prisja nga ai. Sepse e dija që, çfarëdo t'i thosha, do të më përgjigjej: bëj vetë ç'të duash. Tani je i fejuar, je zot i vetes, ndaj dili përballë jetës. Kështu do të më thoshte. Jo se do t'ua përtonte këshillave apo detyrave të tij si vëlla i madh, por sepse donte që unë të përplasesha vetë në jetë dhe, duke u përplasur, ta njihja më mirë. atë.

Ashtu do të bëja.

Qe hera e parë që ngrihesha i fundit nga krevati. Zakonisht çohesha shumë shpejt, qysh në orën pesë të mëngjesit. Në pesë e gjysmë dilja nga shtëpia, sepse puna më fillonte në orën gjashtë e gjysmë. Ecja si i ngeshëm në rrugë. Pija kafe te «Peza» dhe ndonjëherë haja edhe paçe tek «Arbëria». Isha mësuar me këtë rregull që s'më kërkonte as kokëçarjen më të vogël. Çdo gjë ishte vendosur një herë e mirë dhe mua s'më mbetej tjetër veçse të ndiqja me përpikëri ato veprime që quhen gjërat e rëndomta e të përditshme të njeriut.

Por ja që tani kishte ardhur një ditë që ndryshonte nga të tjerat, një ditë që e prishte rregullin dhe unë s'dija ç'të bëja. Rrija

i ulur në krevat me bërrylat të mbështetur mbi gjunjë dhe me sytë të humbur në zbrazëtirën e dhomës. Gjithë sa kisha menduar të djeshmen, e sotmja ma bënte pa kuptim dhe si të pamundur për t'u realizuar. Ishte si të filloje një jetë të re, me të tjerë njerëz dhe me të tjera telashe; një jetë që do të më kërkonte shumë më tepër përpjekje se ajo që kisha jetuar deri tani. Ishte një gjë e vështirë për t'u filluar. Dhe unë e ndieja veten të pafuqishëm për të nisur rrugë të vështira. Edhe të ngrihesha nga krevati, të vishesha, të bëja një kafe në furnelën elektrike e pastaj të dilja ashtu, kot, rrugëve të Tiranës, më dukej si pa kuptim. Megjithatë, u ngrita, u veshja, e bëra edhe kafënë, e piva në këmbë dhe dola.

Për atë që ka lindur e është rritur në një qytet të madh, natyra mund të jetë më pak e pushtetshme. Ai është më i mbrojtur nga trillet e motit, por edhe më larg mrekullive të tij. Se lind dielli i pastër mbi male apo i mbuluar nga retë, pak rëndësi ka për atë. Se në rrugë mund të nuhasë vetëm aromën e ca mimozave, të përzier me erën e karburantit të padjegur mirë të makinave, as që kujtohet për mijëra aromat e vendeve ku kositet bari i njomë e ku mbli-dhen lulet e pranverës. Një njeri i lindur e i rritur në një qytet të madh mund t'i humbasë ca lidhje intime me natyrën. Dhe kur rastësisht në ditë i fiton prapë këto lidhje, atëherë ai ndodhet si përpara një zbulimi, si

përpara një ngazëllimi mahnitës që e bën të mos njohë as veten.

Kështu m'u duk edhe mua ajo ditë e parë e pushimit tim nga puna.

Dielli ndriste në mënyrë të çuditshme. Sikur ishte ose nuk ishte diell. Fshihej pas disa reve aq të rralla sa që mund të dukej habi që fshihej pas këtyre reve. Dilte prej tyre dhe sikur bënte humor: të ngrohte dhe nuk të ngrohte. Fshihej prapë dhe prapë dilte. Derisa, në një çast, nuk e di se kur, por mbaj mend që ndodhesha te kafe «Partizani», ai u shfaq i plotë dhe nuk u fsheh më. Ndenja disa çaste duke e vështruar nga lulishtja aty pranë. Thonë se, po ta vështrosh diellin, të vriten sytë. Mua jo, nuk m'u vranë. Ndoshta ngaqë s'e kisha mendjen tek efekti i tij mbi sytë e mi, por tek ajo dehje aq e përgjithshme, aq e plotë. Gjithë ajo plogështi, që më bënte të mos ngrihesha as nga shtrati e të dilja në ditën e bardhë, m'u kthye në çast në një vrull të madh të të gjithë trupit e shpirtit. Nuk di si ta shpjegoj sa më qartë, por unë mendoj kështu: Rrojmë çdo ditë dhe themi se rrojmë mirë. Shkojmë në punë. Bëjmë detyrat që na takojnë. Realizojmë planin. Tejkalojmë normat. Propozojmë ngritjen e tyre. Na lavdërojnë nëpër mbledhje. Duam edhe një vajzë që na vështron me dashamirësi. Fejohemi. Martohemi. Lindim fëmijë. Bëhemi edhe përgjegjës... Dhe jemi të bindur se çdo gjë e kemi bërë në rregull. Por jo. Ja që ndodh të ke-

mi harruar diellin. Dhe dielli të bën një ditë të qeshësh ose të qash. Këtë ditë, nuk e di përse, dielli më bënte të qaja. Po me një mënyrë aq të pakuptueshme, sa isha i sigurt që edhe im vëlla nuk do të ma shpjegonte dot përse.

U mundova ta kuptoja vetë. Hyra te kafene «Partizani» dhe porosita një kafe. Ma sollën aq shpejt sa nuk do ta dëshiroja. E largova filxhanin në një cep të tryezës dhe mendova: «Nuk kam qarë kur më vdiq babai. Nuk kam qarë kur më vdiq gjyshja. Nuk kam qarë kur më vdiq nëna. A nuk do të qaj edhe unë një ditë?» Megjithatë, ende nuk më dilnin lotët. Atëherë dola jashtë dhe mora rrugën drejt Sahatit. Nuk e dija ku shkoja. Vështroja mimozat apo shkurret uniforme të gardheve të lulishteve dhe prekesha. Kam përshtypjen se duhet të kem ndaluar shumë dhe shpeshherë pranë këtyre shkurreve, derisa një qytetar, ndoshta bahçevan, më tha: «Hë, ç'i shikon ashtu? Nuk të duken të prera siç duhet?» «Si jo, — i thashë, — pse më duken të prera bukur, po i vështroj kaq gjatë.» Ai më rrahu supin dhe u largua duke më buzëqeshur. «Përgjegjës, me siguri, — thashë me vete, se m'u kujtua buzëqeshja e Gentian Spahut. — Një përgjegjës që i pandeh gjërat të tijat», — thashë. Dhe e mora inat. Mora inat edhe veten time, sepse më kaloi ai lloj ngashërimit që ndieja dhe u bëra ai që kisha qenë prej njëzet e pesë vjetësh... Por a kisha qenë vallë

qysh prej njëzet e pesë vjetësh i tillë? Kujtimet m'u bënë në çast njëqind herë më të çuditshme se ajo gjendje shpirtërore që kisha provuar. M'u kujtuan histori të pafundme të të gjithë jetës sime. Dhe me këto histori nuk e di sa kohë brodha, derisa ato mbaruan dhe unë erdha në ditën e në kohën ku isha: në ditën e parë të pushimit tim nga puna.

Duke kaluar nga sheshi «Avni Rustemi», pashë një kumbull që kishte çelur me të gjitha lulet e bardha. Ndalova. U gëzova. Por pas një çasti, vetja m'u duk si i vyshkur. Eca më tej dhe fillova të kuptoja se çdo gjë, edhe ato më të zakonshmet e më të papërfillshmet, më bënë një përshtypje të padurueshme. Shihja dikë të veshur me një bluzë e xhakëtë në ngjyrë të ndezur dhe vetja më dukej i paveshur, aq sa ndieja edhe ftohtë. Në një kthesë, një grua e re u përkul dhe puthi një fëmijë. E mori në krahë, i lëmoi flokët dhe i tha se babi nesër do të vinte në shtëpi, se babi ishte me shërbim dhe ai vinte gjithmonë nesër. Gruaja u kthye nga unë që kisha qëndruar fare pranë saj dhe, kur më pa me sy si të njomështuar, më buzëqeshi. Por më buzëqeshi me njëllonj trishtimi a bezdie, që mua më fyeu.

Nuk po e kuptoja jo vetëm se ç'po ndodhte me mua, por edhe sa do të zgjaste kjo gjendje. E ndieja veten krejt të dobët, por në një dobësi të bukur, të ngjashme me atë rrëqethjen e mrekullueshme që më sillnin pikat e shiut nën një strehë. Dëshiroja të rrija ashtu, vetëm. Ndjenja e një braktisjeje përçmuese, që e kisha provuar kur kalova prapë në ndërmarrjes, tani më ishte kthyer në një ndjenjë tjetër, në atë të vetmisë së plotë. Por ajo që më habiste më tepër dhe më gëzonte njëkohësisht, ishte se, krahas dëshirës për të ndenjur vetëm, tani po e ndieja më shumë nevojën për të pasur pranë një shok, një mik, një të dashur. Dhe m'u kujtuan të gjithë, por në mënyrë të veçantë Donika që tani punonte atje ku kisha punuar unë...

Ky mendim më solli menjëherë në vete. Vështrova orën dhe vendosa të nisesha për në Ndihmën Juridike. Por, çuditërisht, ora e kishte kaluar kohën e punës zyrtare dhe unë u ktheva për në shtëpi.

Nesër, thashë me vete, nesër fillon një ditë tjetër për mua.



Nuk kisha veçse dy ditë pa e parë Donikën, por më dukeshin si dy muaj. Ishim mësuar të shiheshim që në mëngjes kur shkonim në punë, të dilnim bashkë që andej dhe të takoheshim përsëri në mbrëmje, te shtëpia e saj ose tek e motra. Edhe tani atje duhej të ishte. Shkonte shpesh, por mua kishte filluar të mos më pëlqente kjo gjë. Jo se Liliana nuk ishte njeri i mirë. Përkundrazi. Po ta gjykoje nga devotshmëria për punët e gruas, ajo mund të quhej e rrallë. Kishte një dëshirë gati mani për rregullin e pastërtinë në shtëpi, bënte byrekë të mrekullueshëm, me gjithfarë erëzash e përzierjesh, gatuante si pak gra të moshës së saj të re dhe ishte e ndershme. Por mua nuk më pëlqente

që Donika shkonte aq shpesh atje, sepse Liliana fliste shumë dhe nuk thoshte asgjë, ose thoshte ca gjëra që mua më ngrinin nervat duke i dëgjuar shpesh. Si merceologe e mesme, ajo kontrollonte ca kuzhina dhe dyqane ku kishte zënë dy a tri shoqe që «mendonin për atë», siç shprehej vetë. I ruanin ndonjë shishe vaj ulliri të mirë, i gjenin një pako mish qengji të zgjedhur, i jepnin mëlçi të freskëta e këso punësh. Ishte aq e kënaqur nga vetvetja, sa kishte krijuar bindjen se «sot ecet vetëm me mik, o vëlla!». Në fillim unë ia kisha marrë me shaka këto fjalë, sepse ashtu ia kuptonte edhe i shoqi, Lirimi. Ky qe burrë i mirë dhe, sa herë që gruaja e tij thoshte nga këto «mençuri», ai qeshte, si për të nënkuptuar që e kishte pak budallaqe nusen. Megjithatë, mua nuk më pëlqente as qëndrimi i tij ndaj së shoqes. Por, kushedi, kur në shtëpi mund të të vijnë ca gjëra që të tjerët i gjejnë më me vështirësi, mbase edhe parimeve u lehtësohet ca peshë...

Një ditë Donika më foli për një palë sandale që i kishte blerë te një shoqe e Lilianës, por jo tamam e saj; atë që shiste sandalet Liliana e njihte nëpërmjet një tjetre. Deri këtu nuk më habiti ndonjë gjë e veçantë, por kur Donika më tha se, meqë nuk i pëlqenin ato sandale, unë duhej t'i thosha një shokut tim, i cili ishte vëllai i shitëses, që t'i ndërironte me një palë të tjera ose t'i kthente lekët, ia preva shkurt se s'do të merresha kurrë me këto gjëra. Por një ditë tjetër dë-

gjova që Liliana kishte bërë si kishte bërë dhe i kishte ndërruar sandalet. Qesha kur m'u mburr për këtë. Veçse më pas nuk më erdhi mirë që e fejuara ime ngatërrohej në marifete të tilla. Unë nuk i kuptoja këto dëshira të ca njerëzve për të pasur patjetër diçka veç të tjerëve. Për këta njerëz unë mendoja kështu: duke mos pasur asgjë të veçantë, asnjë qëllim, asnjë synim, as edhe një natyrë e një jetë pak të ndryshme nga të tjerët, kërkojnë me çdo kusht të kenë fustanet apo sandalet të ndryshme. Ose, ku ta di unë, mund të ishte krejt e kundërta (domethënë këta të ishin të veçantë e të rrallë si tipa, ndaj edhe veshjen e donin po të veçantë e të rrallë). Por këtë unë e them sa për mirësjellje, sepse mua më mjaftonin vetëm dy shembuj për t'i mbushur mendjen vetes. Dhe ja: Astriti, im vëlla, nuk ishte një njeri çfarëdo, por rrobat i kishte nga më të zakonshmet, të tregtuara në çdo dyqan konfeksionesh. Kurse Donika, që ishte një vajzë krejt e thjeshtë dhe e zakonshme (dhe unë për këtë e kisha pëlqyer më shumë), kërkonte gjëra të rralla e, mundësisht, të ardhura nga importi! E përse? Me siguri, mendoja unë, për t'u treguar të tjerëve pikërisht atë që s'e kishte: të veçantën që të habit. Pastaj, unë kisha edhe një mendim tjetër që im vëlla ma kishte quajtur origjinal. Unë thosha kështu: Duke rendur pas veshjeve të rralla, ne ua mbulonim të metat dhe paaftësitë atyre që merreshin me prodhimin e vesh-

mbathjeve. Sepse, në rast se fustanet, pantallonat apo këpucët bëheshin njësoj dhe ne, të veshur me këto rroba, do të dukeshim si të futur nëpër uniforma, shpejt ata do të detyroheshin t'i vinin gishtin kokës dhe ne s'do të kishim më nevojë të porosisnim sandale te miku i mikeshës së mikut të Lilianës, domethënë të merreshim me «kotësi liliputësh», siç shprehej Astriti.

Si ishte ky vëllai im! Kishte një profesion që unë s'e kuptoja mirë; merrej me një degë të linguistikës. Studionte, shkruante, thoshte gjëra që mua më pëlqenin e më bënin ta doja përherë e më shumë, megjithëse e dija që nuk mund t'i ngjaja kurrë. Ai ishte nga ata që gjithmonë dinë të thonë gjëra të mençura, por në një mënyrë të re dhe të thjeshtë, jo si xha Kasemi, që kisha pasur në punë e që sikur i hidhte fjalët nga njëra degë në tjetrën. Por, ama, sa herë që e kisha dëgjuar të thoshte nga ato shprehjet e tij të famshme, plot humor dhe plot nënkuptime, më ishte kujtuar Astriti, që më pati thënë: «Populli ka gjetur gjithmonë format më të ndryshme për të shprehur qëndrimin e tij. Në çdo shprehje, në çdo fjalë të urtë të popullit do të gjesh në të njëjtën kohë edhe problemin, edhe qëndrimin, edhe perspektivën e zgjidhjes. Dhe të gjitha këto do t'i gjesh në format më mahnitëse të ironisë, të kontrastit, të një përplasjeje të përhershme emocionale». Dëgjo, o çun, këtu, i kishte thënë xha Kasemi një ditë Mësall Sulës që hyn-

te e dilte nga reparti, po gjezdise hu më hu, pa t'u ngul një hu, s'ka derman. Ne kishim qeshur, kurse Mësalli qe skuqur...

Xha Kasemi kishte dalë në pension të nesërmen e ditës që më pushuan mua.

Në shtëpinë e kunatës po më prisnin prej kohësh. Ende pa u përshëndetur dhe pa u ulur në divan, Donika më tha:

— Fredi, Liliana ka biseduar për ty me burrin e një shoqes së saj.

Unë vështrova Lilianën që më tundi kokën në shenjë pohimi, pastaj Lirimën që duket sikur më thoshte «dëgjoje njëherë».

— Shiko, — tha Liliana, — burri i një shoqes sime është drejtor. Unë e kam shumë shoqe atë dhe i shkova në shtëpi e i thashë kështu e kështu. Ishte edhe i shoqi aty. Ia qava hallin mirë. Më dëgjuan më, ç'të them! U erdhi shumë keq. Burri i shoqes sime tha se ata kishin bërë gabim që të kishin pushuar. Pastaj, u mendua ca, ndezi një cigare, (më dha edhe mua, por unë i thashë se nuk e pija), dhe më tha: «Po mirë, po të dojë kunati yt, unë e marr në punë edhe me atë librezë.» E di sa m'u bë qejfi, Donika?! E di sa u gëzova, Fredi?! E falënderova një mijë herë, po ai ma preu shkurt:

«Hiç asgjë mos më thuaj. Ata nuk kanë vepruar mirë. Mua punëtorë të tillë më duhen. Ai të vijë kur të dojë.» Kështu më tha... Nuk mund ta merrni me mend ç'burrë është!

Të gjithë më vështronin mua në heshtje. Prisinin përgjigje nga unë. Por unë kisha ulur sytë dhe nuk dija ç'të thosha. Më vinte mirë për një zgjidhje kaq të thjeshtë dhe të lehtë. Ndoshta për këtë më nxiste edhe ai qëndrimi i Lirimit «dëgjoje njëherë!». Një çast më erdhi keq edhe për Lilianën që e kisha gjykuar ashtu. Se ja, thashë me vete, ai parimi i saj që punët kërkonin mik, nuk qenka i dobishëm vetëm për ca gjëra të vogla. Miku mund të të dëgjonte më me vëmendje se një tjetër drejtues i panjohur për ty, mund të t'i besonte ato që i thoshe dhe të gjente një zgjidhje të shpejtë e të natyrshme. Megjithatë, nuk e di ç'më bënte të mos ngutesha. Sesi më dukej, sikur po tërhiqesha si frikacak, sikur po përfitoja nga një njohje e rastit, sikur po u jepja të drejtë atyre që më kishin përzënë nga ndërmarrja, sikur do të bëja tamam atë që ky Lirim Tirana më kishte thënë të mos e bëja. Por arsyeja e vërtetë që më bënte të mos e pëlqeja atë «ai të vijë kur të dojë» ishte autoriteti i këtij drejtori që më ngjante, edhe pse në prirje krejt të kundërta, me atë të Dyr Demës. Ai e pushonte një punëtor kur të donte, kurse ky tjetri e merrte në punë kur të donte... E sikur edhe për këtë të bëhesha një ditë i padëshirueshëm?... Ky qe një mendim i fsheh-

të që unë nuk ia shpreha askujt, i bindur se nuk do të më kuptonin drejt...

— Po ja, — u thashë, — të mendohem njëherë. Sidoqoftë, faleminderit prej teje, Liliana!

— Uh, ç'na the! — thirri ajo gjithë gjallëri dhe u ngrit të na qeraste.

— Jo, lëre, — i thashë, — se po dalim me Donikën.

— Dilni, se është herët, — tha edhe Lirimi dhe ne u ngritëm.

Atë mbrëmje Donika që shumë e dashur me mua. Më shtrëngonte krahun, zgjaste pak kokën përpara dhe më buzëqeshte, mbështetej pas supit tim dhe lëshohej si t'i merreshin këmbët. Më pëlqente që sillej ashtu, edhe pse më bënte pak përshtypje kjo gjë. E kisha njohur vajzë të përmbajtur, të thjeshtë e të natyrshme, tepër të natyrshme. Dhe, siç e kam thënë, këtë i kisha vlerësuar më shumë. Por te njeriu që dashke i pëlqeke të gjitha dhe unë kisha dëshirë që ajo të vazhdonte të më përkëdhelte edhe më shumë, ndaj rrija si i ngrirë, si të trembesha nga ndonjë lëvizje që mund ta sillte atë në natyrën e saj të zakonshme.

Donika përkuli pak kokën përpara dhe, duke më shtrënguar krahun, më tha:

— E di se ç'dua sonte? Dua të të qeras.  
Po në një vend të mirë. Te më i miri!

Ne ndodheshim pranë hotel «Tiranës» dhe ajo, pa pritur përgjigje nga unë, më tërhoqi drejt tij.

— Nga është hyrja këtu? — tha. — Se s'kam qenë ndonjëherë.

— Për ku? — e pyeta.

— Për andej ku pihet dhe hahet, — tha ajo dhe ne ngjitëm shkallët kryesore të hotelit, që të çonin në restorantin e katit të dytë.

Brenda kishte pak njerëz dhe ne u ulëm në një tavolinë në qoshe e në fund të sallës, ku do të dëshironte të ulej çdo çift të fejuarish. Donika më mori dorën në duart e saj një çast, por ma lëshoi shpejt dhe tha:

— Mos është turp këtu?

— Jo, — i thashë. — Megjithatë, mua nuk më pëlqejnë këto skena kur i shoh te të tjerët.

— Ah, po! — dhe uli kokën si të kërkon- te një mendim. — Je i mërziur, Fred?

— Jo, — i thashë. — Tani jo. Tani jam i gëzuar?

— Pse je i gëzuar?

— S'e di.

— Mos nga ajo që të tha Liliana?

— Nuk e di. Mbase edhe nga ajo.

— Do të fillosh punë atje?

— S'e di. Po ti ç'thua?

— Unë them të fillosh.

Erdhi kamerieri, një djalë i gjatë e i ho-



llë që s'po na e priste me shumë përfillje porosinë. Ne u kujtuam të shihnim menunë dhe ai u largua gjithë bezdi. Tani të prisnim kur të kthehej. Por s'na bëhej shumë vonë. Donika më kishte pyetur për diçka që unë duhej ta mendoja e të vendosja.

— Ti thua të filloj, — pëshpërita si me vete dhe nisa të rrotulloja një thikë në pëllëmbë të dorës. Ngrita kokën, u drejtova, lashë thikën dhe i thashë papritur: — Jo, nuk do të filloj. Nuk ka asnjë kuptim.

Donika u habit pak, i hodhi edhe një sy menusë, ashtu kot, pastaj më pyeti:

— E përse, Alfred, pse nuk ka asnjë kuptim?

— Sepse atyre do t'u bëhet qejfi, — i thashë. — Ata do të mendojnë se unë e ndjeva veten fajtor dhe se shkova shpejt në një ndërmarrje tjetër, i kënaqur që ata morën një masë të lehtë për mua. Ndërsa mua, tani që e kam më të qartë se shkaku i pushimit tim nga puna nuk ishte grindja me Gentianin, do të më dukej vetja njeri i dobët... Jo, nuk do të filloj punë atje ku thotë Liliana. Do të nis të kërkoj të drejtën time... Të paktën, do të mësoj e do të bindem nëse kam ndonjë të drejtë apo jo.

Kamerieri erdhi përsëri. Ne i dhamë një porosi të përgjithshme «sill çfarë të duash» dhe ai u largua. Nuk kisha më dëshirë të rrija në atë lokal të madh e të zbrazët. Mezi prisja të kalonte ajo mbrëmje e ajo natë

që të nesërmen në mëngjes të shkoja në zyrën e Ndhmës Juridike.

— Megjithatë, — tha Donika, — mua më duket se s'ka asnjë rëndësi për ty ç'mendojnë ata. Duke filluar punë shpejt, përkundrazi, ti u tregon se s'je pa njeri dhe nuk do t'ia dish për ato masat e tyre të bukura...

— S'është ashtu.

— Si jo? E ç'janë ata për ty tani? Ti s'ke të bësh fare me ta. Pastaj, të gjithë e dinë se si u mor ai vendim për ty dhe askush nuk të përflet... Pastaj, edhe një gjë tjetër: po të fillosh të kërkosh të drejtën tënde sa në një zyrë në tjetrën, ç'do të fitosh? Do të kthehesh prapë në punë. Por kjo kushedi sa mund të zgjasë. Kurse, duke filluar atje ku thotë Liliana, është njësoj si ta kesh fituar atë të drejtë që kërkon ti. Apo jo, Alfred?

S'dija ç'ti thosha. Më dukej se ashtu ishte, siç e arsyetonte ajo. Në fund të fundit, çfarë doja unë? Të punoja në profesionin tim. Atëherë, përse duhej të bridhja ditë të tëra, kur rasti më jepej për zgjidhjen më të thjeshtë e më paqësore? Vështrova Donikën i gatshëm për t'i thënë se kishte të drejtë. Sytë e saj më qeshnin dhe më luteshin. Ata thoshin më tepër se fjalët e saj dhe ajo nuk u vonua të shprehej.

— Pastaj, Fredi, ne do të martohemi shpejt dhe rroga e çdo pesëmbëdhjetëditëshi ka rëndësi për ne. Akoma s'kemi bërë gjërat më të domosdoshme. Ti e di vetë...

— Po, — i thashë, — ashtu është. — Dhe në çast më hipi një inat i papërmbajtshëm, një inat me adresë të papërcaktuar, por që më nxiste një mendim tepër të qartë. Ata më kishin futur nëpër ca bezdira e telashe që s'ua kisha borxh. Më kishin provokuar, më kishin hequr qafe ashtu siç kishin dëshiruar, më kishin turpëruar dhe tani kishin rënë në qetësi. Tani kishte një më pak nga ata që mund t'i ngacmonin, tani ata mund të merreshin me atë tjetrin ose tjetrën. Por jo, unë nuk doja të isha një më pak. Unë do të vazhdoja të isha bashkë me të tjerët. Dhe qysh nesër.

— Jo, — i thashë Donikës, — nuk do të filloj punë atje ku thotë Liliana. Nesër në mëngjes do të shkoj në zyrën e Ndihmës Juridike. Pastaj shohim e bëjmë.

— Si të duash, — tha ajo dhe nuk foli më.

Nga lokali dolëm pa e sjellë kamerieri porosinë.

Përpara një zyre të panjohur të krijohet kurdoherë njëfarë pasigurie. Sidomos, kur as në çastin e fundit nuk e di pse ke shkuar pikërisht aty, pasiguria bëhet edhe më e madhe. Isha gati të kthehesha prapa e të shkoja atje ku venin të gjithë, në Komitetin e Partisë. Te ne kështu është: kush ka një hall, kush mendon se i kanë bërë padrejtësi, kush ka ndonjë ankesë për ndërmarrjen a për personat të veçantë, atje shkon, se atje i mëson të gjitha dhe që andej i vjen e drejta, drejtësia. Kurse unë kisha shkuar në një zyrë të panjohur më parë nga unë, në një zyrë, për të cilën nuk dija se çfarë bënte e as për çfarë mund të më ndihmonte. Megjithatë, trokita në derë dhe prita të më thoshin «hyr». Më thanë. Ishte një zë vajze si prej fëmije. Hapa derën

dhe, pas një tryeze të vogël e me një makinë shkrimi përpara, pashë një vajzë të re. Ajo më vështroi pa asnjë shprehje. Në çast thashë me vete se kisha ardhur aty kot dhe, si për të fituar pak orientim, e pyeta nëse ishte pikërisht aty zyra e Ndhimës Juridike.

— Kjo, — tha vajza, — është njëra nga zyrat. Ç'kishit ju?

Duhet të kem mbledhur supet dhe të kem marrë ndonjë pamje prej tuhafi që vajza buzëqeshi dhe më tha të ulesha në karrige. U bë një heshtje e bezdisshme, por vajza nuk e la të zgjaste.

— Unë nuk kam cigare t'ju jap, — tha duke buzëqeshur, — por ju mund ta ndizni, po të dëshironi.

Po të mos e shikoje, mund të besoje se ishte vërtet një fëmijë nja dhjetë vjeç që i thoshte fjalët të përkëdhelura me plot ëmbël-si. Cigaren nuk e ndeza, por i thashë menjëherë:

— Nuk e di në kam ardhur tamam aty ku duhet, por hallin e kam kështu: Jam grindur me një shok të punës, me përgjegjësin tim, dhe për këtë më kanë pushuar nga puna.

Vajza sikur u mendua pak, pastaj më pyeti:

— Dhe çfarë kërkon të dish nga ne. Kërkon të paditësh njeri?

— Jo, — i thashë, — nuk dua të padis njeri. Dua të di nëse është vepruar drejt me mua, nëse e meritoj atë dënim dhe se a është

në kompetencat e ndërmarrjes pushimi nga puna i një punëtori, vetëm pse ka qëlluar dikë jashtë ndërmarrjes dhe për arsye krejt personale.... Ose jo tamam kështu...

— Duhet të më shpjegoheni hollësisht, — tha ajo. — Të më tregoni rrethanat e grindjes, arsyet dhe pasojat e saj, pastaj të them unë se ke a nuk ke të drejtë.

I tregova vetëm historinë e ekskursionit, ashtu siç kishte ndodhur, që nga organizimi i tij e deri te grindja në stacionin e Fierit. Ajo më dëgjoi pa më ndërprerë asnjëherë, me mjekrën e mprehtë të mbështetur mbi grush-tin e vogël.

— Për këtë të pushuan nga puna? — më pyeti.

— Po, — i thashë, — vetëm për këtë. Bë në një mbledhje të kolektivit, ku s'u mor vesh fare ç'u tha, dhe më dhanë librezën në dorë me këtë motivacion.

Nxora librezën nga xhepi i xhaketës dhe ia zgjata. Ajo e pa me njëfarë mospërfilljeje dhe ma ktheu.

— Dëgjo, Alfred, — më tha. — Ata nuk kanë vepruar drejt. Unë nuk po të them se as ti nuk ke bërë mirë që s'je përmbajtur, sepse ti ke ardhur këtu për të mësuar të tjerë gjëra. Kështu, ti qëlllove një njeri, sepse e ndjeve veten të fyer para së fejuarës. Nuk u përmbajte. Bëre gabim. Por gabimi kishte nisur më parë tek ata që të kishin provokuar. Ndaj, penalisht, ti nuk dënohesh... — Ajo heshti një çast. — Keni jurist në ndërmarrje

ju? — më pyeti. S'e di, i thashë. Nuk besoj. — Mirë, — vazhdoi ajo. — Edhe pse nuk ke-  
ni jurist, ata e dinin që nuk fitonin gjë po të  
të padisnin. Mirëpo, në njëfarë mënyre, ha-  
kun do të ta merrnin, apo jo? Dhe kuptohet,  
siç the ti, sajuan një mbledhje dhe të pushuan  
nga puna. Për këtë pushim të padrejtë ti  
mund ta hedhësh ndërmarrjen në gjyq dhe të  
fitosh të drejtën e rikthimit në punë. Besoj  
se edhe ti këtë kërkon nga ne, apo jo?

Pa marrë ende fjalën time, ajo nxori nga  
një sirtar disa letra që mua m'u dukën si  
fletëthirrje, sepse në krye kishin emrin e Zy-  
rës Juridike, dhe nisi të shkruante diçka mbi  
to, por unë nuk e lashë të vazhdonte.

— Jo, — i thashë, — as që më kishte  
shkuar mendja për këtë. Ka disa gjëra që  
dalin jashtë këtij rasti, që mund të kenë një-  
farë lidhjeje, por që më tepër kanë të bëjnë,  
s'di si ta shpreh... domethënë me qëndrimin  
në përgjithësi të drejtorit të ndërmarrjes  
ndaj meje dhe ndaj disa të tjerëve.

— Ashtu?

— Kështu më duket mua.

— Atëherë do të shkosh në Bashkimet  
Profesionale të Rrethit. Ata mund ta anulojnë  
vendimin e pushimit tënd nga puna, po ta  
shohin të arsyeshme.

Ajo heshti aq sa futi përsëri fletët në sir-  
tar, pastaj, në një mënyrë që unë s'arrija ta  
kuptoja se ç'donte të thoshte, më pyeti:

— Po mirë, Alfred, përse kërkon t'i ngresh  
tani këto probleme? A s'mund t'i kishe thë-

në më parë? A s'do të ishin atëherë më bindëse?

— Sigurisht, — i thashë pak rëndë, sepse nuk më pëlqeu vërejtja e saj, — më mirë do të ishte. Por ca gjëra unë i kam thënë dhe më duket se prandaj qenë edhe aq të gatshëm të më hiqnin qafe.

— I ke thënë nëpër mbledhje?

— Jo, ua kam thënë në sy.

— E pse jo nëpër mbledhje?

Bëra një gjest bezdie me dorë dhe nuk fola. Më dukej e kotë t'i thosha asaj vajze, edhe pse aq e sjellshme dhe tërheqëse, se, t'u flisje njerëzve në sy për të metat e tyre, ishte shumë më tepër trimëri dhe burrimi sesa t'i thoshe në një mbledhje me dyqind a treqind veta. Sepse, në fund të fundit, para se të thuhesh nëpër mbledhje, gjërat u thuhesh në sy dhe shoqërisht njerëzve. Unë kështu kisha bërë dhe më vinte mirë për qëndrimin tim. Por, po t'ia shprehja asaj këto, me siguri që do të më merrte për mburravec dhe unë s'kisha qejf të dukeshat i tillë.

U ngrita nga karrigia. I gëzuar. Shumë i gëzuar, sepse, si të thuash, zyrtarisht, juridikisht kisha marrë vesh se ata nuk kishin të drejtë. Dhe kjo më gëzonte pa masë. I dhashë dorën vajzës, i thashë dy herë «faleminderit» dhe bëra të dilja, por u kujtova se mund t'i detyrohesha diçka dhe e pyeta.

— Asgjë, — tha vajza. — Ju e dini se te ne këshillat nuk paguhen.

E falënderova edhe një herë dhe dola



nga zyra me keqardhjen që s'mund t'i jepja të paktën një kafe në pastërinë përballë, sepse nuk e kisha zakon t'i ftoja për kafe vajzat që s'i njihja mirë.

Rruga e Durrësit ishte e qetë dhe e ngrohur nga dielli i pranverës. Koha e kthjellët sikur të ndillte shëtitje të ngeshme dhe të nxiste mendime të mira. Por mendimet e mia qenë të përziera, shumë të përziera dhe të shpërndara. Ende nuk e kisha fort të qartë se përse duhej ajo zyrë e Ndihmës Juridike, një zyrë ku nëpunësit jepnin këshilla dhe s'merrnin asgjë. Në të vërtetë, kjo ishte një hamendje e kotë, sepse, unë duhej të mendoja për të tjera gjëra. Për shembull të pyesja veten se përse unë, qytetar i Shqipërisë, dija aq pak për jetën tonë administrative. Për të kërkuar një vend pune a një të drejtë studimi, ne u drejtohemi komiteteve ekzekutive; për të qarë hallet tona, njohim vetëm dyert e komiteteve të partisë. Më habiste kjo gjë. Më habiste sidomos puna e këtyre njerëzve të komiteteve të partisë që duhej të dinin gjithçka, që duhej të ishin edhe juristë, edhe ekonomistë, edhe politikanë. Askujt nuk i kishte ndodhur të shkante te një instruktor partie, i cili t'i kishte thënë se kjo çështje nuk varej prej tij. Ai e kishte dëgju-

ar me vëmendje, i kishte dhënë të drejtë ose jo dhe zgjidhjen e problemit e kishte hedhur mbi supet e Komitetit të Partisë. Çudi. Ishte një punë që ata e merrnin përsipër vullnetarisht apo nga bindja që në një mënyrë a tjetër, çështja mund të përfundonte përsëri tek ata? Kurse, për mua, kjo ishte shprehja e asaj që mbi çdo gjë e mbi gjithçka te ne rri Partia, një Parti ndaj së cilës më dukej se ne, qytetarët e thjeshtë, tregohemi ndonjëherë të padrejtë. Përse për çdo gjë duhet t'i drejtohem vetëm asaj, siç më kishin thënë edhe mua? A s'duhet ruajtur ajo vetëm për gjëra më të rëndësishme? Sigurisht që po, mendoja unë. Se ja, ajo vajza e re e Ndihmës Juridike më kishte drejtuar në gjyq ose në Bashkimet Profesionale dhe jo në Komitetin e Partisë...

Në çast, përfytyrimi i kësaj vajze, së cilës nuk i kisha mësuar as emrin, m'i ngatërrroi mendimet. Harrova ç'po thosha dhe nisa të mendoja për atë sigurinë e saj. Ajo nuk duhej të ishte më e madhe se Donika ose Shpresa, por fliste sikur të mos dyshonte për asgjë në ato që thoshte. Dhe patjetër që i dinte mirë punët e saj, ndaj dinte ç't'u thoshte edhe të tjerëve...

Kam pasur gjithmonë respekt për njerëz të tillë që më ngjanin me tim vëlla. Njerëz të tillë, thosha me vete, janë të aftë për çdo gjë. Janë të aftë sidomos për të drejtuar e për të mësuar të tjerët. Edhe ne kishim të tillë në ndërmarrjen tonë, por ata nuk drej-

tonin. Dyrr Dema gjente njëqind mënyra për t'i lënë në vende të tilla pune që të mos kishin mundësi të hynin në gardhin e ngjeshur të klanit të tij. (Po, klan kishte. Nuk ka asgjë të tepruar këtu. Unë kuptimin e kësaj fjale e dija mirë dhe e përdorja me vend.). Në klanin e tij mund të hynin vetëm ata që dinin të belbëzonin, sepse, të flisje, kjo i takonte vetëm Dyrrit. Çudi! Unë kisha lindur gjashtë vjet pas Çlirimit, kisha mësuar në shkollë dhe në jetë për socializmin tonë, por Dyrr dhe klani i tij nuk më hynin në ato që kisha mësuar unë. Aty hynin njerëzit punëtorë, të ndershmit, të drejtët, të sinqertët, të pastrit, të mirët. Nuk hynin të djallëzuarit, tinëzarët, inatçinjtë, të pabesët, ziliqarët, dredharakët, marifetçinjtë, të poshtrit. Dhe për mua njerëzit ishin dypalësh: këta që ishin të mirë, dhe këta që ishin të këqij. Të mirët mund ta kishin ndonjë të keqe të vogël, por prapë ishin të mirë; të këqijtë mund të kishin ndonjë të mirë, por kjo nuk i ndërronte: ata mbeteshin po të këqij. «Nuk është kështu, — më kishte thënë një ditë Shpresa Bilali. — Njerëzit kanë të meta, por ato bëhen përherë më të vogla, sa më shumë që shoqëria jonë përparon, sa më e madhe bëhet e përgjithshmja pozitive. Natyrisht, nuk e kam fjalën për armiqtë.» Nuk kisha ndonjë kundërshtim. Por, midis dy të rinjve, njëri i rritur dhe i edukuar mirë, tjetri keq, kur të jenë burra të moshuar, cili do të jetë më i përsosur? Sepse, në qoftë se nga i pari pri-

tet rritje e përsosur, nga i dyti nuk pritet kjo, por ndreqja e asaj që e ka bërë kështu e ashtu. «E stërholluar kjo që thua ti, Alfred, — më kishte thënë Shpresa. Megjithatë njerëzit ndërrojnë aq shumë nga rrethanat, sa i pari yt mund të bëhet i dytë dhe i dyti i parë.» Nuk më kishte bindur, por edhe unë nuk e kisha zgjatur, sepse e dija që nuk isha i zoti t'i shpjegoja atë që kisha në mendje e që s'e formuloja dot me fjalë. «Dialektika e përgjithshme e zhvillimit shkon kështu siç thua ti, — ma shpjegoi im vëlla në mbrëmjen e asaj dite, — kurse e veçanta nuk e përjash-ton atë që të ka thënë shoqja jote. E rëndësishme është që gjithçka punon për të mirën.» Po. Isha i bindur nga ky gjykim i përgjithshëm dhe kisha besuar që edhe Mësalli mund të hynte në këtë përmirësim po kaq të përgjithshëm. Kurse Dyr Dema jo. Ai nuk kishte as kohë për një gjë të tillë. Ai ishte prapa në kohë. Ishte plakur. Dhe pleqtë, kur janë me kohën, do të thotë se në rini kanë fluturuar. Ndërsa kur kanë mbetur prapa, vështirë ta arrijnë atë që u ka ikur. Apo jo? «Po, — më tha im vëlla. — Alfred, e di se ke filluar të mendosh si filozof?» Mua më pëlqeu kjo dhe me siguri do të jem fryrë e do të kem dalë nga shtëpia tepër i kënaqur.

Edhe tani kështu po shkoja te pallati që po ndërtonim, tepër i kënaqur. Kishim arritur në katin e katërt, në katin tonë, siç e quanin ne, unë, Ylli e Kujtim Sauku. E quanim

kështu sepse e dinim që i dyti e i treti ishin për ca më të rëndësishëm se ne; për ata që kishte më për zemër Dyrri Dema. Kurse i pari dhe i pesti do të mbeteshin për nevojtarë të tjerë që ishin më pak të rëndësishëm se ne. Natyrisht, sipas klasifikimit dhe simpative të Dyrrit...

Që larg pallati m'u duk më i lartë e më i bukur. Dhe unë nxitova. Atë ditë mund të punoja aty edhe dhjetë orë.

Nuk e di ç'marrëzi tjetër mund të kisha bërë kur më thanë se Dyrri kishte dhënë urdhër që unë të mos punoja më në pallat. Duhet të kem marrë një pamje prej idioti që m'u duk se brigadieri u tremb; duhet të kem pyetur në një mënyrë mjaft të çuditshme që ai m'u përgjigj me një formulë si të mësuar përmendsh: «Një të pushuari nga puna nuk mund t'i jepet shtëpi. Kjo do të ishte njësoj sikur t'i thoshte tjetrit: «Bëj ti keq, se unë ta shpërblej me të mirë.» Kështu kishte thënë Dyrri Dema dhe po kështu m'i përcillnin edhe mua ato fjalë, si të kishin frikë mos harrojnë ndonjë presje. Më erdhi si të pështirë dhe e vështrova brigadierin me inat.

— Po mirë, — i thashë, — sikur të mos dua të dëgjoj se ç'ka thënë Dyrri, ti çfarë do të më bësh?

Kisha një duf që isha gati ta shfryja ndaj kujtdo dhe mezi e prisja një shkak. Por Besnik Zajmi ishte djalë i urtë e i qetë. Ai nuk jepte kurrë rast për grindje. Edhe tani, vetëm sa ngriti pak supet e tha:

— Ti bëj si të duash, Alfred. Mua më porositi të t'i them këto fjalë, dhe unë t'i thashë.

Nuk fola. Ngjita shkallët dhe shkova në katin e katërt, ku më prisnin Ylli me Kujtimin. Gjatë asaj rruge të shkurtër, që m'u duk e pafundme, m'u bë sikur pas shpinë më ndiqte përsëri ai vështrimi keqardhës i Natali Hajredinit kur kisha dalë nga zyra e Dyrrit që më thoshte: «E shikon si i prishe të gjitha? Nuk më dëgjove mua...» Ky kishte qenë një vështrim që më kishte ngritur nervat. Po mbase ajo kishte pasur të drejtë. Mbase ishte më mirë të mos sillesha ashtu, por të bëja edhe unë si ata njerëzit e mençur që i marrin punët shtruar e me durim. Mbase, thashë me vete, është më e arsyeshme të shkoj njëherë te vajza e Ndihmës Juridike, ta pyes nëse kam të drejtë shtëpie, edhe pse jam pushuar nga puna. Dhe, në qoftë se kam, të marr një copë shkresë prej saj e t'ia lëshoj mbi tavolinë Dyrr Demës që të mos më çajë më kokën.

Zbrita shkallët dhe, pa i folur askujt, u largova nga pallati duke dredhuar nëpër rrugezat me llaç e beton anash.

Për gjëra që nuk janë të zakonshme në jetën time, unë habitem shumë, si atë mëngjes kur Natali Hajredini më erdhi për vizitë në shtëpi.

Ishte e nesërmja e asaj dite kur më thanë se Dyr Dema kishte dhënë urdhër që unë të mos punoja më në pallat. Ishin një thes me gjëra për t'u shkoqitur e renditur sipas radhës, kështu që e kisha mendjen tepër të shpërndarë kur zilja ra dy herë, e shkurtër dhe si e druajtur. Shkova të hapja derën i nervozuar, sepse pikërisht në atë çast sikur po vija njëfarë rregulli në punët që më prisnin: Komiteti Ekzekutiv, Bashkimet Profesionale, Donika; plot vende e njerëz ku shkoja për t'u shpjeguar e për të më shpjeguar.

Kur pashë Natali Hajredinin, aq pa kup-

tim m'u duk prania e saj aty, sa nuk i thashë as të futej brenda. Vetëm e pyeta:

— Urdhëro! Çfarë kishe?

Ajo buzëqeshi lehtë dhe, me një zë krejt të natyrshëm, më tha:

— Alfred, unë jam kaq e padëshiruar për ty apo ti kaq i pasjellshëm që nuk më fton as brenda?!

Më erdhi pak rëndë, por as që më shkoi në mendje t'i kërkoja ndjesë.

— Hyr, — i thashë dhe i tregova me dorë kuzhinën që ishte më e rregulluar.

Ajo u ul në divan dhe nisi të më vështronte në një mënyrë që s'e duroja dot. Fillova të ndieja bezdi dhe të lëvizja kot.

— Rri, Alfred, — tha ajo. — Ulu edhe ti, se unë nuk dua asgjë. Kam ardhur vetëm për të biseduar pesë minuta me ty dhe kaq.

Zëri i saj ishte i ëmbël, por i ngjirur dhe i lodhur, si të kishte kënduar tërë natën. Nuk kisha biseduar ndonjëherë me këtë grua, veçse rastësisht e për pak çaste. E kisha dëgjuar të fliste si një çupë e përkëdhelur dhe e kisha quajtur një femër krejt të lehtë. Tani që më thoshte se kishte ardhur për të biseduar diçka me mua, isha i bindur që do të më fliste për gjëra fare pa rëndësi dhe isha gati t'i lutesha që t'i shkurtonte sa më shumë ato pesë minuta, sepse kisha punë për të bërë. Por ajo filloi në një mënyrë që mua më bëri përshtypje dhe sesi m'u duk (vetja, si i padrejtë që kisha menduar ashtu për të. Ajo më tha:



— Ti, Alfred, me siguri mua më quan një grua mendjelehtë e, mbase, edhe të ligë. Por, sido që të më quash ti, nuk besoj se i jep vetes të drejtë të më përflasësh nëpër njerëz të tjerë, kur unë ty nuk të kam bërë asnjë gjë të keqe. Ti ç'ke me mua që më shan?

Po e vështroja edhe më i habitur sesa kur e pashë në derë. Po pyesja veten se kur e kisha përfolur dhe, nëse vërtet e kisha bërë një gjë të tillë, përse ajo më fliste ashtu, me aq butësi dhe sikur kërkonte të më mbush-te mendjen me çdo kusht që ajo ishte aq e mirë, sa unë nuk mund ta përfytyroja. Ah, po, tani m'u kujtua. E kisha kërkuar si dëshmitare në atë mbledhjen e famshme. Kisha thënë se ajo kishte qenë më pranë nga të gjithë kur kisha qëlluar Gention Spahun dhe mund të tregonte më mirë se cilido si ndodhi. Atë çast, për dreq, nuk më kujtohej emri dhe, s'di si më shpëtoi e thashë: «E pra, ajo gruaja që i thonë «dashnorja e Dyrrit», ajo ka qenë më pranë nga të gjithë». Tjetër përfolje nuk më kujtohej dhe nuk besoja të kisha bërë ndonjëherë.

— Ti, — vazhdoi ajo, — mund të më pyesësh se ç'ke thënë për mua. Kjo nuk ka asnjë rëndësi. E rëndësishme është ajo që ti dhe shumë shokë të tu mendojnë për mua. Oh! Në të vërtetë dua të them gjëra krejtësisht të tjera, që ty mbase të interesojnë më shumë... Eh, si është jeta... — Ajo hapi çantën

dhe nxori paketën e cigareve. — Dua ta ndez një, — tha. — Ti do?

E mora cigarenë që më zgjati dhe asaj ia ndeza me çakmakun tim. Ajo e thithi thellë disa herë. Unë i vura një gotë përpara dhe i hodha raki.

— Nuk do të më shash po ta pi? — pyeti me një ironi të hapur.

Nuk i ngrita sytë fare për ta vështruar, sepse e ndieja që po buzëqeshte. Nuk më pëlqente ajo lloj afërsie që kërkonte të krijonte aq shpejt me mua. Mendja më shkoi te ndonjë djallëzi e paramenduar, prandaj e largova gotën time dhe i thashë:

— Fol, Natali, çfarë do nga unë?

Ajo më vështroi në një mënyrë të tillë që gati më bëri t'i thosha të ngrihej në çast e të shporrej, por e përmbajta veten.

— Mos u zemëro, Alfred, — tha. — E kisha fare pa të keq. Por tani që ti u bërë kështu në fytyrë, unë vërtet nuk e di se ç'mund të them dhe as përse kam ardhur këtu...

— Atëherë...

— Po, Alfred, do të iki. Vetëm se më vjen shumë keq që erdha këtu si një budallaçkë. Erdha për të të mërzhitur ty dhe veten.

Ajo heshti, por nuk lëvizi nga vendi. Kisha përshtypjen se ngashërehej përbrenda. Kjo m'i acaronte edhe më shumë nervat. Më vinte inat me veten që po lejoja skena pa kuptim, por në të njëjtën kohë sikur po

më guduliste edhe një lloj kureshtjeje për të ditur arsyen e vërtetë të asaj vizite.

— Fol, Natali, — e nxita. Hajt, gëzuar!

Ajo ngriti gotën dhe unë vura re shkëlqimin e syve të saj të zinj e të bukur. Ajo duket e ndjeu këtë ndaj buzëqeshi dhe tha:

— Më urren ti mua, Alfred?

Sytë e saj u zmadhuan dhe morën më tepër shkëlqim, si në pritje të diçkaje. Këtë lloj vështrimi unë ua njihja grave, ndaj ndjeva të skuqesha dhe, pa u menduar e pa e kuptuar se si, iu përgjigja menjëherë:

— Jo. E përse duhet të të urrej? Unë s'kam asnjë lidhje me ty.

Ajo u ngazëllye, u gjallërua aq shumë sa unë nisa ta ndieja veten me të vërtetë të bezdisur dhe të pazotin për të menduar as përse ndodhej ajo grua aty, as çfarë duhej t'i thosha e as çfarë të bëja me të. Vendosa ta dëgjoja deri në fund dhe të mos e ndërprisja më, çfarëdo që të përralliste.

— Fol, Natali, — e nxita dhe ajo foli si një gurgullimë përroi, plot zhurma e tinguj të përzier, herë të butë e gjithë melodi, herë të mprehtë e të ardhur si prej një egërsie të largët.

— Nuk është e vërtetë, Alfred, — tha. — Nuk është e vërtetë që ti s'më urren. Ti ke arsye për këtë dhe mua do të më pëlqente që ti të më urreje. — Ajo heshti një çast dhe më vështroi në një mënyrë mjaft shprehëse, si të më thoshte: Oh, sa të dua dhe sa më vjen keq për ty! Pastaj vazhdoi: — Ty të

kurdisën një gjë të vogël, por të poshtër dhe fare të padrejtë. Kërkuan të të bënë një shaka, të të fyenin, por të lanë pa punë. Dhe këtë e bënë ata njerëz, me të cilët unë rri më shumë dhe nga të cilët unë kam ditur gjithçka për ty: si të lavdëronin në fillim dhe si nisën të mos të donin më pas, derisa u bëre i padëshirueshëm për ta... Kjo më rëndon edhe tani... Prandaj erdha...

Ajo psherëtiu. Piu rakinë e mbetur në gotë dhe buzëqeshi me vete, si me një kujtim të shkuar, shumë të brendshëm. Unë i hodha prapë raki, sepse nuk i besova që kishte ardhur për shkak të asaj që tha dhe sepse e ndieja që do të fliste gjatë e do të kishte nevojë të pinte.

— Të kujtohet ty njohja jonë e parë, kur sapo kishe filluar punë te ne? — më pyeti.

— Po, — i thashë.

— Vërtet?! — u habit ajo. — Isha e bindur se nuk e mbaje mend.

— E mbaj mend shumë mirë, — i theksova fjalët dhe seç më hipi ta ngacmoja, me pak ligësi. — Unë, — i thashë, — po merrja një pjatë me patate në sportelin e mensës. Ti po flisje me kuzhinieren që prapa shpinës sime. Qeshnit. M'u duk se po qeshnit me mua dhe, kur u ktheva për t'u ulur në tavolinë, ti më the: «Do një krem me kakao? Janë shumë të mirë.» Kuzhinierja vuri duart në mes dhe u shkul gazit. Ti vetëm buzëqeshje plot ëmbëlsi, si tani. Unë nuk të fola. Nuk të thashë as po, as jo. Nuk të fola as kur ti solle dy kre-

met në tavolinën time dhe u ule përballë meje. Fola vetëm kur ti më pyete: «Vetëm të hash di ti?» Unë të thashë «Jo». Ti the: «Shumë mirë», dhe u ngrite. Unë të vështrova nga pas. Dukeshë gjithë siguri, në çdo lëvizje të trupit. Kështu. Kam harruar ndonjë hollësi?

Ndeza një cigare dhe po prisja me njëfarë kureshtjeje, duke mbajtur një lloj poze që i thoshte Natalisë: Hë, vazhdo tani! E shikon që unë jam i zoti t'i kujtoj ca gjëra shumë më mirë se ç'mendon ti? Dhe Natalia tha:

— Ti paske kujtesë fantastike. Ti edhe i kujton hollësitë shumë bukur. Po unë mbaj mend tjetër gjë nga njohja jonë e parë. Ato ditë flitej shumë për ty. Flitej si për një mik të Dyrrit dhe si për një djalë tërheqës... Por ç'e do. Bashkë nuk patëm asnjëherë mundësi të rrinim e të njiheshim. Sepse, po të njiheshim, ti mund të mos mendoje më për mua siç mendon tani.

Ajo heshti pak dhe piu raki. Ndezi një cigare nga të sajat. Edhe pse më dukej se thoshte gjëra krejt pa rëndësi, po më pëlqente mënyra se si fliste. Kishte një zë të afërt dhe fjalët sikur i vallëzonin nëpër gjuhën që i lëvizte shumë dhe nëpër dhëmbët e bardhë që i ndrisnin.

— Dhe, a e di ti, Alfred, — vazhdoi ajo, — që, kur ti nise të shkoje te «Drini» me ata dhe kur Mësalli më tregonte ndonjë gjë të vogël për ty, unë gëzohesha, pa asnjë arsye? Ose, ndoshta, ngaqë në mënyrë të pavetëdijshe ndieja një afrim të mundshëm

në të ardhmen midis nesh. Por kjo nuk ndodhi kurrë. Ti nuk shkoje më me ata dhe Mësalli filloi të mos fliste mirë për ty. Dhe jo vetëm ai. Doja të vija të të thosha të kishe kujdes, por nuk guxoja, sepse nuk të njihja. Kërkoja një mundësi afrimi me ty, por ti ishe lidhur me shoqëri të tjera, ku unë s'mund të hyja...

Ajo më vështroi e më buzëqeshi si të më kërkonte ndjesë që po më prekte në ca gjëra, të cilat më përkisnin ngushtësisht mua, por që ajo i thoshte pa të keq, sepse ashtu binte fjala. Unë i buzëqesha, për mirësjellje, dhe i hodha prapë raki.

— Fol, Natali, — e nxita përsëri.

— Po, — tha ajo dhe ndezi një cigare tjetër në bishtin e së parës. E thithi tymin thellë dhe e lëshoi pjesë-pjesë me një ndarje mjaft të ritmuar. — Eh, — bëri, — ca gjëra të habitin me të vërtetë. Më habitin edhe mua që s'para çuditëm lehtë. — Ajo heshti prapë një çast, si për ta bërë më të pritshme atë që do të më thoshte, dhe më pyeti: — A e di ti, Alfred, se ty ta kishin kurdisur pushimin nga puna?

— E di, — i thashë.

— Po se kjo do të niste në ekskursion e dije?

— Jo.

Ajo vuri buzën në gaz dhe më shikoi si për të më thënë: «Ja pra, ka edhe gjëra që mund t'i mësosh nga unë.» Pastaj vazhdoi:

— Ata kishin menduar disa variante. Në-

se ti do ta rregulloje vetë me shoferin apo me ndonjë shokun tënd që mund të të liron-te vendin, lojën do ta vazhdonin në hotel, në ndarjen e vendeve. Nëse do ta lije të fejuarën të vinte me ne, kurse vetë do të gjeje ndonjë makinë të rastit, rrugës do të ngacmonin Donikën derisa ajo të mërzhitej... Po, që mund ta qëlloje Gentianin, kjo ishte hamendja më ekstreme e Mësallit... Dhe ç'të qëlluar! Ja, kjo nuk mund të parashikohej...

— Megjithatë, s'erdhe në mbledhje të dëshmoje që nuk e kisha vetëm unë fajin, — e ndërpreva.

— Oh, — bëri ajo, — këto s'janë punë grash! Unë u mahnita me fuqinë tënde dhe prapë ndjeva keqardhje që s'kisha pasur mundësi të bëheshim shokë...

U ngrita dhe shkova në bufe. Nuk kisha dëshirë ta dëgjoja më. Po më lodhte ai stërhollim pa kokë, që s'dihej në do të mbaronte ndonjëherë...

Mora kafënë dhe sheqerin me atë fije shprese që më jepte mendimi se, pas kafesë, njerëzit e quajnë të kryer vizitën dhe ngrihen e ikin.

— Jo, mos bëj kafe! — tha Natalia me dorën përpara.

— Patjetër, — ia ktheva unë, — në çast, bile! Për dy minuta e bëj gati unë! — i thashë me një nënkuptim që vetëm unë mund ta merrja vesh dhe vura xhezven në furnelën e vogël elektrike.

Ndërkohë që zieja kafënë në aneks, Nata-

lia vazhdonte të fliste. Nuk e di se çfarë pushteti mund të ketë fjala te të tjerët, por tek unë fjalët e asaj gruaje të bukur se ç'krijonin një si gjendje miratuese, ku çdo gjë më dukej se ishte ashtu siç thoshte ajo, megjithëse nuk kishte një lidhje në ato që thoshte, ose unë nuk isha i zoti t'ua bëja lidhjet. Aq përshtypje bënin fjalët tek unë, sa më ndodhte t'u kthehesha disa herë faqeve të ndonjë romani që lexoja në përgjithësi shumë më ngadalë se ata që lexojnë për të kaluar kohën si unë. Por, ndoshta më shumë se fjalët, mua më bënte përshtypje tingulli i zërrit të saj, ajo loja me zanoret e bashkëtingëlloret nëpër gjuhën e lëvizshme e nëpër dhëmbët e saj të ndritshëm. Dhe, në këtë koncert tingujsh, Natalia më kishte pyetur, ashtu si pakuptuar dhe miqësisht, se ç'kisha ndër mend të bëja. Unë i kisha treguar që kisha qenë në zyrën e Ndhmës Juridike, se do të shkoja në Bashkimet Profesionale dhe, më pas, në Komitetin e Partisë. Ajo më kishte thënë që, po të dëshiroja unë mund të bisedonte me Dyrin që të kthehesha përsëri në ndërmarrje. Sepse (unë mund të mos e besoja) në të vërtetë Dyrin kishte filluar t'i vinte keq për mua dhe, jo më vonë se dje, kur i kishin treguar për qëndrimin tim në pallatin që po ndërtohej, kishte shprehur keqardhjen e tij...

Tani, kur kafeja kishte filluar të ziente, Natalia po më thoshte:

— Po të ishte Dyrri njeri i keq, Alfred,



unë nuk do të rrija asnjë çast me të. Por ai nuk është i keq. Ai është i paaftë. Ai është bërë i paaftë. Ai bëhet çdo ditë e më i paaftë. Dhe kjo mua ka filluar të më tmerrojë. Oh, nuk mund ta marrësh me mend se si më vjen kur e shoh në këtë gjendje! A beson ti, Alfred, që atij ka filluar t'i kundërshtojë edhe Musa Zhuri. Erdhi dje në zyrë dhe i foli Dyrri për ty. (Kjo ishte në të vërtetë arsyeja që më solli këtu). I tha se ishte ngutur me atë vendim dhe se duhej të gjenin një zgjidhje tjetër. Por Dyrri ia preu shkurt: asnjë zgjidhje tjetër nuk kishte! Kurse mua më tha krejt tjetër gjë: mund të bëhej diçka për ty, por nga ai vetë, jo nga ky Musa Zhuri. Kur u bë edhe ky të marrë flamurin në dorë, më tha, dhe mua prapë më erdhi keq. Oh, i shkreti! Ai nuk është njeri i keq. Ose, të paktën, për mua nuk ka qenë asnjëherë i tillë...

— E si do të ishte për ty i keq, — i thashë duke i hedhur kafënë në filxhan. — kur ti ke pasur aq të mira prej tii?

Ajo u mblodh, u tkurr si të kisha lëshuar një rrymë të fortë korrenti mbi të. U drodh.

— Ç'cinizëm! — tha. — Ç'keqdashje! — Ndezi prapë një cigare në bishtin e së parës. Po pse, Alfred, çfarë kam bërë unë? Çfarë krimi? Çfarë poshtërsie apo çfarë tradhtie? Thuaie! — Ajo tundi kokën si në një mosmarrëveshje të padurueshme dhe, me atë zërin e sai të natyrshëm që sikur kërkonte të të bindte me çdo kusht, tha: — Unë, Alfred,

jam një fatkeqe; një fatkeqe për fajet e të tjerëve. A më kupton? Ja ç'jam. Një vajzë e vogël që, kur u rrit e nisi të kuptonte se ishte e bukur dhe e gëzuar, i thanë të mos qeshte. Por unë nuk ua vura veshin. Unë e doja jetën dhe vendosa ta gëzoja atë si të mundja. Dhe kështu bëra e kështu vazhdoj të bëj... Kurse ti, për këto që unë dua, për jetën që bëj, më përçmon e më tall me cinizëm. Por unë, unë prapë nuk të marr inat, prapë të kuptoj dhe të jap të drejtë, megjithëse e di që mendon keq për mua. Por, Alfred, kjo është jeta ime. Dhe unë në këtë mënyrë do ta dua e do ta përballoj, duke qenë e mirë edhe me ata që s'janë të mirë me mua e jo më me ata që më kanë kuptuar, më kanë dashur dhe më kanë përkrahur...

Ajo u ngrit, u rregullua pak dhe më zgjati dorën. Ma shtrëngoi butë dhe më tha:

— Një nga këta njerëz të mirë për mua është edhe Dyr Dema. Ai e ka quajtur të drejtë këtë mënyrën time... Kështu do të dëshiroja ta quaje edhe ti.

— Unë, jo, — i thashë. — Për mua, sidoqoftë, ajo është e ulët.

Më vështroi gjatë, shumë gjatë, aq sa fillova të mos e duroja më. Ma lëshoi dorën dhe kur po ndaheshim në derë, aty ku u takuam, përsëriti:

— Sidoqoftë!

Dhe u largua nëpër shkallë pa bërë as edhe zhurmën më të vogël. Unë mbeta për disa çaste në derë duke menduar përse kishte

ardhur dhe çfarë kishte kërkuar nga unë ajo  
grua.

Im vëlla e shpjegoi kështu vizitën e Natalia Hajredinit: «Kur njerëz të tillë fillojnë të binden për prishjen e tyre, kur fillojnë ta ndiejnë veten përherë e më të braktisur nga të tjerët, kur kuptojnë edhe mendimin e keq shoqëror ndaj tyre, atëherë ata bien në mjerim dhe në këtë mjerim kërkojnë dëshmitarë të së mirës. Edhe ti je një i zgjedhur si dëshmitar për të thënë një ditë: Jo, nuk ishte aq e keqe e shkreta, Dhe kjo, për atë, do të ishte vazhdimi i një lufte tepër të pastajme, i një lufte jashtë saj e brenda teje, brenda nesh.»

Nuk e pata dhe aq të qartë këtë që më tha im vëlla, por edhe ai vetë nuk mund të më shpjegonte më hollësisht, sepse ishte një mendim që i kishte lindur në çast. Megjithatë, një pjesë të saj ma sqaroi Kujtim Sauku. Ai më thirri që larg kur po shkoja te Donika dhe më tha:

— Po ti, në mëngjes rri me Natalinë dhe në mbrëmje me të fejuarën?!

Nuk më pëlqeu ngacmimi i tij, ndaj i bëra shenjë me dorë që t'i linte ato shakarra.

— E pse? S'të vjen mirë, ë? — vazhdoi ai.

— E ç'donte Natalia te ti?

— Lëre, pra! — i thashë. — Kishte ardhur të ankohej, të më kërkonte shpjegime se ç'kisha unë që e merrja atë nëpër gojë.

Kujtimi qeshi me të madhe. E kishte zakon këtë. Kur qeshte, e gjithë fytyra sikur i bëhej buzë dhe ndriste i tëri. Fërkonte duart dhe shkrihej gjithë kënaqësi.

— Pse, ti beson vërtet se ajo kishte ardhur për këto përralla?

— Sigurisht. Pastaj, më tha se, po të doja unë, mund të bisedonte me Dyrriin që të kthehesha prapë atje. Por unë ia preva.

— Rri, mos u bëj rrotë! I bie ndër mend Natalisë se kush flet keq e kush flet mirë për të? Ti e di ku e ka mendjen ajo... Prandaj ka ardhur me vrap të të sjellë edhe fjalët e Dyrriit... Po ç'të të bëj ty unë!

Ai më tërhoqi nga krahu dhe më futi në kafene «Partizani».

— Do të pimë një kafe, — tha, — dhe do të të tregoj një gjë të bukur... Po, njëherë, më thuaj përse nuk vjen prapë në ndërmarje, derisa paska thënë Dyrri?

— Kam filluar ta kërkoj ndryshe, — i thashë, — dhe besoj se do të më japin të drejtë.

— Shumë mirë, — tha edhe Kujtimi. — S'ke përse ta ulësh hundën përpara atyre edepsëzëve. Bëra fjalë një ditë me Gjentianin. I thashë që ishin treguar me gjithë mend burreca me ty. Po kur t'ia ngrenë leckat Dyrriit ndonjë ditë, ç'do të bësh ti? e pyeta dhe e pashë që i dogji shumë. Nejsë...

Kujtimi heshti sepse erdhi kamerieri dhe ne morëm kafe me ujë Gline. Ai vazhdonte të ndriste i tëri. Dukej që dëshironte të tregonte diçka shumë të këndshme për të dhe kjo e bënte mjaft tërheqës. Më vështronte me ca sy rrezëllitës që më nxitën t'i thosha:

— Po hë, trego, se më plase!

Ai qeshi me plot gojën.

— E di ti, — më tha, — që Natalia ka fjetur një natë me mua?

— Me ty?!

M'u duk gjëja më e pabesueshme.

— E, me mua, — vazhdoi Kujtim Sauku gjithë bindje. — Dhe më e bukura, më erdhi vetë në shtëpi. Ja, kështu si ty. Gjoja se kishte një porosi për motrën time të madhe. Pastaj e lamë në mbrëmje vonë në shtëpinë e saj... — Ai heshti një çast dhe më shkeli syrin. — E, ke qejf ta tregoj? — më pyeti. — Ka qenë një natë e fortë shumë.

— Lëre, — i thashë, — s'është e vështirë ta marr me mend, — dhe u ngrita.

— Mirë, — tha Kujtimi duke u ngritur edhe ai, — por a bindesh se çfarë rasti ke humbur?

Qesha, por Kujtimit nuk i thashë asgjë. I dhashë dorën dhe u largova me njëfarë pezmatimi. Ja, thashë me vete, Natali Hajredini e paska gjetur një dëshmitar. Dhe me çfarë çmimi!

«Po të më pyesnin se çfarë urreja më shumë në jetë, do të përgjigjesha pa u menduar asnjë çast: zhgënjimin», — kishte thënë një mbrëmje Valentina e bukur, kushërira e Ketit, gruas së tim vëllai. Ajo qe ndarë nga burri për ca arsye të ngatërruara (që unë s'i mora vesh as atë natë e asnjëherë) dhe po i ankohej Astritit për të shoqin, për njerëzit e tij, për gjithë fisin e tyre. Kishin dashur ta nënshtronin, ta bënin të mendonte, të fliste, të sillej e të jetonte si ata. Mirëpo këtë nuk kishin mundur ta arrinin. Atëherë çfarë s'kishin punuar për t'i ndarë, vite me radhë. Dhe i kishin ndarë, magjithëse me një vajzë dhjetëvjeçare e një djalë pesëvjeçar.

«Oh, Astrit, — kishte vazhduar Vali atë

mbrëmje, — është e çuditshme, por unë i durova të gjitha: edhe shpifjet që më kurdisën, edhe ndërhyrjet e tyre të ulëta në gjykatë e në qendrën time të punës, edhe poshtërsitë që bënë në ndarjen e plaçkave. Dhe për asgjë nuk më erdhi keq, sepse fitova fëmijët dhe shtëpinë, fitova jetën. Vetëm një gjë nuk ia kam falur dhe nuk do t'ia fal kurrë vetes: zhgënjimin nga ai që unë e quaja njeriun tim... Oh, më vjen keq për veten dhe keqardhja për vetveten qenka e padurueshme... Mendoj shpesh: si jetova aq vjet me atë burrë pa e njohur cili ishte? Si isha ngopur aq shumë me hipokrizinë e tij sa të mos merrja vesh asgjë ç'bëhej rreth meje? E tmerrshme! Isha kënaqur me ca përkëdhelje të vogla që tani më duken idiotësira, kisha notuar mbi një gënjeshtër të neveritshme familjare një jetë të tërë që tani më bën ta ha veten me dhëmbë nga inati... Ja, këtë urrej unë më shumë se çdo gjë...»

Po mua pse m'u kujtua kjo histori? Mos ishin ato fjalët pa kuptim që po më thoshte Donika apo ato lëvizjet e saj si të përgjumura që më sillnin në mendje atë zhgënjimin e hatashëm të Valentinës së bukur, kushërirës së gruas së tim vëllai? Nuk e di. Por Donika, ashtu si e lodhur e si e mërzhitur, nuk po më pëlqente; nuk po më dukej si Donika që njihja unë. I thashë të më jepte një gotë raki dhe të më bënte një kafe, më tepër për ta parë se si do të m'i sillte. Ajo bëri një «uf» të mërzhitur, mori shishen në bufe dhe e vuri

mbi tavolinën e mesit. Pastaj mori një gotë të vogël po në bufe dhe e vuri edhe atë pranë shishes. Ma la ta hidhja vetë dhe shkoi gjithë përtesë në aneks. Ishin veprime që më thoshin hapur: «Uf, edhe ti ç'kërkon! Ku e kemi hallin ne dhe ku ti! Si je kaq i qetë, xhanëm?!»

I qetë isha vërtet. Thonë se të fejuarit nuk shohin as me sytë e ballit e as me sytë e mendjes. Atyre u sheh e u ndien vetëm zemra. Kurse mua jo. Mua më shihnin mirë edhe sytë e ballit, edhe ata të mendjes. Ja, për shembull, Donika ma la shishen e rakisë dhe gotën mbi tavolinë, jo për të hedhur vetë sa të dua, por për të më dhënë të nënkuptoj se s'duhet të pi fare. Kafënë e la të derdhet pak, jo sepse e harroi mbi furnelë, por për të më treguar mua një përkujdesje jo aq të madhe. Edhe filxhanin nuk e vuri mbi pjatë, por drejt e mbi syprinën e tryezës. Çudi, thashë me vete. Do të isha zemëruar po të ma bënte më parë këtë gjë. Do t'i kisha thënë që s'ishte e dashur, s'ishte e sjellshme, që s'ishte si një e fejuar me mua dhe do të kisha ikur gjithë mëri. Kurse këtë pasdite të vonë isha vërtet shumë i qetë.

— Eja, — i thashë, — eja ulu këtu, pranë meje, se më ka marrë malli.

— Uf! — bëri prapë Donika, megjithëse erdhi e u ul si e detyruar.

Nuk i thashë gjë. I buzëqesha ashtu kot dhe i vura dorën nën flokë.

— Oh! — bëri ajo dhe u ngrit. — Më lër njëherë, më lër të flas!



— Fol, — i thashë dhe u mundova t'i jepja fytyrës një pamje mjaft të habitur e naive, si t'i thosha: «Pse, të kam ndaluar unë ty ndonjëherë të flasësh?!» Por ajo nuk tha gjë. U përkul pak dhe më mbushi gotën me raki. Me këtë tregonte se po e kuptonte që duhej të ishte pak më e sjellshme. Kjo më pëlqeu dhe desha t'ia thosha, por në korridor u ndien zërat e babait dhe të nënës së Donikës. Ata hynë në kuzhinë pa na përshëndetur, megjithëse na panë ne në dhomën e pritjes. Nuk më erdhi mirë.

— Ç'kanë këta? — e pyeta Donikën.

Ajo ngriti supet dhe shkoi tek ata, në kuzhinë. Mbete vetëm. As për këtë nuk më erdhi mirë. E piva rakinë me fund dhe ndeza një cigare. U rregullova në divan dhe nuk e di sa prita ashtu, sepse edhe cigaren e kisha mbaruar me kohë. Isha gati për t'u ngritur kur hyri Donika e më tha:

— Të kërkon pak babai.

Tani më erdhi vërtet inat. Ne nuk ishim mësuar kështu në shtëpi. Si më thërriste ai atje në kuzhinë pa më përshëndetur fare? Megjithatë, u ngrita dhe shkova.

— Urdhëro! — i thashë. — Si u ngrysët?

— Mirë, — tha ai dhe më tregoi me dorë vendin ku duhej të ulesha; përballë e nja një metër larg tij.

Nuk më pyeti as se si e kisha kaluar ditën, as ç'kisha bërë e ku kisha qenë. Më pyeti për atë gjë që unë e kisha vendosur një herë e mirë në vetvete. Por ja që të tjerët,

edhe ata, paskan të drejtë të pyeskan, bile, edhe të urdhëruakan. Ai më tha:

— Përse nuk futesh në atë punën që të ka gjetur Liliana?

Ngrita vetullat lart dhe rrudha buzët.

— Ja, ashtu... — i thashë, sepse nuk doja grindje me të, por nuk doja të jepja as shpjegime për gjëra që më përkisnin vetëm mua.

— Si ashtu?! — u habit ai.

— Ashtu, — përsërita.

Ai lëvizi në divan duke shfryrë. U zgjat, mori cigare mbi tavolinën e aneksit dhe, si e ndezi vetëm për vete, tha:

— Nuk janë të mira këto gjëra, djalë. Nuk je në rregull kështu.

Në çast vendosa të ngrihesha e të mos e dëgjoja më. Nuk kishte fjalë që më nervozonte më shumë se ajo «djalë», s'e duroja dot. M'u duk vetja më i përçmuari, më i poshtëruari, aq sa nuk isha në gjendje as për ta dëgjuar e as për të folur. Megjithatë, nuk e di ç'më mbajti e s'më la t'i thosha: «Mos më thuaj djalë!» Ndoshta mendimi që ai vërtet më kishte si djalin e tij, derisa më kishte dhëndërr.

— Dëgjo, — tha, — unë kështu e kam të folurën, por kjo e folura ime mirë të bën, jo keq. Për atë proçkë që bëre ti, tek unë duhej të vije më parë, se më ke në këmbë të babait tënd. Të vije e të më thoshe kështu e kështu, që ta dija dhe unë ç'të bënim. Mirë që s'erdhe, po tani nuk dashke as

të hysh në punë tjetër. Pse, kështu do ta ngresh familjen ti? Aha, ik që nesër e fillo punë atje ku të thotë Liliana, ndryshe i kemi të tjera llafet!

Kaq tha, si t'i kishte mësuar të gjitha përmendsh. U ngrit, shkoi në korridor dhe i foli së bijës:

— Do dalësh ti, moj?

— Po, baba, — tha Donika dhe vështroi nga unë.

E hapa vetë derën. Nuk desha t'u thosha as «natën e mirë», por sesi ma shkëputi pa dashje nga goja ajo koka e nënës së Donikës që tundej plot keqardhje.

Në rrugë isha aq i mërziur, sa nuk i thashë Donikës as se ku do të shkonim. Besoja se në shtëpinë time nuk do të gjeja njeri dhe atje do t'ia thosha nja dy fjalë së fejuarës sime. E ndieja që do t'i kisha ca punë me të në të ardhmen. Të paktën ajo ta merrte vesh kush isha e t'i mësonte disa gjëra që unë nuk i kisha qejf, dhe t'i mësonte qysh tani sa s'ishte vonë. Mirë ai, i ati, aq dinte dhe aq bënte. Po kjo, — thosha me vete, — kjo që është e fejuara ime, shoqja ime që më kupton drejt, përse i lejon të tjerët, qoftë edhe babanë e saj, të përzihen në punë që më përkasin vetëm mua? Sepse, unë e dija mirë që jeta e njeriut nuk mund të ishte vetëm fushë me lule. Mund të kishte edhe halle, edhe shqetësime, edhe trille të njërit apo të tjetrit. Dhe kur ky, vjehëri im, ndërhynte që tani në mënyrë aq të vrazhdë, po nesër

ç'mund të bënte? Me siguri që, pak nga pak, do të niste të na bënte edhe hesapin e shtëpisë dhe do të na mësonte se ç'duhej të harrin në drekë apo në darkë... Pastaj, ai më qortonte pikërisht tani që unë kisha më shumë nevojë për përkrahje. Sikur të gjithë njerëzit e mi të flisnin si ky, ç'do të bëja vallë?

Këto mendoja t'i thosha edhe Donikës kur të arrinim në shtëpinë e vëllait tim që në atë orë unë e besoja pa njeri.

Por në shtëpi ishin plot njerëz. Ishte një festë që unë e kisha harruar, megjithëse nuk do ta mbaja mend edhe sikur të ma kishin thënë në mëngjesin e asaj dite. Djali i vogël i Astritit mbushte dy vjeç!

— Pretekst, Alfred, — tha vetë Astriti. — Nuk e di ti që njerëzit kërkojnë gjithmonë pretekste për të kënaqur në mënyrë pak të natyrshme dëshirat e tyre? — Ai m'u afrua më pranë dhe më pëshpëriti: — Për këtë të sotmen u bë shkak Sadetja. Lavdimin e emëruan prapë drejtor në një vend pak më të ulët se në ministri, por jo më pak të mirë. E qartë, besoj... Hë tani, zini vend edhe ju!

Ne u ulëm midis Lavdimit dhe Ketit. Morëm përpara gotat me verë dhe pjatat me

mish pule e ia nisëm edhe ne me urimet. Djalë të bëhej njëqind vjeç! Edhe njëqind vjeç! Ha, ha! Domethënë njëqind e dy! Ha, ha! T'i ngjajë babit! Të bëhet i mençur si babi! T'i ngjajë mami! Të bëhet i bukur si mami! Të bëhet punëtor, i urtë si mami! Oh, po-si, është shumë e urtë kjo! Pse, nuk jam?! Ah, edhe këtë ma mohove?!... Dhe kështu, këto fjalë e të qeshura, ma hoqën në çast atë mërzi të që kisha ndër gjatë gjithë rrugës e që më qe shtuar ca më tepër kur pashë në shtëpi gjithë ata njerëz. Ia njihja vetes këtë: mund të isha i mërziur apo i hidhëruar dhe të bëhesha në çast i gëzuar nga hareja e të tjerëve. Shkurt, siç më thoshte im vëlla, isha «karakter i thjeshtë, shumë pranë natyrës»; aty mund të qaja e aty mund të qeshja. Nuk e di nëse ishte tamam kështu, por ato që thoshte Astriti unë i besoj, sidomos nga mënyra se si thuheshin e kur thuheshin. Edhe këtë mbrëmje qenë pikërisht fjalët e tij që më sollën një çlirim të menjëhershëm, aq sa fillova të qeshja me zë edhe për gjëra që në një rast tjetër nuk do të më bënin as të vija buzën në gaz. Isha, pra, krejt i kënaqur nga ky çlirim, kur dëgjova Sade-ten të më pyeste për punën. I thashë se mirë ia kaloja, por, me sa duket, ajo kapi diçka në fytyrën e Donikës dhe nguli këmbë:

— Çfarë ke që m'i hap sytë ashtu? — më pyeti. — Apo s'më more vesh?

Dikush qeshi, pastaj u bë heshtje e plotë dhe unë e ndjeva veten ngushtë. Veç Sade-

tes e Lavdimit, të gjithë e dinin se nuk isha më në atë punë. Vështrova Astritin.

— Thuaji që të kanë pushuar nga puna, — tha ai dhe mori gotën e rakisë për të bërë një «hajt, gëzuar» me tavolinën.

Por kjo nuk e zbuti fare morinë e pyetjeve të Sadetes. Kush më kishte pushuar? Përse? Kur? Pse nuk i kisha treguar asaj? Pse nuk isha ankuar? Pse nuk e kisha kapur për gryke Dyrrin? Dhe kështu, pa pasur nevojë të dëgjonte hollësi, filloi breshëria e sharjeve: «Pa shih, shih edhe Dyrr Dema! Po ai maskara ka ngrënë e ka pirë në shtëpinë tonë! Po ai plak matuf vinte si pulë, si skile e ngordhur kur kërkonte Lavdimin! Po ai servil ishte gati t'i puthte këmbët këtij, sa ishte në ministri! Apo kujtoi se iku ky dhe vdiqëm ne. Ka vdekur për vete me kohë ngordhësira... Po s'ka faj ai jo, kanë faj ata që e mbajnë atë delenxhi... S'e di ai se unë i shkoj mu atje në zyrë dhe i them ca fjalë që të dridhet edhe në shtëpi tek e shoqja. Unë...»

Mirë, mirë. Astriti dhe Lavdimi e qetësuam. Në atë çast ajo i shkante vërtet Dyrr Demës në zyrë e mbase edhe në shtëpi. Ishte e papërmbajtshme, por nuk i zgjaste shumë. Edhe tani aq e pati. Filloi të dëgjonte Donikën, që nisi t'i tregonte si e qysh kishte ngjarë. Pastaj, s'di se si e nxori te puna që më kishte gjetur Liliانا dhe Sadetja tha:

— Shumë mirë, aty të futet dhe të mos çajë kokë hiç... Po prit, — ajo u kthye nga

i shoqi. — Pse nuk e merr ti në ndërmarrjen tënde?

Lavdimi qeshi me një mimikë shumë të guditur.

— Po pse, moj, — tha, — mos kërkoi ky punë tek unë dhe unë i thashë që s'të marr?!

Por Sadetja nuk të linte vend për arsye-time. Një mendim të sajën ajo e çonte deri në fund, pa dëgjuar njeri tjetër.

— Mirë, o, mirë, — tha. — Merre vëllanë në punë dhe mos e zgjat! Merre qysh nesër! Do ta marrësh nesër apo jo?

Lavdimi ia plasi të qeshurit. Qeshëm të gjithë me furinë e Sadetes. Unë qesha kot, sepse e dija që të gjitha ato që thoshte ajo ishin pa vlerë. Megjithatë, ajo priste përgjigje nga i shoqi me një këmbëngulje komike, por tepër të vendosur.

— Epo, prit njëherë të pimë një gotë, — tha Lavdimi, — se s'ka për ta lënë njeri pa punë tët vëlla.

— Ashtu! — u gëzua Sadetja dhe iu hodh në qafë si kalama. — Po nesër, ama, hë?

Plasën prapë të qeshurat dhe midis tyre Donika tha:

— Edhe në atë punën që i gjeti Liliana ashtu i thanë, të vijë të fillojë qysh nesër, por ky nuk do.

Kjo është pjesa më e bezdisshme për t'u përshkruar. Një herë, pati një «përse» të përgjithshme, së cilës Donika iu përgjigj: «Jo se nuk i pëlqen puna që do të bëjë atje, por do të kërkojë të drejtën e vet. Do që të kthe-

het prapë aty ku ishte.» Në thelb, kjo që krejt e vërteta, por mua më erdhi inat me Donikën. Ajo e dinte se unë e kisha vendosur se ç'do të bëja dhe përsëri e hapi këtë avaz. M'u kujtuan fjalët e të atit dhe kjo më nervozoi më shumë, aq sa u mata të ngrihesha e t'u thosha të gjithëve të më linin rehat, se i dija vetë punët e mia. Por nuk thashë asgjë. Dëgjova me radhë mendimin e Sadetes që tha të filloja një punë tjetër, por të nesërmen e asaj dite që do të punoja në ndërmarrjen e re, t'i shkoja në zyrë Dyrr Demës e t'ia përplasja nja dy fjalë surratit. Dëgjova Lavdimin që më tha se nuk do të fitoja kushedi se çfarë po të kërkoja të drejtën, prapë punëtor do të isha. Ndërsa në një ndërmarrje tjetër do të kisha mundësi më të mira se në një vend ku, dashje pa dashje, i kisha disa njerëz që s'më donin. Megjithatë, i thashë Lavdimit, të shumtët më donin në atë ndërmarrje dhe unë isha nga ata njerëz që nuk kisha dëshirë të bridhja sa në njërën punë në tjetrën. Pastaj dëgjova edhe Ketin, që, në përgjithësi, ishte në një mendje me Lavdimin. Kurse im vëlla tha:

— Nuk duhet të tërhiqet nga kjo që ka nisur. Ta kërkojë të drejtën e vet. Sepse, në qoftë se ikën në një punë tjetër, do të thotë se ka frikë të ndeshet me ata që e pushtuan. Po të ketë frikë të ndeshet, do të thotë se e ndien veten fajtor dhe se u jep të drejtë atyre. Po të shkojë në një punë tjetër vetëm se ka këta interesa që i thoni ju, do të



tregohet njeri i ngushtë, i vogël. Por, po të tregohet i vogël, të mos harrojë që faji këtij do t'i mbesë i shkruar në librezën e punës për tërë jetën. Dhe, po të mbeti për tërë jetën i shkruar një faj që ti nuk ia njeh vetes, mund të vijë një ditë që ky faj të bëhet tepër i hidhur për ty. Atëherë do të pendohesh dhe do të të vijë keq që dikur nuk ke bërë si të kanë thënë mendja dhe zemra jote, por ke dëgjuar të tjerët. Prandaj ky të veprojë ashtu siç e ndien dhe e mendon vetë.

Ai nuk iu drejtua asnjërit kur foli e në të njëjtën kohë, si gjithmonë, iu drejtua të gjithëve. Dhe m'u duk se te të gjithë bënë përshtypje fjalët e tij.

Ndërsa për mua ato ishin si mbështetja e një aleati të fortë që t'i nxit e t'i përtërin energjitë që kanë nisur të të lënë. Dhe unë për këtë kisha nevojë më shumë se për çdo gjë tjetër: për një mbështetje që të mos më dukej vetja i braktisur dhe i vetmuar siç më qe dukur gjatë rrugës. Veç kësaj, më dukej, si të thuash, edhe një lloj përkthimi me fjalë bindëse për të tjerët i asaj që ndieja e që kisha vendosur ta çoja deri në fund. Dhe, me sa dukej, këtë e kishte kuptuar dhe e kishte kryer mjaft mirë im vëlla, sepse, pas fjalëve të tij, të gjithë morën gotat dhe e tokën me mua.

— Gëzuar!

Nuk më besuan plotësisht në Komitetin e Bashkimeve Profesionale të Rrethit. Nuk dija as unë të shpjegohesha mirë. Megjithatë, më dhanë një pjesë të drejte. Burri që më priti, një njeri i shkurtër e i shëndoshë, si nja dyzet vjeç, ma shoi në çast vrullin që më kishin nxitur fjalët e Astritit. Pata pjërshtypjen se i kisha shtuar një bezdi më shumë kur më tregoi vendin ku të ulesha pa më thënë asnjë fjalë, veç një «hë-je» të zgjatur. Por, në të vërtetë, faji ishte imi. Kisha thënë gjëra që nuk lidheshin shumë me rastin konkret, me incidentin në stacionin e trenit, siç e quajti nëpunësi i bashkimeve profesionale. Edhe në qoftë se ato që thashë ishin të vërteta, unë duhej të shkoja në Komitetin e

Partisë të Rrethit, jo këtu. Sa për pushimin nga puna, që ai t'i përcaktonte saktë gjërat, duhej t'u përgjigjesha këtyre pyetjeve:

— A ishim vërtet ne (unë dhe e fejuara ime, si drejtues të organizatës së rinisë) nis-mëtarët e këtij ekskursioni?

— A kishte njerëz të jashtëm në ekskur-sion?

— A më kishte siguruar përgjegjësi i re-partit për vendet në tren dhe në autobus?

— Po unë vetë a mendoja se mund të zgjidhej ndryshe ajo që unë quaja padrejtësi, provokim të paramenduar?

— Cili ishte kryetari i bashkimeve pro-fesionale të ndërmarrjes dhe kush e drejton-te mbledhjen?

— U mbajt protokoll për këtë mbledhje?

— Kërkova unë një mbledhje tjetër nga bashkimet profesionale të ndërmarrjes?

— Dhe, a e ndieja veten sadopak fajtor?

Iu përgjigja këtyre pyetjeve me radhë, pak a shumë ashtu siç i kam treguar, por shumë më shkurt. Tetë pyetjeve që më bë-ri ai u dhashë gjashtë përgjigje pohuese dhe dy mohuese. Që nuk u isha drejtuar ba-shkimeve profesionale të ndërmarrjes, megjithëse kryetari i saj që njeri i mefshtë, kisha bërë gabim. Ai i shënoi të gjitha, me një dy-shim të hapur. Nuk mund të ndodhte kështu. Sidoqoftë, ata nuk kishin të drejtë të më pu-shonin nga puna. Këtë e thoshte me bindje. Nuk ishte në kompetencat e ndërmarrjes. Po të kisha thyer disiplinën në punë, po të

kisha braktisur punën, po të isha grindur di-  
sa herë në punë dhe kjo ta kishte dëmtuar  
punën, atëherë po, mund të më pushonin.  
Por jo në këtë rast. Nejse. Çështjen do ta  
shikonin qysh atë ditë. Të pasnesërmen, në  
po atë orë dhe në po atë zyrë do të paraqi-  
tesha për të marrë përgjigjen.

— Kështu?

— Kështu.

Ka ditë që mbeten në kujtesë për gëzimin apo hidhërimin e madh që të sjellin. Të tilla kisha pasur edhe unë, sidomos kur më kishte vdekur babai në duar dhe më vonë nëna (e mira nënë që e gjetëm të nesërmen në mëngjes të mbaruar, pa shqetësuar asnjëri, goftë edhe për një gotë ujë). Po nuk më kishte shkuar në mendje që të kishte edhe ditë fare të zbrazëta, me një kohë që s'ke ç'ta bësh dhe me një hapësirë ku rrugët s'të shpien asgjëkund...

Kisha dalë herët nga shtëpia, me një qëllim të prerë për të kryer disa punë. Do të shkoja në ndërmarrje dhe do t'i thosha Dyr Demës që Komiteti Ekzekutiv kishte urdhëruar të vazhdoja punën në pallat dhe do të merrja apartament sipas rregullave; në mos

unë, e fejuara ime. Kuptohet, mund të kthehesha prapë në Komitetin Ekzekutiv, sepse Dyrri mund të më përcillte duke më thënë se puna e pallatit do të zgjidhej vetëm në qoftë se do zgjidhej ndryshe edhe pushimi im ose diçka të ngjashme. Siç më kishte thënë Donika, një ditë më parë ai kishte folur prapë keq për mua, kur kishte marrë vesh se unë po e ndiqja çështjen. Kishte thënë edhe se kot sorollatesha, sepse s'kisha për të nxjerrë gjë. Por kishte folur pa bindje, sepse i kishin dalë të tjera andralla dhe nuk ma kishte ngenë mua... Pastaj do të më duhej të kaloja përsëri nga Bashkimet Profesionale për të marrë vesh se ç'po bëhej me punën time. Dhe, më në fund, po të ishte se edhe këtu nuk po bëhej gjë, do të merrja rrugën e Komitetit të Partisë. Po askund nuk më shkohej. Edhe dielli i ngrohtë i pranverës, edhe era e luleve të blirit nuk më nxisnin për asgjë. Bile edhe era e mirë e dorëzonjave që vareshin në muret e një shtëpie, më erdhi e keqe, e rëndë, si e përzier me diçka të palarë. Atëherë, duke menduar për këtë gjendje të pakëndshme, nisa të kuptoja arsyet që më sillnin atë lloj pezmatimi nervozues. Kisha dashur të bëja diçka që e quaja të drejtë e të ndershme, por jo të gjithë njerëzit e mi e kishin kuptuar si unë. Bile ndonjë e pati treguar hapur pakënaqësinë. (Nuk më hiqeshin nga mendja fjalët e babait të Donikës, me atë tonin kërcënues dhe fyes.) Kisha shkuar gjithë qejf në një zyrë, i bin-

dur që atje do të më prisnin me habi, por atje gjeta më tepër dyshim dhe zvarrisje. (Nëpunësi i Bashkimeve Profesionale të Rrethit e kishte shtyrë edhe një javë përgjigjen, sepse i kishin dalë disa «çështje»)... Përse vallë, pyesja veten, të ketë qëndrime kaq të ndryshme nga njerëz që janë rritur në kushte pothuajse të njëjta?... Nuk e di sa herë e rrotullova nëpër mendje këtë pyetje dhe, meqë nuk i gjeta kurrfarë përgjigjeje, ndjeva të më pushtonte një bezdi në gjithë trupin. Për çudi, më bëhej të hiqja xhakëtën e ta flakja si një gjë të mërzitshme bashkë me këpucët që më vrisnin, megjithëse nuk ishin të reja. Më pas, më përpiu një dëshirë e marrë për të blerë një shishe të tërë me konjak e për ta pirë me fund. Ndërsa më pas akoma, nisa t'i vështroja njerëzit në rrugë në një mënyrë të tillë si të kërkoja sherr me cilindo...

Nuk më kujtohet nëse po mendoja më ndonjë nga këto kotësitë, kur një makinë më ndaloi aq pranë, sa më preku pak kofshën e majtë.

— Ej, Fred, — thirri një zë që, edhe pse i njohur, nuk do të ma ketë ndryshuar fare shprehjen e fytyrës.

Lirim Tirana zbriti nga makina, i erdhi rrotull asaj dhe më zuri nga krahu.

— Ç'ke kështu ti? — më pyeti.

— Hiç, jam bosh, — i thashë në mënyrë krejt të pavetëdijshme.

— E ore, burrë i dheut, se nuk u përmbys bota që e lëshon veten kaq shumë!

Hajde me mua, — tha, — se ta mbush unë atë boshllëkun tënd.

Çudi! Pse po i dukem se e kam lëshuar veten? — mendova dhe nisa t'i thosha diçka për ta kundërshtuar, por ai më tërhoqi drejt makinës, pa më lënë të shpjegohesha. Ishte një veturë e bukur në ngjyrë qumështi dhe me forma moderne, një PEUGEOT-504, nga të parat që kishin ardhur në vendin tonë. Lirimi i futi marshin dhe, si për të gëzuar një fëmijë qejfprishur, mori me shpejtësi e duke i rënë borisë për nga rruga e Durrësit. Derisa dolëm te serrat me ngrohje, nuk folëm. Aty Lirimi më pyeti për makinën.

— E, si të duket?

Më bëri përshtypje qëndrimi i tij. Sa herë takoheshim, ai më pyeste a kisha qenë në Ndihmën Juridike, ç'më kishin thënë atje; a kisha qenë në Komitetin Ekzekutiv, në Bashkimet Profesionale, ç'më kishin thënë atje... Dhe ai ishte në dijeni të gjithçkaje. Edhe pse një çast që lëkundur, Lirimi vazhdonte të më nxiste ta çoja deri në fund atë që kisha nisur.

— Shumë e mirë, — i thashë, — veturë luksi.

Ai qeshi i kënaqur dhe shtoi shpejtësinë. Makina mori një vrull plot përkëdheli, duke na krijuar një ndjesi mjaft të butë në shpinë.

— Dhe është me njëqind e tridhjetë në orë, ë? — tha Lirimi duke e ngadalësuar shpejtësinë, sepse në krye të një kthese u duk një karrocë me bar të njomë.



— E ku po shkojmë, njëherë? — e pyeta dhe u ktheva pak nga ai. Lirimi vuri gishtin në buzë dhe bëri «shët».

— Mos më pyet, — tha. — Unë kam detyrat e mia. Pas detyrave, kam edhe pak kohë të lirë sa për të ta hequr ty atë biçim zymtie. — Dhe buzëqeshi duke më shkelur syrin e duke shtuar prapë shpejtësinë.

Nuk e di, qe natyra e tij e mirë, fjalët e tij kureshtare apo ajo lëvizje e shpejtë që më bënë të ndihesha krejt i lehtësuar. Vështroja peizazhin e thyer në qindra ara, që e ndërronin ngjyrën nga e blerta e çelur deri tek e kafta e errët dhe kisha qejf të heshtja. Nuk kisha udhëtuar ndonjëherë në mënyrë kaq të rehatshme dhe, me siguri, po të mos më fliste Lirimi, shpejt do të më zinte gjumi në ndenjësën e butë me shpinë të lartë, ku mund të mbështesje edhe kokën.

— Pse ishe aq i mërzhitur, Fred? — më pyeti ai. — Si po të shkojnë punët?

— Keq, — i thashë.

— Ashtu? Po mirë, atëherë, shko në atë ndërmarrjen që të ka gjetur Liliana.

Bëra një «lëre» me dorë dhe heshta.

Ishte natyra e vërtetë e Lirimit që fliste ashtu. Ai nuk duronte që të tjerët të vuanin, të shqetësoheshin dhe kërkonte rrugët më praktike të zgjidhjes. Kur mori vesh pushimin tim, qe i pari që më mësoi ç'të bëja; kur pa se njerëzit e grave tona donin një zgjidhje më të shpejtë, u bë edhe ai në një mendje me ta...

Në çast u binda se tërë shqetësimi i asaj dite më kishte ardhur pikërisht nga fjalët e tim vjehrrri që më kishte bërë ta ndieja veten padashur të vogël, të pazotin, të përbuzur dhe të padenjë për atë që doja të bëja... Kisha filluar të mendoja ca gjëra që më parë s'i kisha vënë re as te vetja dhe as te të tjerët, dhe më vinte mirë. Por Lirimit i thashë krejt tjetër gjë. Ai buzëqeshi.

— Nuk më pëlqen kur më flet ashtu, — i thashë për vjehrrin tonë. — Më duket sikur shtiret si burrë me mend dhe parimor i madh.

— Jo, nuk shtiret, — tha, — ashtu mendon vërtet. Pastaj, ata njëloj flasin të gjithë, në mënyrë të prerë, që s'të lënë shteg për diskutime. Ti s'ke vënë re vëllezërit e grave tona, sidomos të voglin, që njeh vetëm kokën e tij. Më e urta është Liliana, megjithëse edhe ajo, pak po ta prekësh në interesat e saj, bëhet tepër zevzeke. Kurse Donika jote është shpatë fare.

— Donika?!

— E. Çuditësh? Asaj, t'i thuash një fjalë, pesë të kthen... — Ai frenoi, mori një kthesë dhe, si drejtoi makinën, vazhdoi: — Apo me ty nuk flet? Nuk ta kthen ty?

— S'e kam vënë re, — i thashë. — Mua më duket se ajo mendon si unë. Ndoshta prandaj nuk ka edhe ç'të më kthejë.

— Ah, atëherë, bravo të dyve! — tha ai dhe shtoi shpejtësinë.

Kishim hyrë në Durrës pa e ndier fare

rrugën. Lirimi e ndaloi makinën përpara Komitetit të Partisë. Zbriti dhe më tha ta prisja në makinë ose te kafeneja aty pranë, sepse do të vonohej ca. Por nuk u vonua aq shumë. U nis pa më thënë asnjë fjalë dhe, vetëm kur ndalua prapë te hotel «Adriatiku» buzë detit, më tha ta prisja edhe ca kohë. Por këtu do t'u thoshte të më bënin një kafe speciale, që të mos mërzhitesha duke vështruar detin dhe kafeja të më mbetej gjithë ditën në gojë. Erdhi, më në fund, i qeshur në fytyrë dhe më tha:

— Tani do të merrem me atë boshllëkun tënd.

Gomat e makinës fishkëllyen nga nisja e shpejtë dhe kjo më dha një hare të vetvetishme. Vetura mori prapë andej nga kishim ardhur dhe te sheshi «Mujo Ulqinaku» bëri një kthesë të fundit. Vetëm kur ndalua në lokalin e Currilave, kuptova se ku po më shpinte. Aty ishte vërtet shumë bukur.

Me sa dukej, Lirimi qe bërë mik me të gjithë njerëzit e shërbimit. I pari e përqafoi përgjegjësi i sektorit që porositi menjëherë kafetë. E përqafoan edhe dy djem të rinj, njëri kuzhinier dhe tjetri peshkatar. E përqafoi dhe u ul me ne për pak kohë edhe kamerieri. Mua vetëm sa më dhanë dorën dhe më buzëqeshën. Ata flisnin me Lirimin duke kujtuar emra e copëza historish që unë nuk arrija t'u bëja një lidhje, sepse gjithmonë mungonte diçka ose nga fillimi ose nga fundi. Por, qeshnin ata, qeshja edhe unë. Më

vonë, shumë më vonë, m'u kujtua që Lirimi e kalonte pothuajse çdo verë në plazhin e Currilave.

Në një çast Lirimi më njohu me ta si një punëtor që më kishin pushuar nga puna dhe rrija ashtu i mërzhitur, ngaqë akoma s'ishte vendosur se ç'do të bëhej me mua. Ata mbe-tën pak kohë në heshtje, derisa peshkatari, që m'u duk se që më i çudituri nga kjo gjë, thirri: Hajt se do të rregullohet! Dhe u gja-llëruan përsëri. Nuk vonoi shumë dhe tavo-lina u mbush me peshq të skuqur e me verë. Gjithë ato lloje peshqish më bënë të ndieja një si druajtje a si turp, që e provojmë zako-nisht kur na dhurojnë me bujari diçka që s'e meritojmë plotësisht. Kishte aty karkale-ca të zgjedhur, më i vogli sa gishti i madh i dorës. Kishte bërçolla a biftekë dentali. Kishte një lloj tjetër karkaleci që ata i tho-shin «gambero rotondo» dhe që e kishte mi-shin të fortë e të ëmbël. Kjo ishte gjëja më e rrallë edhe për peshkatarin që ishte rritur në det. Kurse për mua, të gjitha ishin aq të rralla, sa nuk dija vërtet çfarë të haja më parë, të paktën sa për t'ua ditur shijen të gjithëve.

— Po të mësohesh me gjërat e mira të detit, s'të bie fare në mendje se ç'mban toka, — tha Lirimi.

E besova, megjithëse «gjëra të mira të detit» për mua ishin vetëm këta peshq, kur-se ato të tokës i dija të pafundme.

Ndenjëm shumë aty, derisa pamë edhe

një perëndim madhështor të diellit. Ai dukej aq pranë detit, sa të krijonte përshtypjen e një tepsie të përflakur me diametër nja dy metra, që po zhytej ngadalë dhe në sytë tanë në thellësitë e një deti krejt të palëvizshëm, gati të ngrirë.

Para se të çoheshim, u bë zhurmë e madhe për të paguar. Në çast m'u kujtua mbrëmja të «Drini» me Dyr Demën dhe krahasimet u bënë vetvetiu. Ata kishin një ditë dhe një orë të caktuar kur mblidheshin, këtu Lirimi kishte ardhur vetëm sepse e kishte marrë malli për miqtë e tij. Atje paguanin të gjithë me radhë, me përjashtim të Dyrri që «paguante» vetëm me nderin e pranisë së tij, këtu Lirimi arriti më në fund t'u mbushte mendjen që, të paktën, të paguante kafetë për të gjithë. Atje fliste vetëm Dyrri dhe vetëm ai kishte të drejtë të ngacmonte të tjerët, këtu ngacmoheshin të gjithë midis tyre, ndaj edhe të qeshurat ishin të zhurmshme e të gjithanshme. Atje njerëzit përgjoheshin sipas një liste të caktuar, këtu përmendeshin miq të dashur. Atje mbrëmja mbaronte si një komplot i pabesë ndaj atyre që s'ishin të pranishëm, këtu me dëshirën për t'u mbledhur edhe një herë të gjithë bashkë, si në Porto-Romano... 'Atje..., këtu...

Nuk dëshiroja të kuptoja asgjë. Dëshiroja vetëm të shijoja atë dehjen e lehtë që ndjeva kur u nisëm nga Durrësi. Nuk ishte një dehje nga vera, por nga një qetësi e madhe

që më mbushi tërë shpirtin dhe trupin ma vuri në një përgjumje të ëmbël.

Rrugës për në kthim Lirimi këndonte këngë tiranase dhe e ngiste shumë ngadalë makinën. Zbrazëtia dhe zyrtësia e mëngjesit të kësaj dite kishin mbetur si një kujtim i largët, si një «sa i mërzhitur kam qenë njëherë!»...

Duke pritur Lirimën të mbyllte makinën në garazhin e ministrisë, pashë një burrë që m'u duk si Dyrri Dema. Ndoshta m'u duk si ai, ngaqë e kishin vënë në mes dy djem që çuditërisht ngjanin edhe ata me Mësallin e Gentianin, ose ngaqë ngjitën shkallët e restorant «Drinit», ku ata e kishin bërë zakon të kalonin të shtunat. U mundova një çast të kujtoja në ç'ditë të javës ishim, por më kot. Në kokë më rrotullohej mendimi se shefat si Dyrri ishin jo vetëm të paaftë, por edhe të dëmshëm. Për ata ishte djalë i mirë dhe duhej përkrahur ai që ishte i bindur, i nënshtruar, lajkatar, ndërsa nuk përfillej, në mos po sulmohej, ai që ishte i talentuar, që nuk u bëhej urë trilleve të tyre, që ishte krenar për punën e tij dhe që dinte të mendonte me kokën e vet. Për shefa si Dyrri, një njeri si unë ishte i padëshirueshëm, e ndoshta

edhe më tepër se kaq. Po ai, vallë, a mund ta dinte ai se ç'ishte për ne?... Ishte një mendim që do të dëshiroja ta shprehja me zë të lartë dhe të kënaqesha duke e dëgjuar të shqiptuar nga zëri im, por as këtë nuk munda ta bëja, sepse erdhi Lirimi që më tregoi një pako të vogël dhe më tha:

— Bleva edhe pak peshk për darkë. Të hahet më?

— Më hahet, — i thashë, — bile sikur më ka marrë uria.

— Eh, është shumë i lehtë peshku, — tha ai dhe më futi krahun për të më tërhequr drejt shtëpisë së tij.

Aty Liliana na priste sikur ta dinte që kishim qenë bashkë.

— Erdhi Donika e të kërkoi qysh në drekë, — më tha ajo. — Kishte shkuar edhe te ti, por as atje nuk të kishte gjetur.

— Ishim bashkë në Durrës, — tha Lirimi.

— Oh, ku e gjetët sot edhe ju!

— Pse? Ç'ka ndodhur? — pyetëm ne gati njëherësh.

— Kanë pasur mbledhje ata sot, — tha Liliana. — I kanë lënë vetëm sa për të ngrënë drekë dhe akoma vazhdojnë. Kanë filluar që më tetë të mëngjesit. Kurse tani ora është tetë e mbrëmjes. Ç'bëjnë kaq gjatë xhanëm?!

Ne s'folëm. Unë ndeza një cigare dhe u ula në divan për të parë lajmet në televizor. Ishte e çuditshme, por ajo mbledhje se pse më dukej si pa rëndësi për mua. E dija që do të bëhej, bile qeshë fare i sigurt kur Do-

nika më tha para tri-katër ditësh që në ndërmarrje kishte shkuar edhe një grup kontrolli nga Komiteti i Partisë i Rrethit dhe ai i rajonit. Dhe, ishte e kuptueshme se, sido që ta vërtiste Dyr Dema, fare pa u lagur nuk do të dilte. Por unë as që doja të mendoja për këtë. Diçka tjetër kisha nisur të bluaja me vete që rrugës: Ata njerëz atje në lokalin e Currilave, që bënin shaka pa të keq me shoku-shokun, që pinin verë e hanin peshk përmes të qeshurave, ata njerëz plot zhurmë e aq të hapur në bisedë, më kujtuan se kisha qenë i druajtur. Dhe, sikur të mos kisha qenë i tillë, sikur të mos i kisha lënë ca gjëra që të më kalonin ja ashtu, siç i kam treguar, nuk do ta kisha parë veten në këtë ditë. Por, sido që të ishte (dhe kjo që tani gjëja më e rëndësishme për mua), gjithçka kishte mbaruar; ajo që pritej, duhej të rifillonte. Dhe, kur të rifillonte, do të ishte kështu: e hapur, e prerë, e drejtpërdrejtë, pa asnjë lloj druajtjeje, pa asnjë lloj lodhjeje e mundi. Atë që do ta shihja si jo të mirë, do të thosha se s'është e mirë para të gjithëve dhe që ta dëgjonin të gjithë, jo vetëm dikujt dhe kur rastësisht më jepej mundësia. Në qoftë se ndonjëherë kisha qenë sadopak i drejtë kur sytë më kishin parë gjëra të padrejta, tani do të bëhesha i vëmendshëm edhe kur sytë të më shihnin gjëra vetëm të dyshimta... Tani...

— Erdhi Donika, — tha Liliana dhe unë, kur e pashë që hyri e qeshur në dhomë, ku-



reshtjen për të ditur se ç'ishte thënë në atë mbledhje e pata të vetvetishme.

Fjalët e para që ajo tha, ishin këto:

— E shkarkuan Dyrr Demën! Dhe tani dëgjoni motivacionin:

Ajo nxori një copë letër dhe lexoi:

*«Ka vepruar si një burokrat prepotent dhe i prapambetur, ka shpërdoruar materiale jashtë kompetencave të tij, ka grumbulluar në ndërmmarrje njerëz të fafesisit dhe të miqve të tij, ka ngritur në përgjegjësi njerëz të paafte dhe ka qenë hakmarrës ndaj punëtorëve të ndershëm, ka përkrahur edhe ndonjë të deklasuar dhe ka mbajtur një qëndrim të dyshimtë moral me vartëset e tij.»*

— Gëzuar, pra! — tha Lirim Tirana dhe ngriti gotën e tij me verë.

— Prisni, prisni pak! — tha Liliana dhe atë çast vuri mbi tavolinë pjatat me peshk të skuqur, që lëshonin një erë mjaft ndjellëse.

Por mua as më hahej e as më pihej. Kundër çdo vullneti dhe krejt ndryshe nga ajo që kisha ndier një çast më parë, nuk më pritej të dëgjoja ç'ishte thënë në atë mbledhje, ku unë s'kisha pasur fatin të isha.

— Lëre, njëherë, të hajë pak peshk, se ka tërë ditën pa pushuar, — tha Liliana kur unë e nxita Donikën të tregonte.

Por as Donikës nuk i hahej, ndaj nisi të tregonte dhe me aq hollësi e rrjedhshmëri, sa unë nuk do ta kisha besuar, po të mos e kisha dëgjuar vetë. Kishin folur shumë, po-

thua jse të gjithë. E para qe ngritur Shpresa Bilali, që kishte diskutuar si ndonjë grua shteti, tha Donika. Para së gjithash, ajo kishte dashur të tregonte se si, me ç'mënyra dhe me ç'mjete kishte arritur Dyr Dema të krijonte një pushtet aq të plotë dhe aq të dëmshëm në ndërmarrje. Dhe këtë gjë ajo e kishte bërë aq mirë, sa i deleguari i Komitetit të Partisë e kishte marrë si shembull diskutimin e saj në konkluzionet e mbledhjes. Pastaj e kishte marrë fjalën kryeinxhinieri i ndërmarrjes, i çili kishte thënë se këto vitet e fundit me Dyr Demën nuk mund të diskutohej më. Përse këto vitet e fundit? — e kishin pyetur. Sepse, — ishte përgjigjur ai, — pikërisht në këto kohë ai arriti që edhe pushtetin ta ketë gatë të plotë, siç tha edhe Shpresa, duke vënë në vendet kyçe të ndërmarrjes njerëzit e tij, që nuk i përfillnin urdhrat dhe udhëzimet e drejtuesve të tjerë. Unë, kishte vazhduar ai, kam mbi tre vjet që ngul këmbë për rikonstruksionin e plotë të ndërmarrjes dhe jam penguar me të gjitha mënyrat. Përse nuk e dëshironte Dyrri rikonstruksionin? — e kishin pyetur. Sepse, kështu siç është, ndërmarrja drejtohet më lehtë, sepse mënyra e prodhimit, rendimenti, kostoja etj. janë caktuar një herë e mirë. Dhe, veç kësaj, edhe të metat shpërndahen në mënyrë të tillë që syri i një inspektori, bie fjala, e ka të vështirë t'i dallojë... Pastaj ishte ngritur Luftar Zyka, i çili kishte folur, pak a shumë, për ato që më

kishte thënë edhe mua. Pastaj Ylli Berati, Kujtim Sauku, disa punëtorë të presave, të repartit të zdrukthëtarisë, të ngritjes së makinerive ndihmëse dhe, për çudinë e të gjithëve, edhe Nurije Katrosi që kishte thënë: «E kam mallkuar njëqind herë Dyr Demën «e shuplaktë zoti!» dhe qe ku e shuplaku.» Kishin qeshur me fjalët e saj dhe, pasi e kishin pyetur se ç'donte të thoshte «shuplak», kishin kërkuar të dinin edhe nga ajo se ç'propozim kishte. Nurija nuk kishte asnjë propozim.

Midis atyre që kritikonin e kishin marrë fjalën edhe ata që kritikoheshin. Musa Zhuri, nga ana e tij, kishte thënë se ashtu ishte: siç e gjykonin shokët, qe treguar i butë në disa gjëra, e kishte lënë veten të tërhiqej nga të tjerët, por kishte besuar në mendjen dhe shpirtin e pastër të Dyr Demës. Tani e kuptonte se kishte mbajtur një qëndrim oportunist në ca gjëra dhe se ishte përgjegjës për to. Ndërsa kryetari i bashkimeve profesionale të ndërmarrjes kishte thënë: «E ku të linte Dyrri të bëje xhap? Sa herë i thosha për ndonjë çështje që, helbete, na dilte, ai ma kthente: Vëri mendtë punës, Rexhep, se ka kush merret me këto gjëra! E ç'të bëja unë? Ç'kisha unë në dorë?» I kishin thënë se kishte shumë në dorë, por nuk kishte bërë asgjë, e të tjera si këto. Kurse Gentian Spahu kishte folur shkurt fare dhe kishte thënë se qe munduar ta bënte punën sa më mirë. Për këtë le ta gjykonin shokët.

E ç'ti gjykonin? Ndaj edhe mbledhja që zgjatur shumë, me pyetje, kritika e vërejtje që Donika nuk mund t'i kujtonte të gjitha njëherësh. Sa për Dyr Demën, ai kishte folur si filozof; kishte thënë se ja, kështu, si një rrotë ishte jeta, zhvillimi i shoqërisë dhe i punëve që bënin njerëzit: E merrnin disa këtë rrotë dhe e çonin mirë e bukur deri në njëfarë vendi, pastaj nuk mundeshin më dhe fillonin e vinin prapë andej nga ishin nisur. Mirëpo ata nuk e kuptonin këtë derisa të ngriheshin ca të tjerë, më të ditur e më të fortë, që ta shtynin më tutje rrotën e ngecur. E kështu me radhë. Nuk i kishin dhënë shumë rëndësi filozofimit të tij. E kishin lënë të kalonte. I deleguari i Komitetit të Partisë të Rrethit kishte folur kryesisht për fuqinë e fjalës së punëtorëve, si edhe për dëmin që i bënin rendit socialist drejtues si Dyr Dema, të cilët duhet të merrnin atë që u takonte. Por kishte folur shkurt, dhe, më shkurt akoma, ato që kishte thënë, i kishte përmbledhur në motivacionin e shkarkimit të Dyr Demës nga posti i drejtorit. Në mbledhje ishte përmendur edhe rasti im, për të cilin Dyrri kishte pranuar që ishte ngutur pak. Por të tjerët (të gjithë shokët, tha Donika), i qenë kundërvënë, duke i thënë se ajo ishte një hakmarrje e paramenduar e të tjera. Ishte folur edhe për Mësall Sulën, i cili kishte ikur para pak ditësh nga ndërhyrja, por që ende askush nuk e dinte se ku kishte filluar punë, në Albimport apo në Ministrinë e Tre-

gtisë së Jashtme. Sidoqoftë, i deleguari i Komitetit të Partisë të Rrethit kishte pyetur për të dhe ia kishte shënuar emrin në bllokun e tij.

Kaq na tha Donika për këtë mbledhje që pritej të bëhej një ditë, por edhe në nuk i kërkuam më shumë.

Edhe pse Dyrr Demën, bashkë me disa që i shkonin përmbropa, i shkarkuan nga detyrat që kishin qysh të nesërmen e asaj mbledhjeje, unë nuk e rifillova punën po të nesërmen. M'u desh të prisja plot nëntë ditë, derisa Bashkimet Profesionale të Rrethit të urdhëronin ndërmarrjen me një shkresë e një vendim për pranimin tim përsëri aty dhe kuadri i ri i ndërmarrjes të bënte ndryshimet e nevojshme në librezën time të punës.


Dy herë që kisha shkuar atje, kisha vënë re se disa gjëra kishin ndërruar. Të pak-tën, njerëzit sikur ishin çliruar nga një vetëndrydhje dhe më dukeshin të gjithë më të dhënë pas punës. Të parën takova Nurije Katroshin. Më puthi në të dyja faqet dhe më tha: «E sheh si i shuplaku zoti, të keqen nëna?! Atje, atje ku isha do të më çojnë, më tha Naim Murati, që iu bëfsha! Po edhe ty prapë do të të marrin këtu, e kam dëgjuar me veshët e mi unë...» Të dytin takova Naim Muratin, kryeinxhinierin që, tani për tani,

bënte edhe punën e drejtorit. Naimi më tha: «Do të fillosh punë shpejt. Është biseduar me Bashkimet Profesionale.» Pastaj takova Shpresa Bilalin dhe Ylli Beratin. Po hanin mëngjesin në mensë. Shpresa, kur më pa, u çel në fytyrë. E përgëzova për qëndrimin e saj në mbledhje dhe ajo u kënaq e më tha: «U bë vërtet e fortë, shumë më e fortë se ç'e kisha parashikuar.» Pastaj, me radhë, Kujtim Saukun që më tha se tani as Natali Hajredini s'kishte për t'ia varur më Dyrr Demës, dhe vetë Natalinë që më vështroi me ca sy si të përmalluar. Dhe, më pas, Besnik Zajmin që vetëm sa më buzëqeshi e më tha t'i bëja provën e një stampe, sepse ia kishte lënë të pambyllur një djalë i ri që ishte sëmurë. Dhe, rastësisht, Musa Zhurin, sekretarin e organizatës-bazë, që kishte filluar punën në zdrukthetari. Nuk më pyeti asgjë përveç shëndetit dhe familjes. Ndërruam nga një cigare dhe u ndamë me nga një përsëndetje me dorë. Ndërsa Dyrr Demën e pashë që larg, rrinte pranë një stive dërrasash, i veshur me përparësen e marangozit. Nuk më bëri asnjë përshtypje. Nuk më bëri përshtypje edhe kur iu afrova e ai më buzëqeshi, kur hoqi dorezën prej meshine e më zgjati dorën, kur më pyeti për shëndetin duke vazhduar të buzëqeshte, sikur ne të kishim qënë bashkëfajtorë në një histori që, sidoqoftë, nuk kishte mbaruar aq keq. Por ku i dihej, sepse, ndërsa largohesha, m'u duk se e kisha harruar që dikur ai kishte qënë drejtor i

një ndërmarrjeje, së cilës qe përpjekur t'i vinte në çdo gjë emrin e vet.

Dhe ja ku erdhi ajo ditë e enjte kur unë do të rifilloja punën ashtu si më parë. Por a ishte vërtet një rifillim ashtu si më parë? Në mbrëmje im vëlla më kishte thënë: «Asgjë që ka njëfarë përvoje sado të vogël brenda saj, nuk mund të rifillojë kurrë si më parë. Aty diçka do të ketë ndryshuar patjetër...» Doemos, kisha thënë me vete dhe tani që po shkoja drejt ndërmarrjes sikur po e plotësoja me shembullin tim atë mendim të paqar deri në fund. Se ja, unë po kthehesha aty me më shumë mall, por më i përmbajtur nga ajo që kisha pësuar; po kthehesha më i sigurt, por edhe më i vëmendshëm nga ajo që kisha mësuar; po kthehesha më i burrrëruar e më i mençur nga ato që kisha menduar gjatë gjithë kësaj kohe. Dhe më vinte mirë që ndodhte kështu. Sepse tani e dija që kisha qenë më parë e ç'isha sot. Tani unë dija se edhe një njeri, për të qenë më shumë se thjesht i ndershëm apo burrë i mirë, nuk duhej dhe nuk mund të mendonte vetëm për ato gjëra që i shfaqeshin para syve. Të shikoje përtej dukjes së gjërave, ishte për mua njësoj si të jetoje dy jetë. Dhe kjo, në këtë ditë të rifillimit të punës sime, shënonte një hap të hedhur në rrugën që më priste të përshkoja.





**Sinani, H.**

Nuk e harroja atë ditë, Roman. [Red.:  
Z. Sula. Pikt: S. Marko] T., Naim  
Frashëri, 1989

264 f.

(B.m.) dhe

(B.v.) 891.983-31

S 59

Tirazhi 6000 kopje Formati 49x78/16 Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1989